



Universiteti i Evropës Juglindore-Tetovë

Fakulteti i drejtësisë

**TEMA: “KUPTIMI, ROLI, PERSONAT, KUSHTET E HAPJES SË PROCEDURËS SË
FALIMENTIMIT DHE TRAJTIMI JURIDIK I FALIMENTIMIT NE QYTETIN E
TETOVËS NGA VITI 2010-2015.”**

Studenti

Kaltrina Mustafi

Mentori

Prof. Dr. Adnan Jashari

2017

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI	5
HYRJE	6
QASJET TEORIKE DHE DEFINIMI I PROBLEMIT TË HULUMTIMIT	7
METODOLOGJIA	9
PJESA E PARË	10
VËSHTRIMI HISTORIK MBI FALIMENTIMIN	10
1. Falimentimi në Maqedoni	11
2. Falimentimi në kushtet globale	12
PJESA E DYTË	14
FAKTORËT CILËSORË PËR PARASHIKIMIN E FALIMENTIMIT	14
1. Pamundësia e kontrollit të kostove	14
2. Industria në rrënje	15
3. Konkurenca	16
4. Pamundësia për të siguruar financim dhe njëherit për të përmbushur detyrimet e maturuara ..	17
5. Menaxhimi i dobët	17
6. Kriza globale	18
7. Veprimet mashtruese, shkaktimi i qëllimshëm i likuidimit	18
PJESA E TRETË	20
Kapituli i parë	20
ORGANET E PROCEDURËS FALIMENTUESE.....	20
1. Gjykatësi falimentues.....	22
1.1 Kundërshtimi i vendimeve të gjykatësit falimentues	23
2. Drejtori falimentues	23
2.1 Marja e drejta e titullit drejtor falimentues i autorizuar	24
2.2 Kualifikimet, shpërblimet dhe shpenzimet e drejtorit falimentues	25
2.3 Autorizimet e Drejtorit falimentues	26
2.4 Përgjegjësitë e drejtorit falimentues.....	27
2.5 Shkarkimi i drejtorit.....	28
3. Këshilli i kreditorëve.....	28
3.1 Të drejtat dhe obligimet e këshillit të kreditorëve	28
4. Kuvendi i kreditorëve.....	29
4.1 Autorizimet e kuvendit të kreditorëve.....	31

Kapitulli i dytë	33
INICIMI, HAPJA E PROCEDURËS FALIMENTUESE	33
1. Propozimi për hapjen e procedurës falimentuese.....	33
2. Procedura paraprake.....	34
3. Hapja e procedurës së falimentimit.....	35
3.1. Procedura për hapjen e procedurës falimentuese përfshin:	36
3.2. Përbajtja e vendimit për hapjen e procedurës	36
4. Procedurat falimentuese ne R.M. dhe kohezgjatja e tyre.....	37
4.1. Procedurat falimentuese në gjykatat e R.M në bazë Ligjit për falimentim të 1997	40
4.2. Procedurat falimentuese në gjykata në bazë Ligjit për falimentim të 2006	41
5. Rastet në të cilat procedura e hapur falimentuese nuk realizohet	47
PRAKTIKA GJYGJËSORE	48
PJESA E KATËR	65
Kapitulli i parë	65
MASA FALIMENTUESE	65
1. Nocioni i mases falimentuese	65
2. Pasuria që nuk hynë në masën falimentuese	66
3. Bartja e pasurisë së falimentimit.....	67
4. Veprimet e mbetura pezull.....	67
5. Çështjet tjera të pasurisë në falimentim	68
5.1. Sekuestrimi, vulosja dhe marrja e pasurisë së debitorit	68
5.2. Inventari i pasurisë në falimentim.....	68
5.3. Pasuria në transit	69
Kapitulli i dytë	70
PËRMBUSHJA E KËRKESAVE TË KREDITORËVE NË PROCEDURËN E FALIMENTIMIT	70
1. Verifikimi i kërkesave.....	70
2. Përcaktimi për mënyrën e disponimit	71
3. Shndërrimi në para i sendeve ndaj të cilëve është fituar e drejta për përmbushje të ndarë.....	72
4. Kreditorët e falimentimit.....	73
5. Kreditorët e siguruar-veçuar	74
6. Kreditorë të përjashtuar.....	75
7. Kreditorët e masës falimentuese	75
8. Pasojat juridike nga hapja e procedurës së falimentimit	76
Kapitulli i tretë	78

SHPERNDARJA	78
1. Përbushja ndaj kreditorëve të falimentimit	78
2. Shitja e pasurisë në falimentim	79
3. Shpërndarja përfundimtare.....	80
PJESA E PESTË.....	82
PËRMBYLLJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	82
1. Ndërprerja e procedurës falimentuese.....	82
2. Riorganizimi	83
2.1. Prezantim mbi riorganizimin	84
2.2. Plani i riorganizimit	85
2.3. Përbajtjet e planit të riorganizimit.....	87
PRAKTIKA GJYGJËSORE	89
3. Përmbyllja e procedurës falimentuese	92
PJESA E GJASHTË.....	93
LLOJE TË VEÇANTA TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	93
1. Procedura e falimentimit mbi pasurinë e personave të vdekur-tregtar.....	93
2. Procedura e falimentimit mbi pasurinë e bashkëshortëve.....	94
FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR.....	96
PËRFITIMET NGA FALIMENTIMI.....	97
PËRFUNDIM	98
LITERATURA	100

ABSTRAKTI

Falimentimi si institut juridik ka qenë prezent që në shoqëritë e vjetra. Pas viteve 90-ta në Maqedoni gjithnjë e më tepër ndëgjoheshin termet falimentim, likuidim, transformin, organe falimentuese edhe ate në raste të shumta në kuptimin negativ. Falimentimi trajtohet si dukuri negative, sepse përqëndrimi i publikut është i drejtuar vetëm në pasojat e falimentimit në sferën sociale.

Duke patur parasysh zhvillimin e proceseve politike që ndodhën në Maqedoni jam përpjekur që përmes temës të trajtohen problemet e politikës falimentuese të shoqërive tregtare për kuptimin, rolin, efektet dhe pasojat nga ky proces si dhe studimi krahasues i zhvillimeve dhe rrjedhave të rregullativave ligjore që rregullojnë falimentimin në vendet e Ballkanit Perendimor dhe Bashkimit Evropian

Në punim jamë përpjekur të analizojë të gjitha karakteristikat, specifikat e ish Jugosllavisë si dhe të Maqedonisë si pjesë konstituive e federatës Jugosllave, por në kushtet e ndryshimeve rrënjësore të sistemit ekonomik politik dhe në kushtet e tranzicionit.

Janë trajtuar shkaqet dhe faktorët, të cilët inicojnë procedurën falimentuese, madhësia e subjekteve juridike të cilët ndryshojnë prej një vendi në vend tjetër, aspekti juridik apo rregullativa ligjore që ndryshon varësisht nga zhvillimi ekonomik-shoqëror i një vendi, si dhe relacionet kryesore të rregullativës ligjore të Maqedonisë me problemet aktuale strukturore.

Me fjalë të tjera themi se qëllimi është që përmes punimit të vlerësohen rrethanat, kushtet dhe trajtimi juridik konform rrethanave ekonomiko-sociale, shoqërore të vendit.

Pra, ka të bëj me avancimin e rregullativës ligjorë konform rrethanave ekonomike, sociale politike, dhe në harmonizim të standardeve dhe rregullativës ligjore të vendeve fqinje dhe Bashkimit Evropian pasi Maqedonia është pretendent për anëtarësim në strukturat euroatlantike.

HYRJE

Përcaktimi për këtë temë rrjedhë si rezultat i konsultimeve me mentorin Prof. Dr. Adnan Jashari dhe profesorët tjerë të cilët më sugjeruan për dobishmërinë e temës në fjalë për mua, opinionin dhe për të gjithë lexuesit.

Paaftësia paguese është një dukuri që po ndeshet shpesh në qarkullimin e sotëm civil dhe tregtar në Republikën e Maqedonisë. Megjithatë, procedurat e falimentimit janë shtuar shumë në dyert e gjykatave, fenomen në vendet në tranzicion dhe vendet e zhvilluara me ekonomi tregu.

E drejta e falimentimit është një degë relativisht e re e së drejtës krahasuar me degët e tjera, por problemet e falimentimit janë aq të vjetra sa që janë të përfshira në të Drejtën Romake, ndërsa shekulli XX karakterizohet si shekull i zhvillimit tejet të madh të mardhënjeve të kapitalit në prodhim, shekull ku ekonomia zhvillohet me hapa të mëdhenj duke e bërë që kjo problematikë të ketë një qasje serioze.

Falimentimi si institut juridik gjithashtu ka qenë prezent që në shoqëritë e vjetra. Sot, në kushtet e zhvillimit të shpejtë të ndryshimeve, falimentimi ka për qëllim të pastrojë tregun nga subjektet joprofitabile. Pra falimentimi konsiderohet si mënyrë gjygjësore e ndërprerjes së veprimtarisë të subjekteve afariste për shkak se ata punojnë me humbje dhe pa mundësi t'iu përgjigjen kërkesave nga kreditorët e tyre.¹

Në rrethanat e globalizimit ndryshimet janë shumë të mëdhaja si rezultat i aplikimit të teknologjisë informative, konkurrencës perfekte dhe krizave finaciare të natyrave rajonale dhe globale me çrast trajtimi juridik i problematikës falimentuese kërkon një qasje profesionale, korrekte dhe transparente.

¹ Ligji për falimentim i Shqipërisë, nr.8901/2002

QASJET TEORIKE DHE DEFINIMI I PROBLEMIT TË HULUMTIMIT

Sa i përket qasjes teorike dhe definimit të problemit të hulumtimit në këtë temë të magistraturës; “Kuptimi, roli, personat, kushtet e hapjes së procedurës së falimentimit dhe trajtimi juridik i falimentimit nga viti 2010-2015.” gjitha njohuritë teorike dhe empirike që do të përmbahen në tezën e lartë përmendur do të përgaditen në disa kapituj tematikë.

Pjesa e parë ka të bëjë me vështrimin historik të falimentimit. Në këtë pjesë të temës janë analizuar qasjet mbi inicimin e procedurës së falimentimit në ish Jugosllavi dhe vazhdimësia e këtij procesi në Maqedoni si shtet i mvetësuar nga kjo bashkësi, me theks tëposaçëm realizimi i tij në periudhën e tranzicionit. Në këtë kapitull do të tentoj të shpjegoj konceptin e procesit të inicimit të falimentimit, rolin, kuptimin, rrethanat dhe specifikat e tij në Maqedoni.

Karakteristikë e trajtimit të problemeve të falimentimit në ish vendet socialiste është se mungonte një eksperiencë dhe dije, pasi firmat që ishin joprofitabile gjithnjë subvencionoheshin nga shteti dhe raste të falimentimit ishin simbolike. Poashtu, është bërë edhe një komparacion të rregullativës ligjore mes shteteve të E.J.L. dhe B.E.

Në pjesën e dytë të temës janë analizuar dhe shqyrtuar faktorët cilësorë dhe shkaqet të cilët inicojnë falimentimin edhe atë:

-Sistemi i dobët i kontabilitetit dhe raportimit financiar, pamundësia e kontrollit të kostove, industria në rrënje, shkalla e lartë e konkurrencës, pamundësia për të siguruar financim dhe njëherit për të përmbushur detyrimet e maturuara, menaxhimi i dobët, siguracionet e pamjaftueshme, efekti i krizave rajonale dhe globale, trazirat, krizat rajonale dhe luftrat, veprimet mashtruese, shkaktimi i qëllimshëm i likuidimit etj.

Shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit shprehet në shumë vende, ndërsa në vendet në tranzicion këto ishin raste të shumta gjatë procesit të privatizimit të kapitalit shoqëror për qëllime të përfitimeve të strukturave të caktura të menaxhmentit të subjekteve ekonomike dhe atyre burokratike. Krizat rajonale dhe ato globale janë shkaktarët të cilët i çojnë drejtë falimentimit edhe firmat shumë të fuqishme deri te kompanitë multinacionale që karakterizohen me potencial të madh kadrovik e material-kapital.

Në pjesën e tretë analizohen organet e procedurës së falimentimit, cilët janë ata, cili është roli i tyre në procedurën e falimentimit. Në këtë pjesë gjithashtu shqyrtohen teknikat e procedurës së parashtrimit të kërkesës për falimentim. Si bëhet parashtrimi i kërkesës për falimentim, kush e parashtron kërkesën për falimentim, koha kur mund ta bëjë debitori kërkesën për falimentim, kur mund të parashtrorj kërkesën për falimentim një kreditor, kur mund ta tërheqin kreditorët kërkesën e tyre, cilat janë dokumentet e nevojshme për në gjykatë dhe si zhvillohet procedura hap pas hapi. Sqarohet për rolin, emërimin, autorizimet, kushtet, kualifikimin, shpërblimet, shpenzimet, përgjegjësinë, obligimet dhe shkarkimin e drejtorit të falimentimit. Poashtu, analizohen edhe organet tjera si Këshilli i Kreditorëve dhe Kuvendi kreditorëve për rolin, autorizimet të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë.

Në pjesën e katërt defiohet masa falimentuese si bazë kryesore e zhvillimit të procedurës së falimentimit. Çka përfshin konkretisht masa e falimentimit, cila pronë e debitorit do të llogaritet si masë falimentuese, definohet se a do të përfshihet në masën e falimentimit vetëm prona që e ka pasur debitori deri në momentin e hapjes së procedurë apo do të llogaritet edhe prona e cila fitohet edhe gjatë procedurës së falimentimit. Trajtohen edhe çështjet tjera të falimentimit si sekuestrimi, vulosja dhe marrja e pasurisë së debitorit.

Ne pjesën e pestë sqarohet pjesa përfundimtare e procesit të falimentimit. Forma e pëmbjlljes së një procedure, gjithashtu sqarohet se pamvarësisht kërkesës për falimentim nuk do të thotë se subjekti patjetër duhet të mbyllet, por eksitojnë forma të parashikuara me ligj ku shoqërisë i jepet edhe një mundësi që të ripërtrihet dhe të vazhdojë të funksionjë me fjalë të tjera të mund të riorganizohen nëse ka kushte.

Në pjesën e gjashtë në pika të shkurtra ceken disa forma të veçanta të procedurës falimentuese si psh. procedura falimentuese mbi pasurinë e personit të vdekur tregtarë, procedura falimentuese mbi pasurinë e bashkëshortëve si dhe procedura falimentuese e cila në vete përmban edhe elementin ndërkombëtarë.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur është një trajtim linear i historikut të politikës tatimore që gërshetohet përmes krahasimit të efikasitetit të doktrinave të ndryshme qeverisëse. Gjatë punimit të temës në fjalë janë përdorur këto metoda:

a) Metoda krahasore. Përmes kësaj metode është bërë krahasimi i ecurive ekonomike të Maqedonisë me vendet e tjera. Pra, kjo metodë mundëson krahasimin e indikatorëve të ndryshëm në zhvillimin e procesit të transformimit dhe të privatizimit të pronës qoftë mes vendeve të ndryshme që i përfshiu vala e privatizimit ose të ndërmarrjeve në vend si dhe krahasimin e degëve të ndryshme të sektorëve të ekonomisë.

b) Metoda statistikore. Me anë të kësaj metode bëhet i mundur shqyrtimi analitik dhe sintetik i të dhënave, pra mundëson që të arrihet deri te analiza sasiore dhe cilësore e zhvillimit.

S'ka dyshim se analizat dhe konstatimet e ndryshme, pos tjerash duhet të mbështetën në të dhëna statistikore, e këtë e mundëson metoda statistikore. Kështu, konstatimet mbi zhvillimin e dukurive apo të sektorëve të ndryshëm duhet argumentuar me të dhëna të shumta statistikore dhe me të dhëna të ngjashme. Shpeshherë të dhënat statistikore flasin më shumë se një tekst i madh i shkruar. Pra, të dhënat statistikore nga burime relevante mundësojnë dhe japin pasqyrë reale dhe të qartë për studime dhe kërkime të ndryshme në lëmenj të ndryshëm dhe periudha të ndryshme.

PJESA E PARË

VËSHTRIMI HISTORIK MBI FALIMENTIMIN

Edhe pse E drejta e Falimentimit është degë relativisht e re e së drejtës së krahasuar në krahasim me degët e saja por problemet e këtilla haseshin edhe në kohët e mëhershme. Sot, kjo dukuri, në kushtet e ekonomisë së tregut apo më gjërë në kushtet dhe rrethanat e ekonomisë globale ku karakterizohet me një prodhimtari masive dhe konkurrencë perfekte, gjenë konkretizim të plotë në këto marrdhënie. Falimentimi si proces zanafillën e ka nga e Drejta Romake, te Padia Pauliana që ngrihej për të kundërshtuar veprimet e kryera nga debitori në mashtrim të kreditorëve, duke fshehur pasurinë e tij për t'iu shmangur përmbushjes së detyrimeve. Si e drejtë, e Drejta e Falimentimit fillimet e saja i ka në Itali rreth shekullit XIII dhe përbën një produkt të shoqërisë tregtare të epokës komunale të mesjetës së hershme. Kjo periudhë në Itali apo gadishullin Apenin në atë kohë, përbënte bazën materiale të mirë të një discipline të tillë. Të gjitha këto raporte ekonomike dhe lulëzimi i ekonomisë gjetën reflektim në të drejtën e asaj kohe dhe një regullim të ri juridik. Edhe pse ky legjislacion nuk ka ndonjë avancim juridik por në saje të specifikave të kohës shënon fillimin e përfshirjes së një legjislacioni të veçantë, dhe për të parën herë mer versionin zyrtar, si institut bazë dhe karakteristikë për transformimin e të mirave të të falimentuarit, të sqarimit të kredive sipas procedimeve unike dhe pasurisë së falimentimit përmes ushtrimit të së drejtës së kthimit për veprimet kontestuese të kryera në mashtrim të kreditorëve nga debitori në periudhat e dyshimta. Me këto karakteristika, falimentimi përhapet në Evropën Veriore, ku edhe më tepër avancohet në saje të specifikave dhe rrethanave ekonomike, shoqërore dhe politike të vendeve. Pas Mesjetës në Francën pas Revolucionit francez në periudhën e Napoleon Banapartës, falimentimi ashtu si dhe shumë degë dhe institute të së drejtës, do të shënojnë një rritje dhe hap përpara. Ndryshimet dhe avancimet që ndodhën në këtë periudhë bënë që kjo degë të mer rolin primar dhe të influencon në legjislacionet edhe në shumë shtete tjera për rreth, përfshirë edhe legjislacionin Italian që ishte pikënisës dhe bazë e kësaj problematike. Pra, përmes Falimentimit në këtë periudhë të hershme u ruajtën dhe u zhvilluan edhe institute tjera të së drejtës me

originë, që nga e drejta romake.²

1. Falimentimi në Maqedoni

Ligji i falimentimit është vazhdimësi e Ligjeve të ish-Jugosllavisë pasi Maqedonia ishte njësia konstituive e R.S.F.J. Ky Ligj ka qenë i rregulluar me ligjin për barazim me dhunë, falimentimin dhe likuidimin (1989).³ Në këtë periudhë në bazë të ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror dhe ligjit të ri për Shoqëritë tregtare (1996) ishte e paevitueshme (për shkak rrethanave të reja-format e kapitalit) që të reformohet edhe falimentimi. Këta ndryshime imponuan miratimin e ligjit për falimentim⁴ në vitin 1997. Për dallim nga ligji i vitit 1989, me këtë ligj u regulluan edhe tre sfera tjera që kanë të bëjnë me;

-riorganizimin e debitorit falimentues

-administrimin personal të debitorit dhe

- kushtet dhe efektet e lirimit të debitorit nga obligimet tjera.

Me këtë ligj nuk regullohet likuidimi, e cila nuk konsiderohet si procedurë gjyqësore pasi atë procedurë nuk e zhvillojnë gjykatat, por likuidatorët e vetë shoqërisë dhe zakonisht si likuidatorë mund të jenë personat që kanë qenë të autorizuar ta përfaqësojnë shoqërinë.

Në R. e Maqedonisë në fushën e falimentimit janë zbatuar tre ligje, edhe ato:

-Ligji për barazim të dhunshëm, falimentim ose likuidim

-Ligji për falimentim prej vitit 1997 dhe

-Ligji për falimentim prej vitit 2006

Janë përdorur këta tre ligje sepse një procedurë falimentuese që ka filluar me të njejtin ligj është dashtë të përfundon po me atë ligj. Nga kjo rrjedh se Ligji i fundit për falimentim⁵ është zbatuar vetëm për procedurat që janë hapur pas hyrjes në fuqi të tijë.

Barazimi me dhunë si institut nuk parashihet, pasi shumë herë në bazë të këtij instituti dëmtoheshin kreditorët në favor të debitorit edhe qoftë duke e liruar debitorin nga pjesë e obligimeve apo duke e bërë shlyerjen e realizimit të tyre. Barazimi me dhunë, debitorit falimentues i ka mundësuar që të ushtrojë veprimtarinë pa kurfarë ndryshimi në strukturën organizative të tij. Me ligjin për falimentim më 1997 në vend të barazimit me dhunë u parapa

² E drejta e Falimentiti, Dr.Prof.Erblina Fetahu, Tiranë

³ ‘‘Gazeta Zyrtare e R.M.’’ nr 84/89

⁴ ‘‘Gazeta zyrtare e R.M.’’ nr 57/97

⁵ Shpallur në F.zyrtare të R.M. nr 34/06

riorganizimi, me qëllim që ti mundësohet debitorit falimentues të vazhdoj të ushtrij veprimtarinë duke aftësuar debitorin që të realizoj të hyra. Në sajë të rekomandimeve të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare (B.B.; F.M.N) dhe U.E. dhe harmonizimi i ligjeve po edhe të falimentimit është inicuar miratimi i ligjit të ri mbi falimentimin. Edhe pse në aspektin konceptual dhe strukturor nuk ndryshon nga ai i vitit 1997, magjithatë Ligji i ri i vitit 2006 përfshinë disa risi.

Së pari kanë ndryshuar kushtet për iniciimin e falimentimit. Sipas dispozitave të këtij Ligji falimentimin mund të inicohet vetëm nëse debitori është i paaftë për pagesë, pra nuk ka mundësi të përmbushë të gjitha kërkesat e arritura në të holla. Afati ligjor që të mos bën pagesën e këtyre obligimeve është paraparë me ligj. Këshilli falimentues nuk është më organ i procedurës falimentuese, por konsiderohet si organ i shkallës së dytë në procedurën falimentuese dhe ai vendos sipas ankesave kundër vendimeve të gjyqtarit falimentues dhe në lidhje me kundërshtimet e kreditorëve, këshillin dhe kuvendin e kreditorëve. Ky organ është i përbërë prej tre gjyqtarëve, ashtu që tani gjyqtari falimentues nuk është anëtar i këtij organi. Drejtori falimentues për të ushtruar kompetencat e veta duhet të ketë licencë-çertifikatë për drejtor të autorizuar falimentues, që duhet të ripërtrihet (certifikata) në çdo 3-vite për ripërtrirjen e diturive nga fusha e likuidimit. Krahas të drejtave, autorizimeve janë rritur edhe përgjegjësitë e drejtorit falimentues për shkak të dëmeve që mund të sjell çdo pjesëmarrës në procedurën falimentuese me çrast përgjigjet në mënyrë të pakufizuar me tërë pasurinë e tij, ai gjithashtu është i detyruar të paraqes informatë për masën falimentuese. Ndryshime ka edhe në lidhje me emërimin e drejtorit falimentues dhe ndryshime tjera pozitive. Ky ligj është i harmonizuar me ligjet e institucioneve të lartëpërmendura dhe Unionit Europian.

2. Falimentimi në kushtet globale

Përpyekjet për rregullimin ndërkombëtar të falimentimit datojnë shumë herët, ku këta përpjekje hasën që në shekullin e XIII⁶. Por, këta përpjekje kanë qenë të vazhdueshme si: Model-Ligji për falimentim Ndërkufitar të UNCITRAL-it teksti përfundimtar i të cilit u miratua më 1997, Model-Ligji për bashkëpunim në rast të Falimentimit Ndërkombëtar të Institutit Amerikan të së Drejtës, etj. Në Europë për problemet e falimentimit ka pasur disa përpjekje për tu

⁶ R. Leshner ‘‘The new threat to Intrernotional Comercial Transactions; cross- Border Insolvency and its impact on the Stanble letter of credit regime’’ www.natlaw./pubs/spack I htm

rregulluar kjo çështje. Në vitin 1990 në Stamboll është miratuar Konventa Europiane⁷ aktuale mbi “Disa Aspekte Ndërkombëtare të Falimentimit” të cilën e kanë nënshkruar 8-vende, nga të cilët vetëm njëri e ka ratifikuar. Në vitin 1995 Bashkimi European adoptoi një Konventë mbi Procedurat e Falimentimit. Asnjëra nga këto konventa nuk ka hyrë në fuqi. Me qenë se Konventa e 1995 nuk u miratua nga të gjitha shtetet anëtare të BE, Këshilli i Ministratave të BE-së e miratoi tekstin e Konventës përgatitore si Rregullore. Kjo Rregullore u miratua në 29 maj të vitit 2000 dhe ka hyrë në fuqi në vendet anëtare të BE-së në vitin 2002. Kështu, Rregullorja e BE-së për procedurat e falimentimit është shprehur për njohjen automatike të vendit të huaj për fillimin e falimentimit, gjë që është reflektuar edhe në të drejtën gjermane (nenet 335-338 të Ins-os).⁸

⁷ Council Regulation on Insolvency Proceeding (CE)N. 1346/2000, dt 29.05.2005

⁸ Simpoziumi i Ohrit, fq 63

PJESA E DYTË

FAKTORËT CILËSORË PËR PARASHIKIMIN E FALIMENTIMIT

1. Pamundësia e kontrollit të kostove

Për çdo aktivitet ekonomik, pa marrë parasysh formën pronësore të organizimit-statusin juridik, për realizimin e aktivitetit biznesorë duhet të llogarisë faktorët e prodhimit (punën, tokën dhe kapitalin) dhe elemente tjera të domosdoshme për të cilët duhet të ndajë mjetet financiare që ndryshe në terminologjinë ekonomike quhen **kosto**. Organizimi i aktivizimit të faktorëve të prodhimit duhet të jetë racional, kjo do të thotë kombinim optimal i faktorëve të prodhimit të cilët në periudhë afatgjate, firmës do ti sjedhin prodhim maksimal me kosto minimale. Kostot paraqesin kategorinë më të rëndësishme të suksesit afarist pa marrë parasysh formën pronësore organizative, madhësinë e ndërmarrjes, llojin e pronës dhe specifikave të tjera, sepse kostot kanë influencë direkte në fitimin e firmës edhe atë posaçërisht në kushtet e ekonomisë globale ku konkurrenca perfekte vinë në shprehje më shumë se çdo herë. Ulja e shpenzimeve do të thotë ulja e shpenzimeve-kostove në procesin e krijimit të vlerës. Eksperienca tregon disa shtete arritën produktivitet më të madh me shfrytëzimin e faktorëve të prodhimitarisë, kurse disa produktivitet më të vogël. Disa me shpenzime më të vogla kanë dhënë prodhime me kualitet më të lartë, e disa me shpenzime më të mëdha kanë dhënë prodhime që karakterizojnë teknologji të vjetëruara. Në kushtet e konkurrencës perfekte motiv i firmës është fitimi i cili arrihet me zvoglimin dhe kontrollin e kostove. Firmat janë në presion të vazhdueshëm për të reduktuar kostot si dhe për të diferencuar produktin me qëllim të përshtatjes kërkesave specifike të tregjeve të caktuara. Kjo dukuri është mjaftë e aktualizuar edhe te kompanitë multinacionale të cilat karakterizohen me resurse të mëdha materiale dhe kapital të madh financiar dhe kuadra profesionale dhe shkencore. Për një ekonomi në kushte të konkurrencës globale kompanitë i kanë përsosur katër variantat strategjike edhe atë:

- sigurimin e prodhimeve të tyre mbi bazat e resurseve të jashtëme,
- rezervimin e kërkesave në tregje të jashtëme nëpërmjet formimit të filialeve të tyre në vende tjera,

-racionalizimin e prodhimit në bazë të transferit të tijë në ato vende ku shpenzimet e prodhimit janë shumë më të vogla në krahasim me vendin amë,

-orientimi në shfrytëzimin e investimeve vetjake, investimeve të huaja dhe formave tjera të kreditimit me qëllim të formimit të firmave subsidiare, dhe arritjen e marrëveshjeve afatgjate me partnerët e jashtëm.⁹

Në politikën afariste ka një politik të repte të kontrollit të kostove edhe atë përmes evidencës dhe udhëheqjes së përpiktë të kontabilitetit të kompanisë në qendër pa marrë parasysh edhe nëse ka filial në vendet tjera ato janë të obliguar të raportojnë në bazë të standardeve dhe parimeve të kontabilitetit me qëllim që të kenë qasje në politikën e afarizmit dhe kontrollin e kostove.

2. Industria në rrënje

Normat e ulta të rritjes ekonomike, së pari shprehet me rrënje të prodhimtarisë industriale, të cilat janë të shoqëruara me një deficit të lartë buxhetore, papunësi, rritje të borxhit të jashtëm, çregullimin e tregjeve financiare, veçanërisht rritjen e kredive hipotekare, rritjen e dallimeve sociale dhe pasoja të tjera. Industria në rrënje është edhe rezultat i vjetërsisë së teknologjisë dhe mos aplikimit të teknologjisë informative, firmat të cilat përdorin teknologji klasike kanë edhe strukturë prodhuese klasike. Vjetërsimi i diçkahit nxitën vjetërsimin e diçkahit tjetër. Nuk vjetërohet vetëm teknologjia, pajisjet, njohuritë, por edhe gjitha struktura prodhuese, sistemi udhëheqës, drejtues, pikëpamjet udhëheqëse etj. Vjetërsimi i përfshinë të gjitha komponentat e njohurive të përgjithshme. Nuk ndryshon vetëm madhësia dhe niveli i njohurive, por edhe aftësia në punë, zakonet e prodhimtarisë, aftësia për përdorimin e teknikave të reja dhe përshtatja në ndryshimet e reja. Ata krijojnë rezultate shumë të dobëta në krahasim me firmat, strukturat e të cilëve bazohen dhe zhvillohen si rezultat i teknologjive të reja. Në rrënje industriale ndikojnë edhe faktorë të tjerë si vjetërsimi i profileve të tëra të kuadrit-zëvendësimi i përshtetuar i kualifikimeve më të ulta në ata më të larta të arsimimit, të veprimtarive operative me veprimtari kontrolluese dhe regullative, të veprimtarive prodhuese me veprimtari të informimit e tj.

Teoria dhe praktika moderne ka treguar për efektin nga vendosja e metodave të reja për rinovim, modernizim dhe inovim të njohurive të profileve të ndryshme, në fusha dhe vende të ndryshme që nënkupton se rinovimi dhe zhvillimi i njohurive është i nevojshëm gjithkund.

⁹ Veselin Drashkovic, Beograd, 2001.

Në fund mund të konstatojmë se vjetërsimi i teknologjisë dhe i njohurive, i gjithë elementeve materiale dhe jo materiale të zhvillimit, kërkon plotësim të përhershëm të vlerës së humbur të mjeteve dhe atë në nivel më të lartë, (për shkak të amortizimit fizik dhe moral) dhe humbjes së vlerës së njohurive profesionale, shkencore dhe udhëheqëse ndikojnë në humbjen e hapit me kohën dhe rrënjën industriale që çon në shuarjen e firmave të cilat nuk mund të ekzistojnë në rethana të tilla.

3. Konkurenca

Çdo firmë duhet të disponojë strategjinë e vetë për të luftuar konkurrencën në treg. Strategjitë janë aktivitete të paramenduara për të aritur përparësi komparative. Firmat të cilat luftojnë me konkurrencën në një industri përzgjedhin strategji afariste të konkurrencës. Reformat ekonomike si liberalizimi i tregëtisë dhe i tregut financiar, privatizmit etj. janë parë gjithmonë si mjete për të nxitur konkurrencën dhe për të promovuar një efikasitet të madh. Politika e konkurrencës është shumë më tepër se vetëm legjislacioni i konkurrencës. Politika e konkurrencës është një set me masa dhe instrumenet ku përfshihen edhe privatizimi, ristruktuimi, parregullsia, liberalizimi, investimet e huaja direkte etj. Një problem lidhur me konkurrencën është ekonomia informale. Kjo çështje është shumë komplekse dhe nuk shikohet vetëm nga një këndvështrim. Informaliteti ka pasoja negative në zhvillimin e sektorit privat formal, po ti referohemi konkurrencës.

Secila firmë që është me fushëveprim të konkurrencës në një industri të vetme, zgjedh një ose kombinim të disa strategjive të mundëshme:

- strategji e orientuar kah shpenzimet,
- strategji e diferencimit,
- strategji e fokusuar në shpenzime të ulta dhe
- strategji e fokusuar në diferencim.

Firmat që nuk aplikojnë strategjitë e caktuara nuk mund të përballojnë konkurrencën, dhe kështu u hapet rruga drejt falimentimit.

4. Pamundësia për të siguruar financim dhe njëherit për të përmbushur detyrimet e maturuara

Pamundësia për të siguruar financim dhe njëherit për të përmbushur detyrimet e maturuara ka të bëjë me një situatë ligjore në të cilën ndodhet subjekti fizik apo juridik në kushtet e pamundësisë për të paguar huatë e marra në kohën e maturimit. Pra rezulton me një situatë shumë të rrezikshme si për debitorin ashtu edhe për kreditorin. Pra, problemet me financim, paraqesin qasjen e rëndë për sigurimin e mjeteve financiare për përmbushjen e obligimeve. Për të dalë nga kjo situatë, ndodh marrja e borxheve të tjera të cilët edhe më shumë do të rëndonin situatën financiare dhe pamundësinë që ti paguaj, gjë që do të ndikonte në besimin e subjektit ndaj institucioneve bankare për të rimarrë borxhe tjera. Pra bankat duke aplikuar kritere të ashpra për kthimin e mjeteve, në parim ato u shmangen projekteve me rrezikshmëri, pa marrë parasysh profitin e pritshëm nga ana e kërkuesve të mjeteve financiare.

5. Menaxhimi i dobët

Të gjitha subjektet ekonomike pa marrë parasysh nga format organizative dhe madhësia, të vogla, të mesme të mëdha, private apo publike, profitabile apo joprofitabile, pavarësisht edhe nga fusha ku veprojnë aktiviteti i tyre mvaret nga një emërues i përbashkët-nevoja për tu menaxhuar. Çdo organizatë për aktivitetet e veta ka nevoj për faktorët e prodhimit si puna, toka dhe kapitali. Për aktivizimin e tyre menaxheri është ai që në procesin e punës i bashkon dhe i koordinon këto burime për arritjen e objektivave organizative. Praktikant e përditëshme kanë treguar dhe vërtetuar se faktori vendimtar për suksesin apo dështimin e një biznesi është aftësia apo paaftësia e menaxhmentit. Përgjegjësia e menaxherit në shoqërinë tonë është vendimtare jo vetëm për vetë organizatën, por edhe për qëndrimin publik ndaj menaxhimit, për suksesin dhe statutin e tij, për të ardhmen e sistemit tonë ekonomik e social dhe për mbijetesën e organizatës si një institucion i pavarur.¹⁰

Menaxhimi i biznesit në kushtet bashkohore është mjaft dinamik dhe paraqet një sfidë të veçantë në punën e menaxherëve. Menaxhim i sukseshëm i ndërmarrjes nënkupton aftësinë e menaxherëve që të marrin vendime kualitative. Sipas shumë autorëve, menaxhment do të thotë planifikim, organizim, komandim, kordinim dhe kontrollë. Menaxherët mund të rrisin

¹⁰ P.Drucker; The practice of management, Heinemann Profesional, 1999 fq 377.

profitabilitetin e firmës duke ndjekur strategji të cilat synojnë reduktimin e shpenzimeve apo edhe duke ndjekur strategji të cilat rrisin vlerën e produkteve apo shërbimeve.

6. Kriza globale

Globalizimi i ekonomisë botërore i ndryshoi konceptet, strategjitë dhe politikat e firmave, kompanive dhe ekonomive nacionale. Sipas Nouriel Roubinit, “Një reth vicioz humbesh, reduktim i kapitalit, shtërngim krediti, likuidime të detyruara kompanish dhe shitje aktive me çmime shumë të ulëta do të çojnë në një cikël kaskadë humbesh dhe shtërngimi të mëtejshëm krediti”. Ishte një nga 12 etapat e skenarit të krizës financiare që parashikoi profesori i ekonomisë në Univerzitetin e New York-ut, para se falimentimet e bujshme të institucioneve gjigante financiare të ndodhin. Në vitin 2008 bota hyri zyrtarisht në atë që gjithë e dinin dhe e njihnin si “Kriza e Kredive Hipotekare Nënstandarde”¹¹ Kjo krizë u reflektua si pasojë që disa blerës të letrave me vlerë, të bazuara në hipoteka, nuk ishin në gjendje që ato ti shndërrojnë në para. Këta kredi nga institucionet bankare nuk u dhanë në bazë të standardeve ndërkombëtare, por në bazë të ligjit mbi dhënien e detyrueshme të kredisë, shtresave të varfura të shoqërisë dhe komuniteteve.

Krizat financiare e çorjetojnë gjendjen financiare të një vendi, rrisin numrin e kompanive që falimentojnë, ulin prodhimin dhe shkaktojnë papunësi të madhe, ngadalsojnë rritjen ekonomike të një vendi. Çdo krizë financiare është unike në natyrën e saj, formën, shkaqet dhe pasojat. Sipas fjalorit të biznesit, një krizë financiare është një situatë në të cilën oferta për para tejkalohet nga kërkesa për para. Kjo nënkupton që “avullon” shpejtë pasi paraja e disponueshme tërhiqet nga bankat, duke i detyruar bankat të rrisin kamatat për depozitat nga qytetarët.

7. Veprimet mashtruese, shkaktimi i qëllimshëm i likuidimit

Vetë procesi i falimentimit është një proces mjaftë me përgjegjësi që kërkon dije, shkathtësi, profesionalizëm, vullnet, paanëshmeri, dhe ndershmëri për hulumtimin e gjendjes ekonomike, financiare dhe materiale të borxhliut. Hulumtimi kërkon një periudhë më të gjatë e jo një datë të caktuar, pra edhe përcjellje retroaktive e disa viteve pas. Specificiteti i problematikës

¹¹ “The Rising of a Systemic Financial Meltdown; The Twelve Steps to Financial Disaster”

kushtëzon shkallë të lartë njohurie e profesionalizmi në atë drejtim sepse vetë procesi i hapjes së procedurës falimentuese has në forma të ndryshme të falimentimit të instruktuar apo të iskenuar me qëllim të shlyrjes së detyrimeve ndaj kreditorëve dhe obligimet ndaj institucioneve shtetërore.

Si rezultat i ritjes dramatike dhe të shpejtë të numrit të shoqërive tregtare, administrata tatimore e cila në të kaluarën kontrollonte një numër të kufizuar tatimpaguesish mjaftë të disiplinuar, në situatën e re, me numër të vogël të punësuarëve, pa pajisje të nevojshme teknologjike, financiarishtë të pamotivuar dhe të papregaditur për rrethanat e reja e kishte të pamundur të realizojë kontroll fiskal. Pra, në këtë kontest të ndryshimeve të shpejta dhe pamundësisë së ndjekjes së kontrollave fiskale rriteshin shanset dhe mundësitë për marrjen e vendimit të gabuar. Serioziteti i problemit qëndron në konstatimin e gjendjes materiale, ekonomiko-financiare të borxhliut për shkak të konsekuencave juridike, të cilat mund të paraqiten nga hulumtimi joprofesional, konflikt interesash apo formave tjera devijuese që për shoqërinë apo interesin kolektiv ka pasoja juridike.

Shkaktimi i qëllimshëm i falimentimit shprehet në shumë vende, ndërsa në vendet në tranzicion këto ishin raste të shumta gjatë procesit të privatizimit të kapitalit shoqëror për qëllime të përfitimeve të strukturave të caktura të menaxhmentit të subjekteve ekonomike dhe atyre burokratike.

PJESA E TRETË

Kapituli i parë

ORGANET E PROCEDURËS FALIMENTUESE

Karakteristika kryesore e procedurës falimentuese është në atë se ajo është procedurë gjyqësore, dhe prej momentit të hapjes së saj formohen organe që udhëheqin me procedurën. Formimi i këtyre organeve ka disa funksione.

Funksioni i parë është udhëheqja me procedurën falimentuese. Ajo i përfshinë të drejtat, obligimet dhe kompetencat në udhëheqjen e procedurës falimentuese.

Funksioni i dytë që e kanë këto organe është e lidhur me kryerjen e të drejtave korporative të strukturës së qeverisjes që ekzistonte në shoqërinë tregtare para hapjes së procedurës falimentuese. Këtu është fjala për kufizim të ndërmarrjes së kompetencave të organeve të lidhura me formimin e dëshirave, qeverisja dhe mbyqirja në shoqërinë si dhe vendosmëria në procesin e udhëheqjes, vetëm për nevojat e procedurës falimentuese. Pra, përjashton çdo dëshirë, tendencë, paragjykime që janë jashtë procedurës falimentuese.

Funksioni i tretë është i lidhur ngushtë me qeverisjen, që ka të bëjë me përfaqësimin dhe autorizimin e borxhliut mbi të cilin është hapur procedura falimentuese.

Mënyra e formimit të organeve të qeverisjes me procedurën falimentuese mvaret nga rrjedhja e pasojave juridike dhe me të drejtë është suksesive. Kjo do të thotë se të gjitha organet nuk formohen në të gjitha llojet e procedurave falimentuese në mënyrë të njëjtë dhe nuk kanë të njëjtat kompetenca.¹²

Të drejtat dhe obligimet si dhe kompetencat e organeve të cilët formohen për udhëheqje të procedurës falimentuese janë reptësishtë të regulluara me ligj dhe nuk ka mundësi që ato të ndryshojnë.

Organi i parë që paraqitet në procedurën falimentuese është gjykatësi falimentues¹³ i cili ka kompetenca funksionale në gjyq të vepron në parashtrimin e propozimit për hapjen e

¹² Ndryshimi në proceset falimentuese mes borxhliut individual, personit fizik dhe borxhliut person juridik

¹³ Janeski A.Zoroska Kamillovska Tatjana, Gragjansko procesno pravo kniga prva paricno pravo- Praven Fakultet, Skopje, 2009, str 130.

procedurës falimentuese. Këtu veçanërisht mund të veçohet roli i tij si organ i shkallës së dytë në segmente të caktuara të procedurës falimentuese. Shkalla e dytë ku kompetencat e tijë vijnë në shprehje është mbikqyrja e ligjeve në zbatimin e procedurës falimentuese dhe kontrolli i veprimit të organeve tjera që formohen në procedurën falimentuese.

Gjykatësi falimentues ka mundësi të sjell vendime meritore të cilët direkt kanë të bëjnë me zbatueshmërinë ligjore të procedurës falimentuese, dhe në lidhje me zbatimin e mbikqyrjes së punës të organeve tjera.

Kështu që në këtë organ menjëherë pas hapjes së procedurës falimentuese koncentrohen gjitha autorizimet që i kanë pas organet e qeverisjes së borxhliut në raport me qeverisjen dhe disponimin me pasurinë që është në pronësi të borxhliut si person juridik. Me vetë hapjen e procedurës falimentuese vinë deri te koncentrimi i udhëheqjes dhe vendosjes me procedurën falimentuese në dy organet; gjykatësi falimentues dhe drejtori falimentues. Shikuar nga aspekti procesor në këtë periudhë, udhëheqja e procedurës falimentuese është e drejtuar në dy kahje;

Njëra kahje është marrja faktike e udhëheqjes së pasurisë së borxhliut nga organet e udhëheqjes së borxhliut dhe informata për gjendjen të cilën është ndërmarrja e borxhliut, a në anën tjetër rrjedh procesi i paraqitjes së kërkesave të kreditorëve që duhet të mbaron me vërtetimin e kërkesave të tyre. Mbarimi i kësaj faze të procedurës falimentuese paraqet moment kritik kur krijohen kushtet të formohet edhe këshilli i kreditorëve. Për këshillin e të kreditorëve¹⁴ që e emëron gjykatësi falimentues si dhe drejtorin falimentues mund të thuhet se janë organe të përkohshme me atë që ekziston mundësia që Kuvendi i kreditorëve në mbledhjen e parë të vendosë për ndrimin e tyre. Prej këtu mund të konstatojmë se punohet për formimin e organeve suksesive të procedurës falimentuese.

Formimi i këshillit të kreditorëve¹⁵ është i domosdoshëm dhe përbërja e tij vërtetohet me norma kogente të cilat patjetër të respektohen nga ana e gjykatësit falimentues, apo nga kuvendi i kreditorëve nëse ndrohet përbërja e tyre. Prej këtu mund të konstatojmë se flitet për formim suksesiv të organeve të procedurës falimentuese.

Organi i fundit që formohet në procedurën falimentuese, që është i lidhur me udhëheqjen e procedurës është Kuvendi i kreditorëve. Në këtë pa përjashtim hyjnë gjithë kreditorët që kanë paraqit kërkesa në masën falimentuese, magjithatë pjesëmarrja në punë dhe sjedhja e vendimeve

¹⁴ Ligji për falimentimi i RM-së neni 38

¹⁵ Gjyqi falimentues duhet të emëron anëtar të këshillit të të besuarëve në çdo rast, vetëm në rastet kur zbatohet procedurë falimentuese në vlerë më të vogël, në vlerën e të cilës masa falimentuese është deri 1.000.000 den

fitohet me të drejtën e votës. Roli i këtij organi gjithashtu drejtohet në mbrotjen e interesave të kreditorëve në procedurën falimentuese. Karakteristikë e procedurës falimentuese është se interesi i kreditorëve është vënë në më shumë shtresa. Ashtu që është e mundëshme mbrotja e intereseve nga ana e çdo kreditori veç e veç, këshilli i kreditorëve dhe në fund përmes kuvendit të kreditorëve. Kuvendi i kreditorëve në procedurën falimentuese e bartë vendimin kryesorë prej ku varet mënyra e më tutjeshme me udhëheqjen e procedurës falimentuese nga e cila edhe më tutje shprehet qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e vlerës së ndërmarrjes së borxhliut. Flitet për vendimet në veprimin e më tutjeshëm të të gjithë organeve të procedurës falimentuese si në strukturën korporative të borxhliut me atë që mundet të arrihet në zbatimin të procedurës së rëndomtë falimentuese, e cila në realitet është e ndërlidhur me materializimin e pasurisë së borxhliut dhe shpërndarjen e mjeteve të materializuara të besuarit dhe realisht do të thotë ndërprerja e borxhliut dhe fshirja nga evidence e regjistrimit tregtar. Në anën tjetër kreditorët mund të përcaktohen për riorganizimin e borxhliut¹⁶ qëdo të thotë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi e vlerës së ndërmarrjes së borxhliut në çfardo forme organizative juridike. Kjo do të thotë se kuvendi i kreditorëve është organi që është i autorizuar ta sjell vendimin bazë që ndikon në udhëheqjen me procedurën dhe ndikon drejtë për drejt në ndërmarrjen e borxhliut dhe strukturën korporative të borxhliut.

1. Gjykatësi falimentues

Gjykatësi falimentues vendosë për të gjitha çështjet e procedurës falimentuese përveç atyre për të cilët vendos këshilli i kreditorëve ose ndonjë organ tjetër të procedurës falimentuese.

-vendos për iniciimin e procedurës së paraprake për shkak të vërtetimit të ekzistimit të kushteve për hapje të procedurës falimentuese dhe e zbaton atë procedurë.

-vendos për hapjen e procedurës falimentuese

-e emëron dhe shkarkon drejtorin falimentues të përkohshëm dhe drejtorin falimentues.

-përcakton punët e nisura çka duhet të kryhen në rrjedhat e procedurës falimentuese në përputhshmëri me këtë ligj.

Gjykatësi falimentues gjithashtu është i autorizuar të vendos për gjitha çështjet e procedurës falimentuese përveç atyre që me këtë ligj vendos këshilli falimentues ose organ tjetër i

¹⁶ Kostovski D. "Stecaj i privatizacija" Tradicionalno savetovanje pravosuxha, Vrsac, 2008, str 91-95

procedurës falimentuese.

Gjykatësi falimentues kryen kontrollë ndaj punës së drejtorit falimentues dhe i jep udhëzime të domosdoshme.

-vendos për kundërshtimeve të drejtorit falimentues kundër konkluzave të sjellura

-vendos për kundërshtimet të kreditorëve, këshillit të kreditorëve dhe kuvendit të kreditorëve

Gjykatësi falimentues në raste të caktuara lejon për realizimin e disa çështjeve me rëndësi si psh. me propozim të këshillit të kreditorëve, e nëse ai nuk është formuar, me propozim të drejtorit falimentues, i lejon punët e filluara që duhet të kryhen gjatë procedurës falimentuese.

Gjykatësi falimentues e ndjek punën e këshillit të kreditorëve dhe kuvendit të kreditorëve.

-përcakton dhurata dhe kompenzim të shpenzimeve të drejtorit falimentues dhe anëtarëve të këshillit të besuarëve.

-e përcakton shumën e avancit për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së mëparshme.

-lejon pagesën ndaj kreditorëve

-sjell vendim për përmbylljen e procedurës falimentuese.

-mbykqirjen e procedurës së falimentimit deri në përfundimin e saj.

-mbykqyrjen e implementimit të planit të Ri-organizimit.¹⁷

1.1 Kundërshtimi i vendimeve të gjykatësit falimentues

Kundër vendimeve të gjyqit falimentues mund të dorëzojnë parashtesë drejtori falimentues, këshilli i kreditorëve, kuvendi i kreditorëve, dhe kreditorët e këshillit falimentues në afat prej 3-ditëprej ditës së sjelljes së vendimit. (neni 19)

Këshilli falimentues sjell vendim në afat prej 8 (tetë) ditëve prej ditës së sjelljes së vendimit.

Këshilli falimentues mundet përmes detyrës zyrtare, përmes prapsimit apo propozimit, ti ndryshon vendimet të gjykatësit falimentues apo drejtorit falimentues, nëse vërteton se janë jashtë ligjit.

2. Drejtori falimentues

Drejtori falimentues përfaqëson debitorin falimentues, ngase në procedurën e falimentimit, ky vepron në emër dhe llogari të tijë. Pozita e drejtorit falimentues në procedurë është e dyanshme, nga njëra anë është organ i procedurës falimentuese kurse nga ana tjetër ai

¹⁷ Ligji për falimentimi i RM-së neni 19

konsiderohet si përfaqësues i debitorit falimentues.

Drejtori i falimentimit si organ themelohet nga ana e gjykatësit të falimentimit. Punët e drejtorit falimentues mund ti kryej personi fizik që është i autorizuar dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar cili do të mer leje për kryerjen e punëve të drejtorit falimentues.

-Për drejtor falimentues mund të emërohet personi fizik që disponon me aftësi të duhura dhe përvoj afariste, e cila në pajtushmëri me ligjin e shoqërive tregtare është i regjistruar si tregtar individual dhe nëse i plotëson këta kushte:

-të posedoi pregaditje të lartë profesionale dhe më pak 3-vite përvoj pune.

-të jep provimin për drejtor falimentues të autorizuar dhe të ketë vërtetim për drejtor falimentues të autorizuar.

-të mos jetë i dënuar me vepër penale që e bënë të papërshtatshëm për drejtor falimentues.¹⁸

Të drejta dhe detyrimet e drejtorit falimentues janë të përcaktuar me dispozita ligjore. Drejtori i falimentimit gjatë realizimit të punëve të tij ka pozitën e personit zyrtar dhe legjitimohet me legjimitacion zyrtar që e jep Oda sipas statusit të saj. Drejtori falimentues gjatë realizimit të funksioneve të veta në procedurën e falimentimit duhet të veprojë me ndershmëri dhe ndërgjegjshmëri, nëse drejtori i falimentimit gjatë realizimit të funksioneve të veta do të shkatëjë dëm debitorit falimentues, kreditorëve ose palës tjetër të interesuar është i detyruar ta kompensojë. Punën e tij e kontrollon gjykatësi falimentues dhe këshilli falimentues të cilët në çdo moment mund të kërkojnë nga ai informacion apo raport gjatë procedurës falimentuese dhe për gjendjen e masës falimentuese. Ai mund të shkarkohet nga këshilli falimentues nëse punën e vetë nuk e kryen me ndershmëri apo pajtueshmëri me ligjin.

2.1 Marja e drejta e titullit drejtor falimentues i autorizuar

Personi që pretendon titullin drejtor falimentues i nënshtrohet provimit para komisionit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, sipas programit që e sjell Ministria e Drejtësisë.¹⁹

-Personit që e jep provimin, Ministri i drejtësisë i jep vërtetim për drejtor të autorizuar falimentues.

-Shpenzimet për mbajtjen e provimit për drejtor i autorizuar falimentues, janë në ngarkesë të personit që i nënshtrohet provimit.

-Forma dhe përmbatja e vërtetimit, si dhe mënyra e dhënjes së provimit për drejtor i autorizuar

¹⁸ Ligji për falimentimi i RM-së neni 20

¹⁹ Ligji për falimentimi i RM-së neni 25

falimentues i përshkruan ministri i drejtësisë.

Në anën tjetër, shoqëria të cilës i është dhënë autorizimi për kryerjen e punëve drejtor falimentues, evidentohet në regjistrin e shoqërive të autorizuara për kryerjen e punëve drejtor të autorizuar falimentues, të cilën e udhëheq Ministria e drejtësisë.

Me vërtetimin për evidentim në regjistrin tregtar themeluesi i shoqërisë, përveç tjerash, e dorëzon edhe vendimin e Ministrit për drejtësi i cili është i autorizuar të kryej veprimtarinë.

Shoqëria e autorizuar që ti kryej punët e drejtorit falimentues e cila me qëllim apo nga pakujdesia gjatë kryerjes së punëve drejtor falimentues do ti bën dëm borxhliut falimentues është i detyruar t'ia kompensoi dëmin e krijuar.

Shoqëria është e detyruar të sigurohet nga përgjegjësia për demin i cili ndodhë me kryerjen e punëve të drejtorit falimentues. Shoqëria obligohet dëshmin për sigurim të e dorëzon te Ministri i drejtësisë, në afat prej 7 (shtatë) ditë nga dita e sigurimit.²⁰

2.2 Kualifikimet, shpërblimet dhe shpenzimet e drejtorit falimentues

Ashtu siç qëndron tani, Ligji për Likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim përcakton vetëm kualifikimet minimale të drejtorit të rastit në falimentim, të cilat nuk janë shumë strikte. Ky është një rast tjetër ku ligji udhëzon hartimin e rregullave përmbarese për të caktuar kualifikimet e veçanta dhe procedurat e licencimit.

Në pajtim me versionin ekzistues të ligjit administratori i rastit mjafton të jetë “person kompetent, i ndershëm dhe pa konflikt të interesit.” Ky është prag shumë i ulët për një person i cili është ngarkuar me udhëheqjen e tërë procesit të falimentimit, përfshirë edhe riorganizimin ose likuidimin e disa prej shoqërive tregtare që janë seriozisht të ndërlikuara. Ka nevojë për kërkesa shtesë të cilat do të lejonin vetëm juristët më të aftë të bëhen administratorë të rasteve të falimentimit. Kështu që, ekziston nevojë urgjente për kualifikimet dhe procedurat e licencimit para se rastet e falimentimit të fillojnë të dërgohen në gjykatë.

Menjëherë pas emërimit të drejtorit të falimentimit paga dhe shpenzimet e tij paguhet me paratë e gatshme të debitorit ose nga shitjet e pronës së tij. Kur debitori nuk ka para të gatshme në dispozicion, drejtori i falimentimit paguhet nga fondi i posaçëm i krijuar veçanërisht për këtë qëllim. Kjo mbetet të zgjidhet me rregullat përmbarese që duhet theksuar se mungojnë. Në përgjithësi, drejtori duhet të paguhet në mënyrë të mjaftueshme që ajo pagë të tërheq persona kompetent. Megjithatë, procedurat ose shumat e saktë do të përcaktohen nga rregullat

²⁰ Ligji për falimentimi i RM-së neni 27

përmbarese të cilat do të krijohen në të ardhmen.²¹

2.3 Autorizimet e Drejtorit falimentues

Të drejtat dhe detyrimet e drejtorit falimentues janë të përcaktuara me dispozitat ligjore. Ai gjatë kryerjes së detyrës ka status të personit zyrtarë dhe posedon legjitimacion zyrtar që e jep Oda e drejtorëve falimentues. Drejtori i falimentimit është i autorizuar që ta përfaqëson dhe e prezenton debitorin falimentues. Përfaqësimi ka të bëjë me ato punë që kanë të bëjnë me procedurën e falimentimit dhe masën falimentuese.²² Drejtori falimentues ka në numër të kompetencave, detyrave të drejtave siç janë:

- Të merr menjëherë në posedim pasurinë e debitorit;
- Të thërret takimet e kreditorit dhe të udhëheq ato;
- Të azhurojë evidencën e kontabilitetit të debitorit deri në ditën e hapjes së procedurës së falimentimit;
- Të paraqes propozim llogarinë e shpenzimeve të procedurës falimentuese dhe të dërgojë për pëlqim te gjykatësi falimentues;
- Të fillojë dhe vazhdojë procedurat administrative që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të debitorit;
- Të filloi regjistrimin (inventarin) në afat prej 10-ditësh nga dita e emërimit, ta mbarojë në afat prej 30-ditësh dhe të përpiloi bilancin fillestar të falimentimit;
- T'i informojë të gjitha institucionet shtetërore me të cilët shoqëria tregtare ka raporte ligjore.
- Të shërbejë si përfaqësues i autorizuar zyrtarisht i pasurisë së debitorit;
- Të mbyll llogarinë bankare të debitorit dhe të hap llogarinë e veçantë të falimentimit në një gjykatë që është e lejuar nga banka;
- Të bëjë listën e kreditorëve dhe kërkesat që mund të realizohen;
- Të bëjë pagesën e kreditorëve në llogari të kërkesave të aprovuara dhe
- Të detyrojë debitorin apo përfaqësuesin e caktuar të menaxhmentit të debitorëve të paraqitet dhe të ndihmoj në marrjen e inventarit të pasurisë së debitorit.²³

Më tej, Drejtori i falimentimit është i detyruar ta rrisë vlerën e pasurisë, të mirëmbajë dhe mbrojë pasurinë, të kryejë shpejt dhe në mënyrë të bindshme zgjidhjen e rastit dhe kur është e duhur, të

²¹ Ligji për falimentimi i RM-së neni 37

²² Ligji për falimentim i R.M., neni 33

²³ Ligji për falimentimi i RM-së neni 34

udhëheq me biznesin e pasurisë.

Siç mund të shihet, të qenit Drejtor i falimentimit mund të jetë pozitë e fuqishme dhe e rëndësishme me përgjegjësi shumë të mëdha. Kompetencat e përmendura më lartë theksojnë vetëm nevojën që Drejtori falimentues të jetë person i kualifikuar dhe të ketë përgatitje arsimore në drejtësi dhe ose ekonomi.

***Vërejtje:** Kualifikimet e zakonshme për rastet komplekse të falimentimit kërkojnë diplomën në drejtësi, ekonomi ose kontabilitetit, përvojë të punës profesionale të gjatë e përcaktuar me ligj.*

2.4 Përgjegjësitë e drejtorit falimentues

Drejtori falimentues gjatë realizimit të funksioneve të veta si pjesëmarrës në procedurën falimentuese duhet të veprojë me ndershmëri dhe ndërgjegjshmëri me kujdesin që i takon një drejtori falimentues në bazë të kompetencave. Nëse gjatë ushtrimit të funksioneve të veta drejtori falimentues do të shkatojë dëm debitorit falimentues, kreditorëve ose palës tjetër të interesuar, është i detyruar ta kompensojë. Pjesëmarrësit që kërkojnë kompensimin e dëmit duhet të dëshmojnë ekzistimin e dëmit, veprimin e dëmshëm të debitorit falimentues duke u nisur në bazë të parimit të fajit të supozuar, lidhjen kauzale midis fajit dhe dëmit të shkaktuar dhe fajin e drejtorit falimentues. Drejtori falimentues përgjigjet me tërë pasurinë e vetë për dëmin qëdo ti shkaktojë secili pjesëmarrës në procedurën e falimentimit nëse nuk vepron korekt dhe sipas Kodeksit etik të drejtorëve të falimentimit dhe standardeve profesionale ose bënë shkeleje të dispozitave ligjore.

Përjashtimisht drejtori i falimentimit nuk do të përgjigjet për dëmin e shkatuar me veprim, nëse dëmi është shkaktuar nga udhëzimi i lejuar apo i dhënë nga Gykatësi falimentues. Kur kemi parasysh përgjegjësinë, drejtori i falimentimit nuk është përgjegjës personalisht për humbjet e bëra nga kreditori, ndonjë aksionar ose ortak, pasuria, apo ndonjë palë tjetër për pasojat apo dëmtimet që vijnë nga vendimet që janë marrë ose nuk janë marrë, ose për veprimet që janë bërë ose nuk janë bërë brenda fushëveprimit të detyrave të tij nëse ai i ka kushtuar kujdes dhe me detyrë profesionistit të mirë në kryerjen e detyrave të tij me kohë.²⁴

***Vërejtje:** Kjo do të thotë se drejtori falimentues nuk është përgjegjës personalisht nëse ai vepron me maturi gjatë ushtrimit të detyrave të tij si administrator dhe nëse diçka shkon keq. Me fjalë të tjera, nuk ka përgjegjësi për administratorin nëse ai vepron si person i arsyeshëm, por pasuria dëmtohet për shkak të rrethanave të caktuara si fati i keq, veprime të*

²⁴ Ligji për falimentimi i RM-së neni 26

pakontrolluara të palëve të treta etj

2.5 Shkarkimi i drejtorit

Ashtu si mund të emërohet, drejtori edhe shkarkohet. Mund të shkarkohet një drejtor dhe të emërohet një tjetër në rastet kur tregohen raste të mjaftueshme me shkrim nga:

-Gjykata, Debitori, Kreditori ose Organet tjera.

Drejtori i shkarkuar e ka për detyrë të bashkëpunojë me drejtorin e ri në dorëzimin e regjistrave, bartjen e llogarive dhe aspektet tjera të pranim dorëzimit. Edhe pse ekziston qartë në ligj se kur mundet të shkarkohet drejtori por sipas frazës “shkaqe të mjaftueshme” paraqet rastet më të vrazhda, specifike si konflikt interesash, është i njëanshëm, jo korekt dhe keqpërdor rastin.²⁵

3. Këshilli i kreditorëve

Këshilli i kreditorëve është organ mjaftë i rëndësishëm në procedurën e falimentimit. Ai përbëhet nga tre gjykatës nga të cilët njëri është kryetar i këshillit.

Për shkak të mbrotjes së interesave të të besuarëve në procedurë falimentuese, para mbatjes së kuvendit të parë të të besuarëve, drejtori falimentues me aktvendim formon këshill të kreditorëve dhe i emëron pas mbatjes sëseancës së kuvendit të parë. Këshilli i kreditorëve paraqet organ këshilldhënës/kontrollues ne procedurën e falimentimit, që ka për qëllim mbrojtjen e interesave të kreditorëve në procedurën e falimentimit. Në këshillin e kreditorëve patjetër duhet të përfaqësohen përfaqësuesit e kreditorëve të ndryshëm, kreditorët e falimentimit me kërkesa të ndryshme (të mëdha dhe të vogla). Për sa i përket përbërjes së këshillit të kreditorëve kjoi takon gjykatësit të falimentimit. Gjykatësi i falimentimit me propozim të këshillit të kreditorëve për anëtar këshilli mund të emrojë persona që nuk janë kreditorë, por që kanë aftësi profesionale të problematikës dhe mund të ndihmojë në çështjen, por pa të drejtë vote. Ky numër i këshillit të kreditorëve që e përcakton gjykatësi falimentues duhet të jetë numër tek për shkak të sjlljes së vendimeve gjatë votimit. Këshilli i kreditorëve vendos me shumicën e dy të tretave nga anëtarët present me të drejtë vote. Çdo anëtare i kreditorëve ka një votë dhe patjetër të votoj “për ose kundër” vendimit për të cilin vendos këshilli.²⁶

3.1 Të drejtat dhe obligimet e këshillit të kreditorëve

Të drejtat dhe obligimet e këshillit të kreditorëve janë të regulluara në mënyre decide me Ligjin

²⁵ Ligji për falimentimi i RM-së neni 36

²⁶ Adnan Jashari, E drejta afariste (statusore)

për Falimentimin.

-shqyrton raportet e drejtorit falimentimit për rrjedhën e procedurës së falimentimit dhe për gjendjen e masës falimentuese;

-kontrollon librat tregtarë dhe dokumentacionin e plotë që e ka marrë drejtori i falimentimit;

-lejon për llogaritjen e shpenzimeve të procedurës falimentuese dhe i përcakton punët që duhet të kryhen;

-mund të paraqes kundërshtim te gjykatësi i falimentimit;

-propozon gjykatësit të falimentimit mënyrën e shëndërrimit në para të pasurisë së debitorit;

-propozon gjykatësit të falimentimit nëse duhet të vazhdoj puna e filluar, respektivisht puna e debitorit falimentues;

-jep mendim gjykatësit të falimentimit për mungesat e arsytura të regjistrimit të pasurisë.²⁷

Këshilli i kreditorëve ka për obligim, me kërkesë të kuvendit të debitorëve, ti informjë kreditorët për rrjedhën e procedurës së falimentimit dhe për gjendjen e masës falimentuese.

Ashtu si emërohet anëtari i këshillit të kreditorëve gjyqji i falimentimit mund edhe të e shkarkojë anëtarin e këshillit të kreditorëve që bëhet përmes detyrës zyrtare apo me kërkesë të vetë anëtarit të këshillit ose të kuvendit të kreditorëve. Shkarkimi bëhet për arsye të ndryshme si mos kryerja e obligimeve të përcaktuara me dispozita ligjore dhe arsye tjera. Anëtari i shkarkuar ka të drejtë ankese kundër aktvendimit të gjykatësit të falimentimit te këshilli i falimentimit.

Për këshillin e kreditorëve mund të konstatojmë se flitet për organ të shkallës së dytë të pavarur me autorizime mjaftë të rëndësishme dhe specifike të autorizuar për procedurën falimentuese dhe nga të cilët vendime mvaret ligjëshmëria dhe zbatueshmëria e procedurës falimentuese. Edhe për kundër asaj që e formon e njejta gjykatë në të cilin vepron gjykatësi falimentues duhet të jetë i pavarur nga ndikimi i gjykatësit. Gjatë formimit të këshillit kryetari i gjyqjit duhet ta ketë parasyshtë që kryetari i këshillit dhe anëtarët të kenë njohuri për procedurën falimentuese.²⁸

4. Kuvendi i kreditorëve

Organ i fundit që formohet në procedurën falimentuese, që është i lidhur me udhëheqjen e procedurë, është kuvendi i kreditorëve. Kuvendi i kreditorëve është organ i domosdoshëm në procedurë. Në të pa përjashtim hynë të gjithë kreditorët që kanë paraqit kërkesat e tyre në

²⁷ Ligji për falimentim i RM-së neni 40

²⁸ Komentim i Ligjit për falimentim i RM-së (neni 38-44)

procedurë falimentuese, magjithatë pjesëmarrja në punë dhe sjellja e vendimeve është e kushtëzuar me fitimin e të drejtës së votës. Qëllimi bazë i formimit të këtij organi është mbrojtja e interesave të të besuarëve në procedurën falimentuese. Kuvendin e kreditorëve e thëret gjykatësi i falimentimit dhe me raste gjykatësi i afalimetimit me propozim të drejtorit të falimentimit, dhe këshillit të kreditorëve.²⁹ Numri i anëtarëve patjetër duhet të jetë tek dhe patjetër duhet të përfshihen kreditorë të ndryshëm me kërkesa më të vogla dhe më të mëdha si dhe përfaqësues të të punësuarëve. Anëtarët e kuvendit kanë të drejtë në dhurata dhe kompensim të shpenzimeve. Kuvendi është i detyruar të i njoftojë kreditorët për procedurën falimentuese dhe masën falimentuese.

Karakteristikë themelore e procedurës falimentuese është mbrojtja e interesave të kreditorëve e vënë në më shumë nivele. Ashtuqë, mundësohet mbrojtja e interesave nga ana e çdo kreditori veç e veç, këshilli i kreditorëve dhe në fund përmes kuvendit të kreditorëve. Kuvendi i kreditorëve punon në mbledhje dhe bartë vendimet më të rëndësishme të procedurës falimentuese. Ashtu që kreditorëve në kuvendin e parë raportues duhet të sjellin vendimin prej ku varet mënyra e mëtutjeshme e qeverisjes me procedurën falimentuese që shprehet për qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e vlerës së ndërmarrjes së borxhliut. Flitet për vendimet që ndikojnë për sjelljen e mëtutjeshme të të gjithë organeve të procedurës falimentuese si të strukturës korporative të borxhliut me ate që mund të vije te zbatimi i likuidimit të borxhliut apo materializimi i pasurisë së tij dhe shpërndarja e mjeteve të materializuara të kreditorëve, që do të thotë ndërprerje e borxhliut dhe fshirje nga regjistri tregtar. Anën tjetër kreditorët mund të përcaktohen për riorganizimin e borxhliut, që do të thotë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të vlerës së ndërmarrjes së borxhliut në çfardo formë organizative juridike. Në raste kur borxhliu apo kreditori propozon plan për riorganizim, kuvendi i kreditorëve në vend të vendimit që do të vazhdojë zbatimi i procedurës falimentuese, duhet të sjell vendim për pranimin e planit të dorëzuar për riorganizim. Kjo do të thotë se kuvendi i kreditorëve është organ që është i autorizuar të sjell vendime kryesore për mënyrën e mbulimit e kërkesave dhe njëkohësisht ndikon në udhëheqjen e procedurës dhe strukturën korporative të borxhliut.

Kuvendi përveç këtyre autorizimeve ka edhe rolin kadrovik e ndërlidhur me formimin e organeve në procedurë. Në këtë qasje ka mundësi të sjell vendim me cilën do të kryej ndrim të emrimit të drejtorit falimentues si dhe ndrimin e anëtarëve të këshillit të të besuarëve. Mund ti

²⁹ Adnan Jashari, E drejta afariste (statusore)

kryej edhe gjithë autorizimet e këshillit të kreditorëve në procedurë kur nuk është emëruar këshilli i kreditorëve. Anëtar i kuvendit të kreditorëve nuk mundet të zgjidhet kreditori i cili ka obligime-borxh ndaj borxhliut falimentues, ashtu që borxhi i tijë ndaj borxhliut falimentues të tejkalon një përqindë të vlerës së pasurisë që hynë në masën falimentuese. Me fjalë tjera kreditori i cili njëkohësisht është edhe në rolin e borxhliut ka obligime të papaguara që hynë në masën falimentuese nuk mund të jetë anëtar i kuvendit të kreditorëve.³⁰

4.1 Autorizimet e kuvendit të kreditorëve

Kuvendi i kreditorëve është i autorizuar në kuvendin e parë raportues.

-të formojë këshill të kreditorëve, nëse ai nuk është formuar, apo të vendos nëse këshilli i kreditorëve nga gjyqji falimentues, do të mbetet me të njëjtën përbërje apo do ta ndryshoj numrin e anëtarëve.

- kryen kontrollë në punën e drejtorit falimentues dhe e ndihmon atë.

-jep leje paraprake për gjitha pagesat dhe obligimet në para kesh dhe kontrollon tërë dokumentacionin.

- mund të parashtojë parashtesë për punën e drejtorit falimentues te gjykatësi falimentues.

- në vend të drejtorit falimentues, i cili është i emëruar nga gjyqji falimentues, të emërojë drejtor falimentues tjetër në pajtim me nenin 32 alineja 1e këtij ligji.

- të vendos për mënyrën e materializimit të pasurisë.

- të vendos a do të a do të ketë qasje drejtë pregaditjes së planit për riorganizim.³¹

Me kuvendin e kreditorëve udhëheq gjykatësi falimentues. Kuvendi i kreditorëve ka të drejtë të kërkoj nga drejtori falimentues informatë dhe raport për rrjedhjen e procedurës falimentuese dhe gjendjes dhe kërkesave të masës falimentuese, jep leje paraprake për shitjen e ndërmarrjes apo pjesë të ndërmarrjes dhe jep leje për shpërndarjen paraprake të mjeteve të grumbulluara. Vendimi i kuvendit të kreditorëve llogaritet i sjellur-aprovuar nëse për te votojnë kreditorët, ku shuma e kërkesave është në vlerë më të madhe se gjysma nga shuma e përgjithshme e kërkesave e gjithë kreditorëve me të drejtë vote.

Gjykatësi falimentues ex officio e thirrë vetëm kuvendin e parë dhe kuvendin përfundimtar. Përveç këtyre dy kuvendeve gjykatësi falimentues e thirrë kuvendin e kreditorëve atëherë kur duhet të sjellë:

³⁰ Ligji për falimentimi i RM-së (Komentim i neneve 45,46,47,48,49)

³¹ Ligji për falimentimi i RM-së neni 50

- vendim për shitjen e pasurisë të borxhliut falimentues në shitje publike për grumbullimin e ofertave me çmime më të lira nga çmimi fillestar.
- vendim se a do të bëhet shitja me ofertë publike në shitjen e dytë pa e përcaktuar çmimin fillestar
- vendim me propozim të kuvendit të kreditorëve për shpërndarjen e pasurisë së kreditorëve në rastet kur pasuria i cili hynë në masën falimentuese nuk mund të shitet,³²
- vendim me të cilin do t'i lejojnë drejtorit falimentues të ndërmer veprim të karakterit të posaçëm kur kuvendi i kreditorëve nuk është emruar apo zgjedhur.
- vendim për leje të shitjes së ndërmarrjes ose pjesë të saj blerësit i cili posedon një të pestën e kapitalit të borxhliut nën vlerën e tij.³³

³² Neni 99 alinea 8 e ligjit

³³ Komentim i nenit 104 të ligjit për falimentim

Kapitulli i dytë

INICIMI, HAPJA E PROCEDURËS FALIMENTUESE

1. Propozimi për hapjen e procedurës falimentuese

Propozimin për hapje të procedurës së falimentimit mund të bëhet me kërkesë të:

- a) kreditorit;
- b) debitorit;
- c) personave tjerë të autorizuar me ligj.

Kreditori është i autorizuar të paraqes propozim për hapjen e procedurës falimentuese, me kusht që gjykatës ti paraqes dëshmi se janë plotësuar kushtet e përcaktuara për hapjen e procedurës falimentuese.³⁴ Propozimi i kreditorit kundër borxhliut i a.q. “falimentim jo vullnetar” parashtrohet me qëllim që të kompenzohet ajo pjesë nga ajo që i ka borxh, ose thënë ndryshe inicim për restrukturim. Magjithatë në rastet më të shumta të inicimit të falimentimit janë nga ana e borxhliut, “falimentim vullnetar” që inicohet në rastet e subjekteve jo solvente, individ apo subjekt juridik.

Propozim për hapjen e procedurës falimentuese mbi pasurinë e shoqërisë tregtare, në emër të debitorit mund të paraqes secili person i autorizuar për përfaqësimin e personit juridik sipas ligjit si dhe çdo likuidues. Nëse propozimi për hapjen e procedurës falimentuese nuk është paraqitur nga të gjithë personat e autorizuar sipas ligjit, propozimi lejohet vetëm nëse paraqitësi i propozimit e bënë të arsyeshëm ekzistimin e ndonjë arsye nga arsyet e falimentimit.

Bashkë me propozimin për hapjen e procedurës falimentuese debitori duhet të ofrojë;

- vërtetim nga banka që bën qarkullimin pagesor për gjendjen e mjeteve në llogari dhe kërkesat e pa përmbushura që duhet paguar nga llogaria;
- raportin për pasurinë me dëshmi për pasurinë;
- vërtetim nga organet kompetente për gjendjen në lidhje me tatimet, kontributet dhe obligimet tjera.³⁵

³⁴ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 51 al.1

³⁵ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 51 al.9

Te Tregtari individual propozimin për hapjen e procedurës falimentuese, e paraqet individualisht vet tregtari individual. Propozimi për hapjen e procedurës falimentuese mund të tërhiqet deri kur hapja e procedurës falimentuese shpallet në tabelën e shpalljes, respektivishtë deri në marrjen e vendimit për hedhjen poshtë ose për refuzimin e propozimit. Nëse propozuesi e tërheq propozimin për hapjen e procedurës falimentuese, gjykatësi i falimentimit do të ndërpresë procedurën. Shpenzimet e krijuara të procedurës në këtë rast i bartë propozuesi.

2. Procedura paraprake

Procedura paraprake ka për qëllim verifikimin e ekzistimit të shkaqeve për hapjen e procedurës falimentuese, apo nëse nuk ekzistojnë shkaqe, propozimi për hapjen e procedurës falimentuese refuzohet. Me dorëzimin e propozimit për hapjen e procedurës falimentuese, gjykatësi i falimentimit fillimisht kontrollon, nëse i njëjti është në rregull dhe se propozuesi i ka dërguar të gjitha faktet-dëshmitë e duhura. Nëse konstaton se propozimi është jo i plotë ose nuk janë paraqitur të gjitha faktet-dëshmitë e duhura në pajtim me dispozitat ligjore, do t'ia kthen propozuesit të njëjtën që ta rregulloj në afat prej 8-ditë. Nëse propozuesi në afatin e dhënë nuk e rregullon propozimin, gjykatësi i falimentimit do të nxjerrë aktvendim me të cilën kërkesën do ta hedh poshtë. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Gjykatësi falimentues do të nxjerrë aktvendim për inicimin e procedurës paraprake, nëse propozimi për hapjen e procedurës falimentuese është në rregull. Me vendimin për ngritjen e procedurës paraprake gjykatësi i falimentimit do të caktojë edhe datën për mbajtjen e seancës për shikimin e kushteve për hapjen e procedurës falimentuese. Nëse propozimi për hapjen e procedurës së falimentimit është paraqitur nga kreditori, së bashku me aktvendimin për ngritje e procedurës paraprake, debitorit do ti dorëzohet propozimi. Në afat prej 8-ditësh gjykatësi i falimentimit është i detyruar të veprojë ndaj propozimit për hapjen e procedurës. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë. Një kopje e aktvendimit i dërgohet Regjistrisë Qëndrore.³⁶ Propozuesit është i detyruar ti sigurojë shpenzimet procedurale, në lartësi që do ta caktojë gjykatësi i falimentimit, (Gjykatësi përcakton shumën e avancimit sipas Rregullorës për avanse në procedurë falimentuese të cilën e miraton Ministri i Ekonomisë). Nëse propozuesi nuk ofron avansë në afatin e caktuar, gjykatësi i falimentimit me vendim e hedh poshtë propozimin. Nëse procedura e falimentimit hudhet poshtë, shumën e avansuar hynë në shpenzimet e falimentimit.

³⁶ Ligji për Falimentim i RM-së, neni 54

3. Hapja e procedurës së falimentimit

Procedura falimentuese mund të hapet vetëm nëse ekzistojnë arsyet. Arsyet e hapjes së procedurës falimentuese janë;

- paaftësia për pagesë apo jolikuiditet, dhe ekzistenca e pamundësisë së ikjes së likuidimit dhe mbingarkesa me borxhe.

Paaftësia paguese si arsye e përgjithshme e hapjes së procedurës falimentuese ekziston atëherë kur borxhliu nuk mund ti paguan obligimet e veta në para të arritura në afat prej 60-ditësh prej ditës së arritjes që nënkupton me arritjen e obligimeve llogaritet vendim gjyqësor i realizuar. Mbingarkesa me borxhe nënkupton situatën kur pasuria e borxhliut nuk i mbulon obligimet e tija apo obligimet ekzistuese.

Ndërsa rasti i dytë ka të bëjë atëherë kur borxhliu nuk mund të i mbulojë borxhet-obligimet në para dhe në këta raste mund të propozojë hapje të procedurës falimentuese.

Procedura e falimentimit fillon me paraqitjen në gjykatë të kërkesës së njëres prej palëve (debitor, kreditor). Me këtë rast Gjykatësi i falimentimit duhet ta shqyrtoj kërkesën brenda 30-ditëve. Për të vendosur nëse procedura do të hapet ose jo, gjykata cakton një administrator të përkohshëm falimentimi-ekspert (nga lista e licensuar në gjykatë) i cili në afat prej 15 ditëve do të vendos nëse debitori në të vërtetë është i paaftë për pagim. Me këtë rast gjykatësi i falimentimit në afat prej 3 ditëve duhet të mer vendim për hapje apo refuzim të propozimit për hapje të procedurës falimentuese. Kunder këtij vendimi lejohet e drejta e ankesës në këshillin e falimentimit.³⁷

Ligji për falimentim parasheh dy lloji procedurash për biznesin:

-Likuidimi nënkupton procesin nëpërmjet të cilit debitori nuk mund të vazhdojë aktivitetin e tij dhe nëpërmjet shpërndarjes së pasurive të tij likuidon debitorët, dhe

-Riorganizimi është proces nëpërmjet të cilit debitori apo administrator i falimentimit nëpërmjet pararqitjes së një plani riorganizimi synon ruatjen e aktivitetit dhe likuidimin e kreditorëve në bazë të një afati kohor dhe plani ripagimi.

Pas shqyrtimit të kërkesës nga gjykata do të vendoset nëse procedura do të hapet ose jo dhe drejtimin që do të marrë, drejt likuidimit apo organizimit. Nëse procedurat hapen prej njërit nga

³⁷ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 64 al.8

mënyrat e përmendura më sipër, gjykata do të vendos një administratë falimentimi i cili do të marrë në posedim pasurinë dhe do të kryej gjitha detyrat.

Afatet e vazhdimet të procesit kur procedura është e hapur për likuidim janë; 90-ditë paraqitja e pretendimeve nga kreditorët, 60-ditë për verifikimin e pretendimeve dhe paraqitjen e raportit përfundimtar nga administrator i falimentimit. Pastaj vazhdon me shitjen e asetve dhe shpërndarjen e pagesave tek kreditorët sipas rradhës së preferimit të parashikuar.

Në raste kur procedura hapet për riorganizim, debitorit i lihet një afat i arsyeshëm nga gjykatat për paraqitjen e një Plan-Riorganizimi. Pas paraqitjes së planit parashikohet zhvillimi i mbledhjeve të kreditorëve për verifikimin e pretendimeve, mbledhje për votimin e planit dhe mbledhje përfundimtare, afati midis të cilave nuk duhet të jetë më shumë se një muaj.

3.1. Procedura për hapjen e procedurës falimentuese përfshin:

- Dorëzimin e kërkesës;
- Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe përmbajtja do të përcaktohet me rregullat përmbarese;
- Dokumentet shtesë- kërkesa shoqërohet me deklaratë e cila thotë:
- organi udhëheqës është pajtuar për parashtrimin e kërkesës dhe debitori është josolvent, pra nuk është në gjendje të paguaj borxhet dhe detyrimet.
- Gjykata- e njofton regjistrin e biznesit dhe regjistrin e pengut për hapjen dhe mbylljen e rastit, dhe e regjistron kërkesën.

3.2. Përmbajtja e vendimit për hapjen e procedurës

Vendimi për hapjen e procedurës falimentuese duhet të përmbajë:

Të dhënat bazë ku përfshihet emri, mbiemri dhe vendbanimi e debitorit në rastin e personave fizikë, emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personit juridik;

- vendimin për emërimin e drejtorit falimentues të falimentimit si dhe të dhënat gjenerale për drejtorin falimentues;
- afatin për depozitimin e kërkesave-pretendimeve nga kreditorët e debitorët e falimentimit (jo më pakë se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë);
- orën e saktë kur është hapur procedura falimentuese;
- detyrimin e debitorëve që detyrimet e tyre t'ia përmbushin administratorit të falimentimit dhe jo debitorit të falimentimit;
- thiren kreditorët të i paraqesin kërkesat e tyre në afat jo më të shkurtë se 15-ditë e as më shumë se 30-ditë;

-afatin për zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për raportim që duhet bëhet brenda 45-ditësh jo më teper se 90-ditë nga shpallja e vendimeve;

-afatin për zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për verifikim;

-urdhërin për publikimin e vendimit në faqen zyrtare të gjykatës, në internet dhe organet tjera të parapara me ligj.³⁸

Vendimi për hapjen e procedurës falimentuese i dërgohet; kreditorit, debitorit, bankës, prokurorit publik, regjistrin publik në cilët është e regjistruar pasuria e borxhliut.

4. Procedurat falimentuese ne R.M. dhe kohezgjatja e tyre

Në këtë pjesë të punimit do të jap një pasqyrë për numrin e procedurave falimentuese dhe ligjet që zbatohen në R.M. për periudha të caktuara dhe sa është kohëzgjatja e tyre prej momentit të hapjes së procedurës falimentuese e deri te mbyllja e tyre³⁹. Në R. e Maqedonisë në fushën e falimentimit janë zbatuar tre ligje, edhe ate:

- Ligji për barazim të dhunshëm, falimentim ose likuidim⁴⁰

- Ligji për falimentim prej 1997⁴¹ dhe

- Ligji për falimentim prej 2006⁴² me ndryshime dhe plotësime të shpallur me fletën zyrtare të R.M. nr 126/2006, 84/2007, 47/2011, 79/2013, 164/2013, 29/2014, 98/2015 dhe 192/2015.

Janë përdorur këta tre ligje sepse një procedurë falimentuese që ka filluar me të njejtin ligj duhet të përfundon me po atë ligj. Nga kjo rrjedh se Ligji i fundit për falimentim⁴³ është zbatuar vetëm për procedurat që janë hapur pas hyrjes në fuqi të tijë. Në bazë të të dhënave nga Njësia për falimentim pranë M. së Ekonomisë të R.M.⁴⁴, procedurat falimentuese në vijim në R.M. janë:

TABELA -1 Procedurat falimentuese në vijim bazë ligjeve

Proc. Falimentuese në vijim sipas ligjeve	2008	2009	2010
Ligji për barazim të dhunshëm, falimentim dhe likuidim (1989)	34	23	15

³⁸ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 69, 71

³⁹ Të dhënat e prezentuara janë të dhëna oficiale të siguruar nga Njësia-Sektori për falimentin i M. së Ekonomisë të R.M.

⁴⁰ Shpallur në F. Zyrtare të R.M. nr 84/89

⁴¹ Shpallur në F.zyrtare të R.M. nr 57/97

⁴² Shpallur në F.zyrtare të R.M. nr. 34/06

⁴³ Shpallur në F.zyrtare të R.M. nr 34/06

⁴⁴ Informat nga M. e E së R.M. shkurt, 2011

Ligji për falimentim 1997	190	159	142
Ligji për falimentim 2006	137	156	201
Gjithsej-Totali	361	338	358

Me Ligjin për barazim të dhunshëm, falimentim ose likuidim (1989), në vitin 2008 janë udhëhequr 34 procedura falimentuese, më vitin 2009 janë udhëhequr 23 procedura falimentuese, ndërsa më vitin 2010 janë udhëhequr 15 procedura që janë në procedurë dhe ende të pambyllura⁴⁵ Me Ligjin për falimentim të vitit 1997, në vitin 2008 janë udhëhequr 190 procedura falimentuese, më vitin 2009 janë udhëhequr 159 procedura falimentuese, ndërsa më vitin 2010 janë udhëhequr 142 procedura. Me Ligjin për falimentim të vitit 2006, në vitin 2008 janë udhëhequr 137 procedura falimentuese, më vitin 2009 janë udhëhequr 156 procedura falimentuese, ndërsa më vitin 2010 janë udhëhequr 201 procedura.

Nga të dhënat e prezentuara në tabelë konstatohet se ka zvoglim të procedurave falimentuese sipas ligjeve të vitit 1989 dhe ligjit për falimentim të vitit 1997, që një kohë të gjatë nuk hapen procedura të reja falimentuese, por vetëm veprohet për procedurat e hapura të cilat gradualisht mbyllen, dhe për këtë shkak egziston zvoglimi i procedurave falimentuese përmes këtyre ligjeve.

Në Tabelën 2 do ti japim të dhënat për mbylljen e procedurave falimentuese në 2008, 2009, dhe 2010 përmes tre ligjeve që janë në zbatim, dhe më pas përmes karahasimit me tabelën nr-1 të procedurave falimentuese në vijim, do të vijmë në përfundim se me Ligjin për falimentim prej 2006, që ishte në zbatim, hapen procedura të reja, të njejtat nuk mbyllen gjatë vitit që janë hapur pasi duhet kohë më e gjatë për mbylljen e tyre.

TABELA -2 Mbyllja e procedurave falimentuese sipas ligjeve në zbatim

Mbyllja e Proced. Falim sipas ligjeve në zbatim	2008	2009	2010
Ligji për barazim të dhunshëm-falim dhe likuidim	5	7	8
Ligji për falimentim 2007	29	27	18
Ligji për falimentim 2006	59	62	62
Gjithsejt-Totali	93	96	108

⁴⁵ Të dhënat nga kjo tabelë janë përfundimisht me 31.12.2010

Nga të dhënat në tabelë vërehet se gradualishtë ka rritje të mbylljes së procedurave falimentuese të ligjeve në fuqi. Më 2010 vërehet rritja graduale e mbylljeve të procedurave falimentuese që udhëhiqen përmes Ligjit për barazim të dhunshëm, falimentim dhe likidim, a arsyeja për këtë rritje është se duke pasur parasysh se këta procedura janë hapur para 12-13 vitesh prej kur fillon të ndërpritet zbatimi i Ligjit për barazim të dhunshëm, falimentimi dhe likuidimi me sjelljen në fuqi të Ligjit për falimentim prej 1997, pastaj pas një kohe të gjatë është logjike që të mbyllen procedurat falimentuese të hapura sipas këti ligji. Nëse analizojmë të dhënat mes tabelës 1 dhe 2 mund të konstatojmë se gjatë 3-viteve më shumë hapen procedura falimentuese se sa mbyllen. Psh. më vitin 2010 në vijim janë 201 procedura falimentuese, ndërsa janë mbyllur 82 procedura falimentuese, po të njejta raporte kemi edhe 2008 dhe 2009. Me aprovimin e Ligjeve për falimentim prej 2006 qëllimi bazë ishte shkurtimi i kohëzgjatjes së procedurave falimentuese që prej hapjes e deri te mbyllja të mos zgjasë më shumë se 6-gjashtë muaj, del se këta vlerësime në praktikë vështirë se realizohen.

TABELA -3 Procedurat falimentuese në vijim bazë të Ligjit për falimentim të vitit 2006 me ndryshime dhe plotësime.⁴⁶

Ne gjyqjin themelorë të Tetovë	2011	2012	2013	2014	2015
Procedura të hapura	205	180	200	246	155
Procedura të mbyllura	205	180	200	246	155

Me Ligjin për falimentim të vitit 2006 në vitin 2011 janë udhëhequr 205 procedura falimentuese, në vitin 2012 janë udhëhequr 180 procedura falimentuese, më vitin 2013 janë udhëhequr 200 procedura, në vitin 2014 janë udhëhequr 246 procedura falimentuese, ndërsa në vitin 2015 janë udhëhequr gjithësej 155 procedura falimentuese. Të njejtat procedura të hapura në këto vite, njëkohësisht edhe janë mbyllur po në të njejtin vit.

Nga të dhënat e prezentuara në tabelë konstatohet se Ligji për falimentim i vitit 2006 me ndryshime dhe plotësime të shpallur ne fletën zyrtare të R.M. nr 126/2006, 84/2007, 47/2011, 79/2013, 164/2013, 29/2014, 98/2015 dhe 192/2015 ka aritur efikasitet më të lartë në krahasim

⁴⁶ Të dhëna statistikore na Gjyqji Themelorë i Tetovës, më date 02.12.2016

me ligjet e mëparëshme duke marrë parasysh se të gjitha procedurat e hapura, në të njejtin vit edhe kanë perfunduar-mbyllur.

4.1. Procedurat falimentuese në gjykatat e R.M në bazë Ligjit për falimentim të 1997

Nr.rend	Gjygji Themelor	2008	2009	2010	Shkalla e rritjes mesatare
1	Shkupi	103	85	72	-15.05
2	Kumanova	24	24	25	2.08
3	Velesi	9	7	5	-22.22
4	Struga	15	13	10	-16.67
5	Manastiri	8	0	0	-50.00
6	Strumica	6	6	5	-8.33
7	Koçani	6	3	3	-25.00
8	Shtipi	8	8	5	-18.75
9	Gostivari	2	2	3	25.00
10	Prilepi	1	0	0	-18.75
11	Tetova	2	2	2	-50.00
12	Ohri	1	0	0	0.00
	Gjithsej	197	162	142	-13.96

Nga të dhënat në tabelë vërehet se Gjygji Themelor 2, ka më shumë lëndë të procedurave falimentuese poashtu edhe më shumë lëndë të pa zgjidhura sipas Ligjit për falimentim prej 1997, ndersa në Gjygjin Themlor në Koçani për periudhën 2008-2010 ka zvoglim të lëndëve falimentuese me 25%. Zvoglimi mesatar të procedurave falimentuese sipas Ligjit për falimentim është -13.96-vjetore, edhe ate më 2009 janë mbyllur 35 procedura falimentuese, ndërsa 2010 janë mbyllur 20 procedura falimentuese.

Shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit në nivel më të gjërë-global janë trajtuar në pjesën e dytë të punimit, ku janë potencuar faktorët-shkaqët të cilët kontribuojnë në problemet e subjekteve afariste të cilët në rastet e shumta përfundojnë me hapjen e procedurës falimentuese.

Shkaqet e hapjes së procedurës falimentuese në Maqedoni janë të rregulluara me Ligjin për falimentim. Falimentimi ndërmeret kur borxhliu falimentues është i paafte të paguan

obligimet ndaj kreditorëve. Arsyeja kryesore e hapjes së procedurës falimentuese është jolikuiditeti i subjektit afarist. Nga kjo kuptojmë çdo situatë që ndërlidhet me pamundësinë permanente të subjektit afarist ti mbulon obligimet e veta ndaj kreditorëve mund të definohet si jolikuiditet ose si arsye të hapet procedura falimentuese.⁴⁷

Pra si shkaqe më të shpeshta për hapjen e procedurave falimentuese ndaj subjekteve juridik ne RM mund të përmendim:

- jolikuiditeti,
- mbi ngarkesë me borxhe,
- vlerësim i gabueshëm i aftësisë kreditore,
- mos arkëtimi i kërkesave.

4.2.Procedurat falimentuese në gjykata në bazë Ligjit për falimentim të 2006

Nr.rend	Gjygi Themelor	2008	2009	2010	Shkalla e rritjes mesatare
1	Shkupi	76	85	98	14.47
2	Kumanova	11	10	21	45.46
3	Velesi	8	7	6	-12.50
4	Struga	3	8	7	66.67
5	Bitoli	6	7	6	0.00
6	Strumica	7	7	10	21.43
7	Koçani	5	6	11	60.00
8	Shtipi	3	4	6	50.00
9	Gostivari	5	8	15	100.00
10	Prilepi	10	10	11	5.00

⁴⁷ Kostovski, D “Komentari za zakonot za stečaj”

11	Tetova	2	4	5	75.00
12	Ohri	1	0	5	200.00
	Gjithsej	137	156	201	23.36

Nga tabela mundë të konstatojmë se se Republika e Maqedonisë sipas Ligjit për falimentim prej 2006 ku në mënyrë kontinuele kemi rritje të numrit të hapjes së procedurave falimentuese, edhe ate më 2008 ka gjithësej 137 lëndë, më 2009 gjithësej 156 lëndë dhe më 2010 ka 101 lëndë të falimentimit. Edhe përmes këti Ligji lëndë më shumë ka gjyqji Themelor Shkupi-2, thujse 1/2 nga numri i përgjithshëm i lëndëve.

TABELA E GRUPEVE TE DREJTOREVE FALIMENTUES TE SHPERNDAR SIPAS
NUMRIT TE PERGJITHSHEM TE LENDEVE

Nr.rend	Drejtoret e falimentimit	Vendi	Nr. i lëndëve në vijim	Nr. i lëndëve në përfundim	Nr. i përgjithshëm i lëndëve	Shkalla e mbylljeve
1		Shkupi	32	2	34	5.88
2		-II-	17	3	20	15.00
3		-II-	13	5	18	27.78
4		-II-	15	3	18	16.67
5		-II-	15	3	18	16.67
6		-II-	17	1	18	5.56
7		Gostivari	13	3	16	18.75
8		Shkupi	14	1	15	6.67
9	Mbi 16 lëndë		136	21	157	13.38
10		Kumanova	12	2	14	14.29
11		Strumica	13	-	13	0.00
12		Shkupi	11	2	13	15.38
13		-II-	12	1	13	7.69
14		-II-	9	3	12	25.00
15		-II-	6	6	12	50.00
16		Kumanova	9	3	12	25.00
17		Shkupi	10	2	12	16.67
18		-II-	3	8	11	72.73
19		Strumica	10	1	11	9.09

20	Prej 11-15 lëndë		95	28.	123	22.76
21		Prilepi	8	2	10	20.00
22		Shkupi	4	5	9	0.00
23		-II-	7	1	8	12.50
24		-II-	10	-	10	12.50
25		Struga	8	-	8	0.00
26		Strumica	7	1	8	12.50
27		Shkupi	4	3	7	42.86
28		Koçani	6	1	7	14.29
29		Kratova	3	3	6	50.00
30		Shkupi	3	3	6	50.00
31		-II-	3	3	6	50.00
3233		Prilep	2	4	6	66.67
34		Prilep	1	5	6	83.33
35		Prilep	1	5	6	50.00
36	Prej 6-10 lëndë		69	34	103	33.01
37		Tetovë	4	1	5	20.00
38		Shtip	5	-	5	0.00
39		Struga	5	-	5	0.00
40		Manastir	1	3	4	75.00
41		Gostivar	4	-	4	0.00
42		Shkupi	4	-	4	0.00
43		-II-	3	1	4	25.00
44		Struga	1	3	4	75.00

45		Tetovë	-	3	3	100.00
46		Shtipi	3	-	3	0.00
47		Veles	3	-	3	0.00
48		Ohri	3	-	3	0.00
49		Manastir	3	-	3	0.00
50		Manastir	1	2	3	66.67
51		Prilep	-	3	3	100.00
52		Shkupi	-	2	2	50.00
5354		Shtip	2	-	2	0.00
55		Veles	2	-	2	0.00
56		Manastir	1	1	2	100.00
57		Struga	1	1	2	50.00
58		Tetovë	2	-	2	0.00
59		Shtip	2	-	2	0.00
60		Shkup	2	-	2	0.00
61		Ohri	1	1	2	50.00
62		Veles	1	-	1	0.00
63		Shkup	1	-	1	0.00
64		Veles	1	-	1	0.00
65		Shtip	-	1	1	100.0
66		Shkup	1-	-	1	0.00
67		Ohri	-	1	1	100.00
68		Shkup	-	1	1	100.00
69		Manastir	1	-	1	0.00

70		Veles	1	-	1	0.00
71	Prej 1-5 lëndë		58	25	83	0.00
72		Shkupi	0	0		0.00
73		Shkupi	0	0		0.00
74		Manastir	0	0		0.00
75		Velesi	0	0		0.00
76		Manastir	0	0		0.00
77		Kumanova	0	0		0.00
78		-II-	0	0		0.00
79		Shkupi	0	0		0.00
80		Manastir	0	0		0.00
81		Velesi	0	0		0.00
82		Gjevgjelia	0	0		0.00
83	Pa asnjë lëndë					0.00
	Totali		358	108	466	23.18

5. Rastet në të cilat procedura e hapur falimentuese nuk realizohet

Nëse vërtetohet së pasuria e debitorit që do të kishte hyrë në masën falimentuese nuk është e mjaftueshme as për mbulimin e shpenzimeve për atë procedurë ose është një vlerë e vogël-jo e rëndësishme, gjykatësi i falimentimit, realizon procedurë paraprake, me përjashtim nëse propozimi është inicuar nga debitori falimentus ose likuidatori ⁴⁸. Pas realizimit të procedurës paraprake gjykatësi i falimentimit do të marrë aktvendim për hapjen dhe mbylljen e procedurës falimentuese, në atë rast procedura falimentuese nuk do të zhvillohet. Aktvendimi shpallet në ‘‘Gazetën Zyrtare’’ të Republikës së Maqedonisë. Propozuesi që ka propozuar hapjen e procedurës falimentuese mund nga secili person, ose me përgjegjësi për paraqitjen e propozimit jo në kohë për iniciimin e procedurës falimentuese, të kërkojë kompensim për shumën e avancuar dhe dëmin e pasur. Nëse konstatohet se pasuria e debitorit është e pamjaftueshme, gjykatësi i falimentimit do të nxjerrë aktvendim për iniciimin e procedurës për shndërrimin në para të pasurisë dhe mjetet e fituara do ti përdor për përmbushjen e shpenzimeve të krijuara të procedurës falimentuese, e nëse ka tepër do ti derdh në buxhetin e shtetit.⁴⁹

Procedurën për materializimin e kapitalit e zbaton gjykatësi i përkohshëm falimentues në afat jo më shumëse 30-ditë. Materializimi kryhet me grumbullimin e ofertave të mbyllura, me marrëveshje direkte dhe shpallje publike. Me mbarimin e procedurës së materializimit të kapitalit dhe mbulimin e shpenzimeve, gjykatësi falimentues sjell vendim për hapjen dhe mbylljen e procedurës falimentuese dhe urdhëron fshirjen e borxhliut nga regjistri ku është regjistruar. Pra, nga kjo kuptojmë se procedura falimentuese nuk duhet të zbatohet në rastet kur borxhliu nuk ka kapital, apo kapitali që ka hyrë në masën falimentuese është i parëndësishëm. Kundër aktvendimit, kreditorët kanë të drejtë në ankesë të veçantë në këshillin falimentues në afat prej 8-ditësh nga dita e shpalljes në Gazetë Zyrtare.⁵⁰

Ekzistojnë dy arsye për këtë qëndrim. E para se zbatimi i procedurës falimentuese çdo herë nxit shpenzime të mëdha të lidhura para aktivizimit të a.q. falimentimi administrativ ose organet e procedurës falimentuese dhe e dyta nuk ekzistojnë kushte që të zbatohet procedura falimentuese nëse nuk sigurohen mjetet për mbulimin e shpenzimeve të procedurës falimentuese.

⁴⁸ Ligji për falimentim i R.M. neni 68 al 1.

⁴⁹ Neni 98 al.5

⁵⁰ Ligji për falimentim i R.M. neni 68 al 4.

PRAKTIKA GJYGJËSORE

RASTI-I



Hapja dhe mbyllja e njëkohëshme e procedurës falimentuese

Lënda: Propozim për hapje të procedurës falimentuese

Parashtrues: Shoqëria për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP Sh.P.K.export-import, Rr. Dervish Cara nr-51-1, me NP 6816703.

Propozim për hapje të procedurës falimentuese

Propozimin për hapje të procedurës falimentuese parashtruesi e parashtron në bazë të nenit 5 të Ligjit për falimentim. Si arsye e hapjes së procedurës falimentuese është paaftësia e pagesës së obligimeve të arritura (jo likuiditeti) të Shoqërisë.

Fakte: Vërtetimi për bonitet nga Kredit Banka AD, Shkup, HALLKBANKA AD Shkup dhe informata nga R.Q. i R.M.

Në këtë gjendje në bazë të nenit 5 alineja 1, 2 dhe 4 dhe nenit 51 alineja 1 dhe 9 nga Ligji për falimentim, kur borxhliu i përbush kushtet për hapjen e procedurës falimentuese paaftësia për pagim (jo likuid) i shoqërisë, i propozojmë gjykatësit pas vërtetimit të shkaqeve për hapjen e procedurës falimentuese të sjell këtë:

Vendim

PRANOHET propozimi për procedurën falimentuese parashtruar nga drejtori Shoqërisë për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K.export import Tetovë.

HAPET procedura falimentuese mbi debitorin Shoqëria për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K.export-import Tetovë me N.P. 6816703 dhe e njëjta nuk realizohet dhe

MBYLLET për shkak mos ekzistimit të pasurisë së debitorit.

Fakte:

1. Fletëpagesa në vlerë prej 480.00 denarë
2. Fletëpagesë në vlerë prej 20.000.00 denarë.
3. Vendim për ndërprerje të punës së Shoqërisë dhe inicimi i procedurës falimentuese.
4. Llogaria rrjedhëse nga R.Q. i R.M.
5. Deklaratë nga themeluesit të vërtetuara në Notar
6. Vërtetim për bonitet nga Pro Kredit Banka Sh.A. Shkup, HALBANKA SH.A. Shkup
7. Vërtetim nga Depozitari Qëndror i letrave me vlerë Sh.A. Shkup

8. Vërtetim për dhënje informate nga R.Q. Regjistri i Pengut.
9. Njoftim nga Regjistri Qëndrorë i R.M. Zyra regjistruese regjionale, Shkup
10. Vërtetim nga Ministria e punëve të brendëshme
11. Vërtetimi për pasuri- A.K.P. Shkup (Kadastru)
12. Vërtetim nga Komuna e Tetovës
13. Vërtetim nga D.H.P, Drejtorija Regjionale Tetovë (Departamenti i të hyrave publike)

Sqarim: Nga të gjitha këto institucione jepen dokumente të nevojshme me kërkesë të gjyqit për gjendjen obligimet, pasurinë e shoqërisë që do ti bashkëngjesin në vijim.

Në llogarinë rrjedhëse të shoqërisë tregëtare jepen të dhëna të subjektit si emri, lloji i subjektit në regjistrim, dita e themelimit, statusi afarist, lloji i pronësisë, N.P,T. llogaria rrjedhëse, prejardhja e kapitalit, madhësia, forma organizative, regjistri kompetent dhe kryegjësja bazë–deponim jomonetar në vlerë prej 32000.00 denarë.

Pronarët:

1. Davor Nastevski- Drejtor i autorizuar
2. Shoqëria për menaxhment afarist dhe shërbime konsultante-KAMENIMOST HOLLDING GRUPA –Shkup.



Këshilli i bashkëpjesëmarrësve të Shoqërisë për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K. export-import Tetovë, në mbledhjen e mbajtur më 23.12. 2014 miraton:

Vendim

1. Përshkak jolikuiditetit/josolvent, apo pamundësisë për përmbushjen e obligimeve në periudhë më të gjatë, si dhe përkeqësimi i veprimtarisë me bllokimin e xhirollogarisë në bankat afariste, Shoqëria për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K. export import Tetovë, të pushoi me punë afariste..
 2. Obligohet drejtori i shoqërisë të iniciojë propozim për inicim të procedurës falimentuese pranën gjyqit kompetent-Tetovë Shoqëria për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K. export import Tetovë, të pushoj së ekzistuari.
 3. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe e njëjta të realizohet.
- Pas vendimit të bashkëpjesëmarrësve për propozimin për hapjen e procedurës falimentuese pason Deklarata e pronarëve të Shoqërisë për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP

SH.P.K. export import Tetovë.



Deklaratë

Deklarojë me përgjegjësi morale, materiale dhe penale se Shoqëria për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K. export import Tetovë, nuk ka pasuri që do të përfaqësonte bazë, ose masë falimentuese për përmbushjen e shpenzimeve të procedurës falimentuese si dhe obligimet e arritura ndaj kreditorëve.

Deklarat jepen nga të dy pronarët e nënshkruar Davor Nastesvki dhe Shoqëria për menaxhment afarist dhe shërbime konsultante-KAMENIMOST HOLLDING GRUPA –Shkup.



Gjygji Themelor në Tetovë si gjygj falimentues i shkallës së parë më 15.01.2015 duke vepruar në bazë të propozimit të parashtruesit Davor Nasteovski- Drejtor i autorizuar sjell:

Vendim

Obligohet parashtruesi, ndaj borxhliut Shoqërisë për transport, tregëti dhe shërbime OIL GRUP SH.P.K. export import Tetovë, në emër të avancit për përmbushjen e shpenzimeve të procedurës paraprake të paguaj shumën prej 20.000.00 denarë në afat prej 8-ditësh në llogarinë depozitare pranë këtij gjygji.

Arsyetim

Para Gjygjit Themelor në Tetovë si gjygj falimentues i shkallës së parë parashtruesi në cilësinë e drejtorit parashtror propozim për procedurë falimentuese dhe e njëjta procedurë të **hapet dhe mbyllet menjëherë** për shkak mos pasjes së kapitalit, bazuar në nenin 68 të Ligjit për falimentim.

Gjygji duke vepruar në bazë të propozimit dhe në bazë të nenit 54 të ligjit për falimentim vlerësoi se propozimi është i rregullt dhe se parashtruesi i ka paraqitur të gjitha faktet e nevojshme që të mund të veprojnë në bazë të tyre, dhe në këte kontekst gjygji në pajtim me nenin 53 nga L.F. e obligon parashtruesin e kërkesës për pagesën në fjalë-avans në afat prej 8-ditësh për udhëheqje të procedurës paraprake.



Gjygji Themelor në Tetovë me Gjykatësin falimentues më 30.01.2015 sjell;

Vendim

I

-Për udhëheqje të procedurës paraprake për përcaktimin e shkaqeve të hapjes së procedurës falimentuese parashtruar nga parashtruesit.

II

Përcaktohen masat e mëtutjeshme për sigurim:

- Për parçaktimin e drejtorit falimentues të përkohshëm

-Drejtori falimentues i përkohshëm obligohet të mbron pasurinë e borxhliut, të vazhdon me udhëheqjen e ndërmarrjes së borxhliut deri në sjelljen e vendimit për hapje të procedurës falimentuese, të bën regjistrim dhe të testojë se borxhliu ka pasuri dhe nga pasuria a mund të krijohet masa falimentuese, me propozim si të përmbushen shpenzimet e procedurës falimentuese dhe si të përcaktohet person i ekspert nga lëmia ekonomike.

- Obligohet drejtori falimentues i përkohshëm të dorëzojë raport për gjendjen.

-Thret seancë për shkak arsytim të propozimit për hapje të procedurës falimentuese të 19.03.2015 në 11-orra në Gjygin Themelor Tetovë.

Vendimi të shpallet në tabelën e shpalljeve të gjyqit dhe në F.Zyrtare të R.M.si dhe të dorëzohet në R.Q.të R.M. filiala Tetovë. Kundër këtij vendimi të masës për siguri nuk lejohet ankesë e posaçme.

Arsytim

Drejtori parashtror propozim për procedurë falimentuese dhe të gjitha dokumentet e nevojshme në bazë të Ligjit për falimentim.

Gjygi duke vepruar në bazë të propozimit dhe në bazë të nenit 54 të ligjit për falimentim vlerësoi se propozimi është i regullt dhe jnaë plotësuar kushtet për hapje të procedurës paraprake.

Gjygi sipas detyrës zyrtare përcakton drejtor të përkohshëm falimentues deri në sjelljen e vendimit në bazë të parashtrësës për hapje të procedurës falimentuese me qëllim pengimi të mos ndodhin ndryshime në statusin financiar dhe gjendjes materiale të borxhliut dhe kreditorëve dhe e obligon borxhliun që ti mundësoj drejtorit të përkohshëm falimentues ti ndërmer të gjitha veprimet të parapara me ligjin për falimentim dhe të dërgoj raport për gjendjen në afat prej 15-ditësh.

Gjygi përcaktoi shpallje të vendimit në pajtim me ligjin 54 neni 6 nga Ligji për falimentim.



Me kërkesë të gjyqit themelorë të Tetovës, drejtori i përkohshëm falimentues dorëzoi:

Raport

Për gjendjen ekonomiko-financiare të Shoqërisë OIL GRUP-Tetovë.

Në sajë të Vendimit të GJ.TH.Tetovë, prej 30.01.2015 ku është inicuar procedura paraprake për hulumtimin e kushteve për hapjen e procedurës falimentuese ndaj borxhliut jepen të dhënat teknike, materiale dhe financiare si dhe obligimet dhe kërkesat deri në ditën e hapjes së procedurës paraprake dhe konstaton:

- Shoqëria ka problem me likuiditetin në 2013/2014 dhe pushon me aktivitete afariste.
- Llogaritë e transaksioneve pranë Kredit Bankë dhe Hallkbankë SH.A. Shkup janë të bllokuara më tepër se 45-ditë.
- Shoqëria është josolvente, ka pamundësi të përhershme për përmbushjen të obligimeve të arritura në para.
- Llogaria e fundit vjetore është dorëzuar në Regjistrin qendrorë të R.M.më 2014.
- Sipas të dhënave nga D.P.B nuk posedon automjete motorike.
- Nga të dhënat e A.K.P Shkup nuk disponon me pasuri të patundëshme.
- Shoqëria nuk është evidentuar si themelues-bashkëpjesëmarrës në subjekt tjetër dhe nuk është pronar i letrave me vlerë.
- Obligimet e përgjithshme në pajtim me dokumentacionin në disponim si dhe me vërtetimet e shërbimeve kompetente janë 1.679.111.00
- NëShoqërinë nuk ka baza për përpunimin e planit për riorganizim, sepse Shoqëria ka pushuar së funksionuari dhe nuk ka kapital.
- Zgjidhje e vetme me pajtueshmëri me analizën e kryer nga gjithë dokumentacioni në disponim është likudimi i Shoqërisë, sepse ka pushuar të kryej veprimtarinë për cilën është regjistruar, si dhe pamundësia e përmbushjes së obligimeve.

Pasqyrë e të hyrave të realizuara dhe rezultatet afariste për periudhën 2012-2015

VITI	Hyrat/Denarë	Fitimi/ Denarë	Humbja/Denarë
2012	514.731.00	180.788.00	
2013	6.296.512.00	448.565.00	
2014	1.825.542.00	/	2.226.653.00
2015	Nuk ka aktiv. afariste	/	Nuk është llog.humb

Burimi: Dokumentacioni i kontabilitetit të borxhliut.

- Shoqëria nuk ka kërkesa të papaguara

- Aktiviteti afarist i Shoqërisë është ndërprerë me fillimin e 09/2014.

Nga analiza e Bilancit të Gjendjes është konstatuar se nuk ka mjetet monetare dhe ekvivalent parash, Aktiva dhe Pasiva e përgjithshme është 81.808.00 den. Nga analiza e gjendjes financiare të Shoqërisë është konstatuar se:

- ka aktivë të vogël, e cila përbëhet prej kërkesës në vlerë prej 81.809.00 den. Të hyrat më 2014 janë 3.5 herë më të vogla në raport me 2013, dhe në muajin e 09/2014 pushon me aktivitete afariste.
 - Shoqëria është e ngarkuar me borxhe
 - Shoqëria është jolikide
 - Shoqëria nuk ka kapital
- Shkaqet e gjendjes së keqe të Shoqërisë
- Jolikuiditeti dhe borxhet
 - Nuk ka mjete qarkulluese për kryerjen e veprimtarisë dhe menaxhimi i keq.

Propozim

I drejtorit të përkohshëm falimentues për rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës

Nuk ka pasuri, kërkesa apo të drejta, të cilët do të mund të bëhen lëndë materializimi-shëndërrimi në para dhe në bazë të tyre të formohet masa falimentuese e cila do të ishte e mjaftueshme për përmbushjen e shpenzimeve të procedurës dhe obligimeve ndaj kreditorëve.

Propozon deri te Gjygi Themelor përmes Gjykatësit falimentuese në bazë të këtij raporti të **veproj** në pajtim me nenin 68 alinea 1 dhe të sjellë **Vendim** për hapjen e procedurës falimentuese dhe e njejta nuk realizohet dhe mbyllet.

Shtojca:

- Vërtetime nga institucionet kompetente për mos pagesë të tatimeve nga D.H.P.
- Vërtetim për gjendjen e obliguesit tatimorë- Komuna Tetovë.
- Vërtetim se personi nuk është regjistruar si bartës i së drejtës në kataster dhe patundëshmëri.
- Vërtetim nga Depozitari Qëndror i letrave me vlerë Sh.A. Skup



Gjygi Themelor në Tetovë si gjygi falimentues i shkallës së parë me datë 19.03.2015 sjell:

Vendim

I

HAPET procedura falimentuese ndaj borxhliut SHTTSH OIL GRUP-TETOVË.

II

Procedura falimentuese e hapur ndaj borxhliut NUK REALIZOHET dhe e njëjta MBYLLET, për shkak mospasjes së pasurisë në pajtim të nenit 68 nga Ligji për falimentim.

III

Pas plotfuqishmërisë së vendimit borxhliu TË FSHIHET nga Regjistri Qendrorë i RM.

Kopje nga vendimi të shpallet në ‘‘Fl.Zyrtare të R.M’’ –Shkup dhe tabelën e shpalljeve të gjyqjit.

URDHËROHET Halk Banka si institucion që ka kryer qarkullimin ditor të borxhliut, me pranimin e këtij vendimi llogaria e borxhliut falimentues të shuhet.

Arsyetim

Para Gjyqjit Themelor në Tetovë si gjyq falimentues i shkallës së parë parashtruesi në cilësinë e drejtorit parashtror propozim për procedurë falimentuese dhe e njëjta procedurë të **hapet dhe mbyllet menjëherë** për shkak mos pasjes së kapitalit, bazuar në nenin 68 të Ligjit për falimentim.

Në bazë të raportit të pergaditur nga drejtori falimentues i përkohshëm dhe të gjithave dëshmimeve të bashkangjitura dhe rezultatet e përgjithshme të procedurës gjyqji vërtetoi se janë plotësuar kushtet në bazë të nenit 68 të Ligjit për falimentim për hapjen dhe mbylljen e procedurës falimentuese për shkak të mos pasjes së pasurisë.



Ndërkohë gjyqji sjell VENDIM me të cilin LEJOHET PËRLLOGARITJA E SHPENZIMEVE të procedurës paraprake dhe kompensimin e drejtorit të përkohshëm falimentues ndaj borxhliut SHTTSH OIL GRUP-TETOVË. në lartësi prej 19.800.00 den. Këtë vendim të shpërndarjes së mjeteve drejtori i përkohshëm falimentues e dorëzon të gjykatësi falimentues për miratim të cilën në bazë të procedurës së sipërpërmendur edhe e miraton.

Mjetet e shpërndara janë të siguruar nga avansi për shpenzimet e udhëheqjes së procedurës paraprake nga ana e propozuesit SH.T.T.SH OIL GRUP-TETOVË.

Mjetet në para të barten në llogarinë trans depozitare të Gjyqjit Themelor në Tetovë tek Tregëtari Individual- KALLKOV KONSALTING.

Sqarim: Procedura falimentuese mgritet me propozim te kreditorit, debitorit ose personit tjetër të autorizuar me ligj, kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj. Në rastin konkret procedura është e inicuar me propozim të debitorit.

Organet e debitorit jnaë të detyruar që propozimin në fjal] ta paraqesin më së voni ne afat prej 21 diëve nga dita e paraqitjes së shkaqeve për hapjen e procedurës falimentuese, bazuar ne nenin 51 te ligjit për falimentim.

Debitori duhet të ofroje edhe dëshmitë perkatëse të lartëpërmendura si vërtetim nga banka që e bën qarkullimin pagesorë, raport për pronën si dhe vërtetim në lidhje me tatimet dhe kontributet e paguara.

Në bazë të propozimit per hapje të procedurës së falimentimit, gjykatësi i falimentimit pasi të konstaton se propozimi është i regullt mer vendim për hapje të procedurës paraprake ku do të vertetohet ekzistimi i kushteve për hapje të procedurës falimentuese dhe njekohësisht parcaktohet drejtori falimentues të përkohshëm.

Pasi konstatohet se ekzistojnë kushte për hapje të procedurës falimentuese, në rastin konkret gjykatësi falimentues mer vendim për hapje dhe mbyllje të procedurës, për shkak se prona e debitorit nuk është e mjaftueshme as për mbulimin e shpenzimeve të procedurës. Pas plotfuqishmërisë së vendimit debitori do te fshihet nga regjistri qendrorë i RM-se dhe me këtë rast vendimi në fjalë shpallet në gazetën zyrtare të RM-së.

RASTI-II

Hapja dhe mbyllja e njëkohëshme e procedurës falimentuese

Lënda: Propozim për hapje të procedurës falimentuese

Parashtrues: Shoqëria Aksionare për Sigurim dhe Risigurim "MAKEDONIJA Skopje- Viena Insurance Group".

Debitorë: Shoqëria për Ndërtim të Objekteve nga Ndërtimi i Ulët dhe i Lartë "TETOVA GRADBA"

Propozimi për hapje të procedurës falimentuese

Parashtruesi kërkon nga borxhliu vlerë prej 1,711.920.00 den, me përlogaritje të kamatës ligjore dhe asaj ndëshkuese në pajtushmëri të regullativës ligjore, llogaritur prej ditës së arritjes për çdo shumë veç e veç të treguar në aktvendim, si dhe shpenzime të procedurës në vlerë prej 111.000.00 den. në bazë të aktvendimit të plotëfuqishëm (pravosillna i izvrshena presuda).

Fakte: Aktvendimi i Gjyqit Themelor Tetovë , nr. 605/10.

Parashtruesi disa herë e ka thirrur borxhliun të paguaj borxhin, por ai nuk i është përgjigjur ftesës. Ka të dorëzuar edhe parashtrësë për kryerje të pagesës me forcë (prisillno izvrshvanje) përmes përmbaruesit, por edhe me këtë propozim nuk është vepruar, qëdo të thotë borxhi ende nuk është paguar. Mos veprimi i përmbaruesit është rezultat i mungesës së mjeteve në xhirollogarinë e borxhliut.

Fakte: Kërkesë për zbatimin e kryerjes deri te përmbaruesi më 20.09 2013.

Në bazë të dhënave të lartëpërmendura, a në pajtim me nenin 5 p.2, nenin 6, nenin 19. P.1, al.1 dhe 2, neni 31, neni 51 p.1 dhe 2 dhe neni 54 al 2 i Ligjit për falimentim, i propozojmë gjyqit kompetent, prej kur nga procedura paraprake do të vërtetohet solventitetin e borxhliut, të sjell vendimin për hapje të procedurës falimentuese të borxhliut.

Vendim

Hapet procedura falimentuese ndaj borxhliut Shoqëria Për Ndërtim të Objekteve nga Ndërtimi i Ulët dhe i Lartë SH.P.K., deponent në T.T.K.Bankë SH.A. Shkup.

- ndërkohë parashtruesi propozon drejtor falimentues si dhe

-person të autorizuar me autorizim gjeneral–juristë i diplomuar që do ta përfaqësojë Shoqërinë Aksionare për Sigurim Dp dhe Risigurim " M"MAKEDONIJA Skopje- Viena Insurance Group"

në të gjitha gjykata me të drejtë ndërmarrje të të gjitha veprimeve juridike nga neni 87 prej Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, pa të drejtë bartje të autorizimit.

Gjyqji Themelor në Tetovë si gjyq i shkallës së parë përmes gjykatësit falimentues duke vepruar sipas propozimit të Sh.A. për sigurim dhe risigurim “MAKEDONIJA Shkup-Vina IG” ndaj borxhli “TETOVA GRADBA” Tetovë solli këtë:

Vendim

Ku obligohet parashtruesi SH.A. për sigurim dhe risigurim “MAKEDONIJA Shkup-Vina IG” ndaj borxhliut “TETOVA GRADBA” në emër të avancit për përmbushjen e shpenzimeve për procedurë paraprake të paguaj vlerë prej 25000.00 den. në afat prej 8-ditësh në llogari pranë këtij gjyqi, pajtushmëri me dispozitat nga neni 53 alinea 1 dhe 2 prej Ligjit për falimentim, a në lidhje me nenin 2 dhe 3 të Rregullorës për përcaktimin e shumës për mbulimin e shpenzimeve të procedurës paraprake për të cilën gjyqi do të përcaktojë seancë për hulumtimin e kushteve për hapje-inicim të procedurës falimentuese pajtim me nenin 54 të Ligjit për falimentim. Nëse parashtruesi në afat prej 8-ditësh në këtë Vendim nuk dorëzon fakt se i ka avancuar shpenzimet për procedurë paraprake, parashtruesin gjyqi do ta hudhë poshtë.

DERI TE: Gjyqi Themelor i Tetovës

Parashtruesi: Shoqërinë Aksionare për Sigurim dhe Risigurim “MAKEDONIJA Skopje- Viena IG”. Përfaqësuesi ligjor, Autorizuesi ligjor. NT.403097258740, MB4067037 xh/llog 300000000086657-Banka Komerciale SH.A.-Shkup

Borxhliu: Shoqëria për Ndërtim të Objekteve nga Ndërtimi i Ulët Dhe i Lartë SH.P.K. me lokacion në rr ‘121’ nr 8 A, MB -4061926, N.T.402898116447, xhirollogaria nr 29040006638711, deponent në T.T.K. Bankë SH.A. Shkup.

Parashtesë nga parashtruesi i cili vepron sipas ngarkesës së gjyqit në bazë të vendimit nr.200/14 prej 24.10.2014 i cili është i ngarkuar për avancim të mjeteve në shumë prej 25000.00 den. shumë e cila është paguar për përmbushjen e shpenzimeve të procedurës paraprake-fakt për pagesë fletëpagesa në vlerë prej 25000.00 den.

Arsyetim

Nga të dhënat dhe faktet e sipër përmendura nga parashtruesi i kërkesës për gjendjen e borxhliut, masat e ndërmarrura si dhe bllokimi i xhiro llogarisë, gjyqji vlerësoi se në rastin në fjalë janë

plotësuar kushtet për zbatim të procedurës paraprake për përcaktimin e ekzistimit të kushteve për hapje të procedurës falimentuese. Në pajtim me nenin 58 të ligjit për falimentim, gjyqi përcaktoi masa për siguri për të cilën përcaktoi drejtor të përkohshëm falimentues deri në sjelljen e vendimit për hapje të procedurës falimentuese për të penguar ndryshim të gjendjes financiare dhe statusit të gjendjes materiale të borxhliut gjë që për kreditorët do të ishte e pavolitshme dhe njëhkohësisht të analizoj rrethanat se a ekziston arsye për hapjen e procedurës falimentuese dhe veprimet tjera në kompetencë të drejtorit të përkohshëm falimentues. Gjyqi përcaktoi edhe shpallje të këtij vendimi në tabelën e shpalljeve dhe kopje të këtij vendimi dorëzoi te R.Q në pajtim me nenin 54 alinea 2 të Ligjit për falimentim që bashkë me këtë borxhliut i dorëzoi edhe kopje për hapje të procedurës paraprake dhe shpallje në Web-faqe të gjyqit.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.

Tabela e shpalljeve të gjyqit

Gjyqi Themelor në Tetovë shpallë se me Vendim Nr-200/14 të 2014 ndërmeret procedurë paraprake për përcaktimin e shkaqeve të hapjes së procedurës paraprake parashtruar SH.A. për sigurim dhe risigurim MAKEDONIJA Skopje- Viena IG Shkup.

Ndërmeret procedurë paraprake ndaj Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë ‘TETOVA GRADBA’ dhe njoftim për ekzistimin e kushteve për hapje të procedurës falimentuese.

Konvikohet seancë për shkak të përcaktimit të propozimit për hapje të procedurës falimentuese në ditën 26.11.2014 orra 10 dhe përcaktohen masat siguroese si:

-obligohet drejtori falimentues i përkohshëm të mbrojë pasurinë e borxhliut, të vazhdon me udhëheqjen e Shoqërisë deri në sjelljen e vendimit për hapjen e procedurës falimentuese, të hulumtoj a ekzistojnë kushte për hapjen e procedurës, borxhliu a ka pasuri, nga pasuria a mund të krijohet masa falimentuese dhe se a mund të mbulohen shpenzimet nga masa falimentuese.

-borxhliu ti mundëson kushte pune drejtorit të përkohshëm falimentues me hapësirë dhe në disponim dokumente te nevojshme.

- i ndalohet përmbaruesve të veprojnë-realizim me dhunë nga cili do kreditor mbi pasurinë e borxhliut.

- i ndalohet borxhliut të disponojë-transaksione me pasurinë e vet.

- të publikohet tabela e shpalljeve të gjyqit si dhe të dërgohet deri te R.Q të R.M. filiala-Tetovë, si dhe borxhliut ti dërgohet vendim për hapje të procedurës falimentuese e parashtruar nga kreditori si dhe vendimi të shpallet në Web faqen e gjyqit.

Raport

Për gjendjen ekonomiko financiare të borxhliut Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë “TETOVA GRADBA” Tetovë.

Nga të dhënat në dokumentacionin kantabël Drejtori i përkohshëm falimentues konstatoi se borxhliu (subjekti) ka obligim të papërbushur ndaj kreditorëve në vlerë prej 1.711.992.00 den, nuk ka udhëheqës dhe një kohë të gjatë nuk punon, nga 2010 nuk dorëzon llogari vjetore, i njejtë disponon pasuri të patundëshme edhe ate banesë në sipërfaqe prej 50m2, hapësira ndihmëse (terasë) 4m2 në rrugën “Ilinden” ndërtesa A2-1 Tetovë, dhe se borxhliu është jolikuid dhe i paaftë për përbushjen e obligimeve të arritura ndaj kreditorëve dhe llogaritë transaksione që udhëhiqen në TTK-Bankë ShA. Shkup janë bllokuar mbi 45-ditë, me çka janë përbushur kushtet për hapjen e procedurës falimentuese në pajtim me nenin 5 al. 1 dhe 2 të L.F. Për shkak të këtyre rrethanave gjyqit i propozoi në pajtim me nenin 64 të Ligjit për falimentim të inicojë procedurë falimentuese ndaj borxhliut Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë “TETOVA GRADBA”-Tetovë. Në momentin e pregaditjes së njoftimit Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë “TETOVA GRADBA”-Tetovë. me NP 4061926 është i evidentuar si themelues-bashkëpjesëmarrës në subjekt të ri Shoqëria për prodhim, ndërtim dhe shërbime TETOVOGRADBA-ING-TETOVË 308.700.00 den.deponim jo në para.

Gjyqji Themlor në Tetovë si organ i shkallës së parë duke vepruar në bazë të propozimit për inicim të procedurës falimentuese në saje të mbatjes së seancave në prani të personave të autorizuar të propozuesit dhe drejtorit falimentues të përkohshëm më 12.01.2015 e solli këtë:

Vendim

Miratohet Propozimi i parashtruesit SH.A. për sigurim dhe risigurim “MAKEDONIJA Shkup-Vina IG”

Hapet procedurë falimentuese ndaj borxhliut Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë “TETOVA GRADBA”-Tetovë.

Përcaktohet Gjykatësi falimentues.

Thiren kreditorët-Duke marrë parasysh dispozitat e nenit 69, 70, 71, dhe 72 të L.për falimentim për thirjen e kreditorëve që të i paraqesin kërkesat e tyre te gjyqi falimentues për datën e mbajtjes së seancës (ispitno rocishte) dhe njoftimi i kreditorëve në Fl. Zyrtare të R.M. pastaj në dy gazeta si dhe tabelën e shpalljeve, në afat prej 15-ditësh nga dita e shpalljes në Fl Zyrtare ti paraqesin kërkesat e tyre të gjyqi falimentues, me faktë për pagesën e kryer të taksës gjyqësore në shumë prej 480.00 den.

Thiren borxhlinjtë (debitorët) e borxhliut falimentues ti përmbushin obligimet e tyre që i kanë ndaj borxhliut te drejtori falimentues.

Konvikohet Seancë-për shqyrtimin e kërkesave (ispitno rocishte) më 27.02.2015

Vendimi për hapje të procedurës falimentuese të shënohet në regjistër që i udhëheq R.Q.- Regjistri tregtar dhe regjistra tjerë dhe në Agjensionin për katastër të patundëshmërive të R.M.- Shkup dhe Agjensionit për katastër të patundëshmërive- Tetovë.

Vendimi për hapje të procedurës falimentuese të dorëzon deri te R.Q i R.M. –filiala Tetovë dhe të shpallet në Web Faqen, në Fl Zyrtare të R.M. dhe tabelën e shpalljeve të gjyqit.

Gjyqi në bazë të vlerësimeve nga faktet e parashtruara vërtetoi se janë plotësuar kushtet për hapjen e procedurës falimentuese.

Vendim i Gjyqit Themelorë në Tetovë më 12.01.2015 në numër rendorë 200/2014.

Faktet:

1. Fletëpagesa në vlerë prej 480.00 denarë
2. Fletëpagesë në vlerë prej 25.000.00 denarë.
3. Vendim për ndërprerje të punës së Shoqërisë dhe inicimi i procedurës falimentuese.
4. Llogaria rrjedhëse nga R.Q. i R.M.
5. Deklaratë nga themeluesit të vërtetuara në Noter
6. Vërtetim për bonitet nga Pro Kredit Banka Sh.A. Shkup, HALBANKA SH.A. Shkup
7. Vërtetim për dhënje informate nga R.Q. Regjistri i Pengut.
8. Njoftim nga Regjistri Qëndrorë i R.M. Zyra regjistruese regjionale, Shkup
9. Vërtetim nga D.P.Brendshme
10. Vërtetimi për pasuri- A.K.P. Shkup
11. Vërtetim nga Komuna e Tetovës
12. Vërtetim nga D.H.P, Drejtorija Regjionale Tetovë.
13. Vërtetim nga Depozitari Qëndror i letrave me vlerë Sh.A. Shkup

Nga të gjitha këto institucione me kërkesë të gjyqit jepen dokumente të nevojshme për gjendjen financiare dhe materiale, obligimet ndaj kreditorëve dhe ndaj borxhliut, pasurinë e Shoqërisë nëse disponon, xhirollogaritë tjera, obligimet ndaj shtetit D.H.P. dhe Komuna si dhe Fondi Pensional dhe shëndetësorë që do ti bashkëngjesim në vijim.

Në llogarinë rrjedhëse të shoqërisë tregëtare përveç të dhënave të subjektit, emri, lloji i subjektit në regjistrim, dita e themelimit, statusi afarist, lloji i pronësisë, N.P.T. llogaria rrjedhëse, prejardhja e kapitalit, madhësia, forma organizative, regjistri kompetent dhe kryegjësja bazë në deponim jomonetar në vlerë prej 4.956.200.00 denarë.

Sqarim:

D.H.P.-Drejtoria e të Hyrave Publike

A.K.P.-Agjensioni katasdrit për patundëshmëri

Lënda: Njoftim prej Agjensionit për katastër dhe patundëshmëri se subjekti nuk disponon me parcela katastrale apo fletë poseduese.

-Regjistri Qëndrorë i R.M. njofton se xhirollogaria e subjektit është e bllokuar mbi 45-ditë.

-Depozitari Qëndrorë- Subjekti nuk është i evidentuar në D.Q. për letra me vlerë si posedues i letrave me vlerë.

-Regjistri i pengut-nuk është evidentuar në asnjë dokument

Agjensioni për Katastër në R.M.-është i regjistruar në katastrin e patundëshmërisë.

Ndërkohë Gjygji Themelor në Tetovë sjell **Vendim** dhe lejohet përlllogaritja e shpenzimeve të procedurës paraprake dhe kompensimin e drejtorit të përkohshëm falimentues ndaj borxhliut Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë "TETOVA GRADBA"-Tetovë, në lartësi prej 25.000.00 den. Këtë vendim të shpërndarjes së mjeteve drejtori i përkohshëm falimentues e dorëzon të gjykatësi falimentues për miratim të cilën në bazë të procedurës së sipërpërmendur edhe e miraton.

Me vendim nr 200/14 prej 12.01.2015 Gjygji Themelor në Tetovë hapi procedurë falimentuese ndaj borxhliut Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë "TETOVA GRADBA"-Tetovë dhe përmes shpalljes në Fl Zyrtare të R.M.nr 9 më 21 01.2915 thiren të gjithë kreditorët në afat prej 15 ditë të shpalljes në Fletën zyrtare të i paraqesin kërkesat e tyre falimentuese.

Drejtojtori falimentues në bazë të kompetencave të veta dhe parapara me ligj pregadit:

Raport

Për gjendjen ekonomiko financiare të borxhliut Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë ‘‘TETOVA GRADBA’’-Tetovë.

Në bazë të të dhënave të treguara në llogaritë vjetore, borxhliu në periudhën që analizohet evidenton këta rezultate nga aktiviteti:

1.Bilanci i suksesit.

	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Të hyra	654.162	348.783	2.164.717	13.098.188	161.374	155.000
Shpenzime	2.823.302	2.342.616	2.616.714	11.946.086	173.704	209.779
Fitimi	///	///	///	1.036.892	///	///
Humbje	2.164.140	1.993.833	484.468	///	12.330	54.779

Nga të dhënat shihet se gjatë gjithë periudhën subjekti ka treguar humbje. Të hyrat e realizuara më 2009-2010 kanë arritur në nivel prej vetëm 161.374 den apo 155.000 den. Në tërë periudhën e analizuar, borxhliu ka nivel të lartë të obligimeve që çon në përfundim se subjekti është në shkallë të lartë të borxheve. Kërkesat e treguara për tërë periudhën janë në nivel të lartë dhe të njëjtat barten prej viti në vit, çon në përfundim se të njëjtat janë treguar joreale apo pa angazhim serioz të personave përgjegjës për pagesë të njëjtat që janë vjetëruar.

Është e qartë prej Regjistrimit Qendrorë të R.M.nr 0815-20/0477 prej 10.12.2014 borxhliu është evidentuar si themelues-bashkë pjesëmarrës në Shoqëri për prodhim ndërtimtari dhe shërbime TETOVO GRADBA-TETOVË me deponim jomonetar në vlerë prej 308.700.00 den.

-Pasuria e borxhliut

Vërehet në fletë pronësinë nr 101987 për Nj.K. Tetovë-2 borxhliu ka të shënuar të drejtë prone një banesë prej 50m, hapësira ndihmëse 4m dhe terasë në hapësirë 4m në Tetovë. Nga hulumtimi i mëtutjeshëm është konstatuar se banesa është shitur personit fizik, por nuk është bërë bartja në të drejtë pronësie. Pasi nuk është bërë bartja e pronësisë e njëjta ka figuruar si pronë e subjektit. Njëkohësisht paraqet edhe bilanc provues për gjendjen e mjeteve, pasurisë, obligimeve dhe kërkesave, ku paraqet kërkesa nga kreditorët në vlerë prej 25.354.676.00 den.

Borxhet më të mëdha janë ndaj:

- 1.SH.A. për sigurim dhe risigurim "Makedonija" Shkup = 4.720.331.00 den
- 2.Fondi për Sigurim Shëndetësor-Nj-Rajonale-Tetovë =2.509.265.00 den
- 3.Fondi për Sigurimi I. Pensional- Nj-Rajonale-Tetovë=9.926.723.00 den
- 4.Drejtoria e të Hyrave Publike-Nj.Rajonale -Tetovë =4.796.849.00 den dhe pjesa tjetër janë borxhe ndaj personave fizik që janë vlera më të vogla (3.201.498) gjithësejme borxhlijtë mëdhëj, totali shuma është25.354.676.00 den.

NJOFTIM

Në bazë të nenit 96 të Ligjit për falimentim, njoftohen kreditorët se raporti për gjendjen materiale-financiare të borxhliut **Shoqërisë për ndërtim të ulët dhe të lartë "TETOVA GRADBA"-Tetovë** është deponuar në dosjen falimentuese dhe ka qasje te kreditorët e interesuar. Njëkohësisht të pregadit raport shtesë për banesën që udhëhiqej si pasuri e borxhliut që në fakt është e personit fizik që vërtetohet pas dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm;

-Parakontratë për shitëblerje të banesës e evidentuar me nr 0307-566/1 prej 19.07.1999

-Kontratë për shitëblerje të banesës më 23.08.2000

-Vërtetim –Arka pranuese, vlera e paguar e banesës prej 58.013 DM.

-Vendim për tatim qarkullim nr 12-01/514/3 prej 14.03.2011 në vlerëprej 55.440.00 den

-Urdhëresë për pagesë në vlerë prej 55.440.den

Me raportin shtesë vërtetohet se Shoqëria në fjalë nuk disponon pasuri-kapital ashtu si figuronte në raportin e parë.

Gjygji Themelor në Tetovë pas seancave të mbajtura me gjygin falimentues, të autorizuarit, përfaqësues të institucioneve që kanë paraqit kërkesa dhe dorëzimit të raportin përfundimtar e pregaditur nga gjykatësi falimentues në pajtim me nenin 205 të Ligjit për falimentim e sjell këtë:

VENDIM

Hapja e procedurës falimentuese ndaj borxhliut Shoqëria për Ndërtim të Objekteve nga Ndërtimi i Ulët dhe i Lartë SH.P.K. me lokacion në rr "121" nr 8 A, MB -4061926, N.T.402898116447, xhirrollogaria nr 29040006638711, deponent në T.T.K. Bankë SH.A. Shkup, e regjistruar pranë Regjistrat qendrorë të R.M. HAPET dhe njëkohësisht NDËRPRITET për shkak se nuk ka pasuri-kapital. Ky vendim sjellet në pajtim me nenin 205 të ligjit për Falimentim nëse pas hapjes së procedurës falimentuese konstatohet se pasuria që hynë në masën falimentuese nuk do të jetë e mjaftueshme për përmbushjen e shpenzimeve të procedurës,

gjykatësi falimentues do ta ndërpret procedurën dhe do të sjell vendim për mbylljen e procedurës falimentuese.

Urdhërohet T.T.K. Banga Sh.A.Shkup, institucion bankar ku i ka kryer transaksionet borxhliu, me pranimin e këtij Vendimi nëse ka mjetet në xhirollogari të njejtat ti bart në Buxhetin e R.M.në llogaritë adekuate dhe pastaj xhirollogaria e borxhliut të shuhet.

Vendim i Gjyqjit Themelor-më 23.03.2015 në ren 200/2014.

Kundër këtij vendimit lejohet ankesë në afatë prej 8-ditësh pas pranimin të vendimit, përmes këtij gjyqji në gjyqjin e apelacionit në Gostivar.

PJESA E KATËR

Kapitulli i parë

MASA FALIMENTUESE

1. Nocioni i mases falimentuese

Menjëherë pas hapjes së procedurës falimentuese, përcaktohet formimi (krijimi) i masës falimentuese. Procedura falimentuese zbatohet mbi masën falimentuese.

Masa falimentuese përfshinë pasurinë e përgjithshme të debitorit në ditën e hapjes së procedurës falimentuese, si dhe pasurinë që ai do ta fitojë gjatë procedurës falimentuese.⁵¹

Pasuria e shëndrruar në masë falimentuese shërben për përmbushjen e harxhimeve të procedurës falimentuese, si dhe të kërkesave të kreditorëve të debitorit falimentues, përmbushja e të cilëve është siguruar me të drejta të caktuara mbi pasurinë e debitorit.

Çdo shoqëri tregtare që parashtron kërkesën për falimentim mund të posedojë pasuri, pavarësisht nga vështirësitë financiare. Varësisht prej madhësisë së shoqërisë tregtare pasuria mund të përfshijë ndërtesat, tokën, veturat, mobiliet dhe furnizimet e zyrës dhe shumë asete të tjera. Sapo të fillon procedura e falimentimit dhe të emërohet administratori, e tërë pasuria mbetet në administrimin e administratorit-drejtorit falimentues dhe shoqëria tregtare në falimentim nuk ka asnjë të drejtë të menaxhojë pasurinë e saj.⁵² Pasuria e shoqërisë tregtare në falimentim quhet “pasuria e falimentimit”. Regjistrimi i kërkesës krijon pasurinë e falimentimit dhe ajo përbëhet prej tërë pasurisë së debitorit prej datës së parashtrimit të kërkesës, si dhe e tërë pasuria e mbledhur nga administratori në emër të debitorit gjatë procedurës ose rrjedhës së zakonshme të afarizmit. Për obligimet e veta shoqëria tregtare përgjigjet me tërë pasurinë e vetë. Nga kjo kuptojmë se kreditorët mund t’i përmbushin kërkesat e tyre nga e tërë pasuria e cila aëshhtë në pronë të shoqërisë tregtare.

Në masën falimentuese nuk hyjnë sendet dhe të drejtat e debitorit mbi të cilat nuk do të mund të zbatohet përmbarimi nëse debitori nuk ka qenë tregtar ose zejtar. Përkundrazi nëse

⁵¹ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 74

⁵² Ligji për Falimentim i RM-së Neni 77 al.1

debitori konsiderohet tregtar apo zejtar përjashtime të tilla nuk bëhen. Personat që konsiderohen tregtar përcaktohen me dispozita të ligjit për shoqëri tregtare, kurse zejtarët përcaktohen me ligjin për veprimtari zejtare.⁵³

Pasuria e falimentimit përfshin, por nuk kufizohet në:

- gjithë pasurinë e luajtshme, të paluajtshme, materiale dhe jomateriale, kudo që gjendet, qoftë në administrim të debitorit ose të personave të tretë.
- kërkesat dhe veprimet juridike të debitorit kundër personave të tretë.
- fitimet nga veprimet që përfshijnë të ardhurat që arkëtohen prej transfereve të pandershme apo të privileguara.
- trashëgimet dhe fondet tjera të pranuar brenda gjashtë (6) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës.
- qiradhënien, të ardhurat dhe fitimet që dalin prej përdorimit të pronësisë së pasurisë ose nga veprimet e biznesit të debitorit.

2. Pasuria që nuk hynë në masën falimentuese

Pasuria që nuk hynë në masën falimentuese në momentin kur drejtori falimentues e formon masën falimentuese janë: veshjet, këpucët, dhe pajisje tjera për nevoja personale, enë të ndryshme, mbulesa, mobilje, shporet, frigorifer dhe pajisje tjera që shërbejnë për plotësimin e nevojave të amvisërisë, nëse i nevojiten borxhliut apo anëtarëve të familjes së ngushtë, ushqim, ngrohje për nevojat e borxhliut dhe anëtarëve të familjes së ngushtë për tre muaj, makina bujqësore dhe pajisje tjera për punë, farëra, ushqimet e kafshëve, pajime tjera që i nevojiten borxhliut për kryerjen e veprimtaris bujqësore apo zejtarisë, në atë masë që duhet të siguroi ekzistencën minimale për mbajtjen e vetës dhe anëtarëve të familjes së ngushtë. Libra dhe pajisje tjera që i nevojiten borxhliut i cili pavarsishtë në formë të veprimtarisë së pavarur shkencore, artistike apo veprimtari tjera profesionale, medale të caktuara, ambleme ushtarake dhe shenja tjera mirrënjohje, letra personale, dorëshkrime dhe shënime tjera të borxhliut, si dhe fotografi familjare dhe pajisjet ndihmëse të invalidëve apo personave tjera me të meta që i kanë furnizuar vetë apo u janë dhënë nga institucionet kompetente të shtetit, që janë të domosdoshme për jetën e tyre. Poashtu janë të përfshira të gjitha ndihmat, kompenzimet, kompenzimet për shkak të

⁵³ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 75

dëmtimeve trupore, ndihmat sociale, kompenzimet për shkak papunësisë së përkohshme, kompenzimet e shtesave feminare, kredit dhe ndihmë të nxënësve dhe studentëve, kompenzimet e ushtarëve dhe kadetëve në shkolla ushtarake, kompenzim të të burgosurve dhe kompenzime të tjera.⁵⁴

3. Bartja e pasurisë së falimentimit

Bartja e pasurisë së falimentimit është e kufizuar.

Për shkak se shoqëria tregtare në falimentim është shoqëri që ka vështirësi financiare dhe ka të ngjarë që nuk është në gjendje të përmbush të gjitha detyrimet e saja, ekziston nevoja për mbrojtjen e aseteve të asaj shoqërie tregtare nga bartja në mënyrë që interesat e kreditorëve të mos dëmtohen më tej. Së këndejmi, ekzistojnë disa kufizime për bartjen e pasurisë në falimentim në mënyrë që të mbrohen kreditorët.

Prej datës së paraqitjes së kërkesës deri në emërimin e drejtorit falimentues, ndalohet shitja, disponimi, bartja apo dhënia me qira e pasurisë, duke përfshirë çdo bartje për përmbushjen e detyrimeve ekzistuese, ose krijimin e pengjeve apo hipotekave kundër pasurisë së debitorit, pa vendim të gjyqit.

4. Veprimet e mbetura pezull

Është e qartë se shoqëria tregtare që shkon në falimentim, në ditën kur parashtrohet kërkesa për falimentim, mund të ketë disa veprime të lëna pezull të cilat presin të zgjidhen. Për shkak se debitori në fakt nuk është në gjendje të kryej shumicën e detyrimeve financiare, ekziston nevoja e trajtimit të këtyre veprimeve. Ligji në fakt i trajton këto çështje në mënyrën e paraqitur më poshtë. Sapo të parashtrohet kërkesa për falimentim, të gjitha kërkesat, procedurat dhe aktet e çdo lloji që synojnë të plotësojnë kërkesat kundër debitorit pezullohen. Thënë ndryshe, vendoset moratoriumi për këto kategori të kërkesave. Më tej, të gjitha periudhat e kufizimit të procedurave ligjore kundër debitorit që janë ndaluar gjatë moratoriumit pezullohen dhe vazhdojnë vetëm pas heqjes së tij. Me fjalë të tjera, parashtrimi i kërkesës për falimentim krijon pauzë në kohë sa i përket disa kërkesave, procedurave ose akteve.

Ky moratorium vendoset për një numër të kërkesave, procedurave dhe veprimeve, përfshirë:

⁵⁴ Komentim i ligjit për falimentimi i RM-së

-Çdo veprim, përfshirë proceset gjyqësore, për arkëtimin ose përmbushjen e kërkesave për borxhet, tatimet, ndëshkimet apo detyrimet e çfarëdo lloji që rrjedhin para datës së paraqitjes së kërkesës përveç për procedurat e paraqitjes së ankesave të përcaktuara me ligj.

***Shënim:** Kjo përfshinë të gjitha kërkesat të cilat kërkojnë kompensim në para për borxhet që debitori i ka ndaj palëve të treta (kreditorëve), borxh i cili është bërë para parashtrimit të kërkesës për falimentim.*

-Çdo veprim për krijimin, ndryshimin, rritjen, ndryshimin, regjistrimin ose zbatimin e pengut apo hipotekës në pasuri ose kundër debitorit dhe

-Çdo veprim për realizimin, marrjen, ose shitjen e çdo pasurie të vënë nën hipotekë të pasurisë së debitorit ose për ushtrimin e kontrollit mbi pasurinë e tij.

5. Çështjet tjera të pasurisë në falimentim

Ekzistojnë edhe shumë gjëra që kanë të bëjnë me pasurinë në falimentim që duhet të trajtohen. Disa prej këtyre çështjeve përfshijnë: sekuestrimin, vulosjen dhe marrjen e pasurisë së debitorit, inventari i pasurisë në falimentim, pasuria në transit dhe pasuria e mbajtur në emër të personave të tretë.⁵⁵

5.1.Sekuestrimi, vulosja dhe marrja e pasurisë së debitorit

Siç shihet shoqëria tregtare mund të ketë pasuri të madhe në forma të ndryshme. Ligji e detyron administratorin të gjejë, sekuestroj, vulos, ruaj dhe mbrojtë të gjithë pasurinë që identifikohet si pasuri në falimentim. Gjithashtu atij i kërkohet të sigurojë mirëmbajtje të pasurisë në falimentim.

Më tutje, administratori duhet të shesë mallrat që prishen shpejtë, ai është i autorizuar të shes pasurinë mirëmbajtja e së cilës është shumë e shtrenjtë, duhet të kërkojë kur është e përshtatshme që prona nën administrimin e palës së tretë të kthehet, dhe për pasurinë që gjendet jashtë vendit administratori duhet të parashtrij kërkesën tek gjykatat kompetente me njoftimin e sekuestrimit, vulosjes dhe marrjes së pasurisë së tillë.

5.2.Inventari i pasurisë në falimentim

Administratori klasifikon dhe bënë inventarizimin fizik të pasurisë jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas emërimit të tij. Kjo do të thotë që administratori i ka dyzet e pesë ditë pas emërimit të tij të hartojë listën e çdo pjese të pasurisë që konsiderohet se është pasuri në

⁵⁵ Programi USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial

falimentim, të cilat më vonë do të ishin në dispozicion të nevojave të gjykatës dhe të kreditorëve.

Ligji e lejon mundësinë që administratori të kërkojë zgjatje të afatit në rastet kur rasti i falimentimit është shumë kompleks.

5.3. Pasuria në transit

Shpesh ndodh që para se të parashtrohet kërkesa për falimentim shoqëria tregtare në falimentim ka porositur mallra të cilat pritet të arrijnë dhe pagesa të bëhet pasi që shoqëria tregtare parashtron kërkesën për falimentim. Në këto raste, mallrat janë rrugës për në destinacion, kryesisht drejt shoqërisë tregtare në falimentim por akoma nuk janë në pronësi të shoqërisë tregtare në falimentim. Ligji merret edhe me këtë dukuri dhe thotë se nëse mallrat që i janë shitur debitorit janë në transit kur është parashtruar kërkesa dhe debitori akoma nuk i ka në pronësi ato mallra, shitësi mund të kërkojë kthimin e mallrave me kusht që shitësi të bart të gjitha shpenzimet përkatëse, që kanë të bëjnë me kthimin dhe të kthej shpejtë çdo pagesë bërë në avans nga ana e debitorit. Në anën tjetër, administratori mund të marr dërgesën e mallrave dhe në atë rast pasuria e paguan shumën e tërësishme të borxhit.

Kapitulli i dytë

PËRMBUSHJA E KËRKESAVE TË KREDITORËVE NË PROCEDURËN E FALIMENTIMIT

1. Verifikimi i kërkesave

Me shpalljen e procedurës falimentuese të gjithë kreditorët i paraqesin kërkesat e veta, përmes fletëparaqitjes me shkrim ku e bashkëngjesin dëshminë për kërkesën e siguruar. Në të shënohen të gjitha të dhënat e nevojshme, si baza juridike, shuma e kërkesës, firma apo emri i kreditorit, selia, numri tatimor dhe i llogarisë së bankës, numri unik amë i subjektit të regjistrimit (NUAS) etj. Nëse kreditori është person fizik, në fletëparaqitje shënohet adresa dhe numri unik amëzë i tij. Në rastet ku paraqitet kërkesa për cilën zhvillohet kontest gjyqësor ose procedurë tjetër, në fletëparaqitje duhet të shënohet gjygi apo organi ku paraqitet kontesti tjetër ku zhvillohet kontesti gjyqësor. Çdo kreditorë është i detyruar të paraqes lartësinë e shumës së kërkesës me qëllim që të bëhet rangimi, apo pozicioni për kompenzimin e kërkesave. Kërkesat e tyre duhet ti paraqesin në afatin e përcaktuar në shpalljen e procedurës falimentuese, në të kundërtën drejtori falimentues me aktvendim do t'i hedh poshtë ata kërkesa të vonuara. Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta për ankesë tek këshilli i falimentimit. Këshilli i falimentimit obligohet në afat prej 8-ditësh të vendos nga pranimi i ankesës dhe lëndës për të cilën ka të bëjë ankesa.⁵⁶ Për çdo mangësi të fletëparaqitjeve nga kreditorët, drejtori falimentues është i detyruar t'ia këthejë këta fletëparaqitje dhe t'i mënjanojë vërejtjet në afat prej 8-ditësh, njëkohësisht për fletëparaqitjet e vonuara dhe jo të plota është i detyruar drejtori falimentues ta njoftoj gjykatësin falimentues, i cili me aktvendim i hedh poshtë. Për validitetin e fletëparaqitjeve shqyrtimin e bënë drejtori falimentues.

Për të përcaktuar radhën e pagesës ndaj furnitorëve, drejtori falimentues obligohet të prononcohet për secilën kërkesë të paraqitur veç e veç. Tabela e veçantë ku përfshihen të gjitha të dhënat u dorëzohet të gjithë kreditorëve ku me kohë janë paraqitur kërkesat e tyre dhe kërkesat që janë shqyrtuar. Kreditorët kanë të drejtë kundërshtimi për skemën e përpiluar nga drejtori falimentues në afat prej 8-ditësh.

⁵⁶ Ligji për falimentim i RM-së neni 87

2. Përcaktimi për mënyrën e disponimit

Në kuvendin e parë kur paraqitet raporti, drejtori falimentues është i obliguar të paraqesë raport me shkrim për gjendjen ekonomike financiare dhe shkaqet e gjendjes së tillë. Këtë raport drejtori i falimentimit është i detyruar ta dorëzojë te këshilli i kreditorëve dhe te gjykatësi i falimentimit për inspektim. Prej ditës së dorëzimit në afat prej 15-ditësh mbahet kuvendi i parë raportues i kreditorëve, ku vendoset se subjekti a do të mbyllet apo do të vazhdojë përkohësisht. Nëse nga dita e mbajtjes së kuvendit të kreditorëve nuk është dorëzuar propozim plani për riorganizim, kuvendi do të vendos, se a do të pranojë iniciativën për pregaditjen e planit për riorganizim. Nëse nuk pranohet iniciativa nga kuvendi i kreditorëve atëherë do të miratohet vendimi për mbylljen e subjektit afarist dhe do të përcaktohet mënyra dhe kushtet për shpërndarjen e pasurisë së debitorit në para (shndërrimi në para).⁵⁷ Prej momentit të sjelljes së vendimit për shëndërrim në para të pasurisë fillon edhe shitja e pasurisë së debitorit. Shitja kryhet përmes shpalljes publike me grumbullimin e ofertave përmes dy formave:

-ankand publik dhe

-marrëveshje e drejtëpërdrejtë

Këta shitje shpallen në një nga tri gazetatat me tirazh më të madh.

Shitja e aksioneve që është pjesë e masës falimentuese, kryhet përmes bursës sipas ligjit dhe rregullave të bursës, ndërsa pjesët që janë pjesë e masës falimentuese, shiten sipas ligjeve të shoqërisë tregëtare. Shitja me ankand publik realizohet atëherë kur personat që kanë përparësi të blerjes së pjesëve e refuzojnë blerjen e tyre. Shpallja e parë e pasurisë së masës falimentuese përmes ankandit publik për grumbullimin e ofertave e përcakton çmimin e përcaktuar fillesatar, ndërsa shitja e dytë po me të njëjtën procedurë nuk e përcakton çmimin fillestar. Nëse shitja e metodës-procedurës së parë nuk realizohet atëherë mundësohet shitja e drejtëpërdrejtë. Vendimin për shitjen e drejtëpërdrejtë e merr kuvendi i kreditorëve me propozimin e këshillit të kreditorëve. Gjykatësi falimentues e konfirmon shitjen. Me përjashtim, me propozim të drejtorit falimentues dhe me vendim të këshillit të kreditorëve me çmim më të ulët se vlera e caktuar mund të shiten pjesa e sendeve të tundëshme-pjesë që nuk e cenojnë procesin teknologjik (lënda e parë, gjysëm produktet, inventari, mbeturina etj)⁵⁸

Nëse edhe pas tri përpjekjeve nuk mund të mbahet kuvendi i kreditorëve për shkak të

⁵⁷ Ligji për Falimentim i RM-së Neni 97

⁵⁸ Ligji për falimentim i R.M. neni 98 al.8

kuorumit, vendimin për shpërndarjen e masës falimentuese e merr gjykatësi i falimentimit me detyrë zyrtare. Gjykatësi i falimentimit dhe organet tjera falimentuese si dhe familjarët deri në shkallën e katërt nuk kanë të drejtë të bëhen blerës, sepse llogaritet si konflikt interesash.⁵⁹ Pasuria nga masa falimentuese shitet sipas vlerës së përcaktuar, por në raste të pasaçme edhe nën vlerën e caktuar-çmim më i ulët.

3. Shndërrimi në para i sendeve ndaj të cilëve është fituar e drejta për përmbushje të ndarë

Drejtori i falimentimit mund t'i propozojë gjykatësit të falimentimit shitjen publike të patundëshmërisë që paraqet pjesë të pasurisë e cila hynë në masën e falimentimit, nëse ndaj asaj patundëshmërie është fituar e drejta për përmbushje të ndarë. Në aktvendimin e shitjes së patundëshmërive, gjykatësi i falimentimit do të shënojë se patundëshmëria shitet në procedurën e falimentimit.⁶⁰

Në librat publik do të bëhet shënimi i aktvendimit për shitjen e patundëshmërisë. Pas shndërrimit të pasurisë në para, personi kompetent së pari nga këto mjete i përmbush shpenzimet nga zbatimi i realizuar dhe mjetet e mbetura do ti realizoi në llogarinë e falimentimit. Pra, nga mjetet e realizuara, drejtori falimentues së pari i përmbush kërkesat e kreditorëve me të drejtën e përmbushjes së ndarë sipas radhës së paraparë me rregullat e procedurës falimentuese.⁶¹ Nëse sendet e tundshme gjenden në disponimin e drejtorit falimentues ai pakufizime mund të disponoj me ta. Nëse disponon me sendet e tundshme dhe ka autorizim drejtori falimentues për ta, me kërkesën e kreditorit të veçuar është i obliguar të njofton për gjendjen e sendit të tundshëm, ndaj të cilit ekziston e drejta e përmbushjes së ndarë. Kreditorit të veçuar i mundësohet nga drejtori falimentues që vetë të bënë kontrollin e sendit të tundshëm si dhe kontrollin e librave tregtar dhe dokumenteve tjera afariste tregtare. Drejtori falimentues para se të bëjë shitjen e sendit ndonjë personi të tretë duhet të njoftojë kreditorin me të drejtën e përmbushjes së ndarë, për mënyrën se si do ta kryej shitjen. Kreditorit i ofrohet mundësia në afat prej 8-ditësh të propozojë mënyrë më të volitshme të shitjes, propozim i cili pranohet nga drejtori falimentues me kushtë që të ofron ofertë obliguese (marrëveshje, garanc ose sigurin tjetër).

⁵⁹ Ligji për falimentim i R.M. neni 98 al.10

⁶⁰ Ligji për Falimentim i RM-së (komentim i nenit 98-107)

⁶¹ Ligji për falimentim i R.M. neni 107

4. Kreditorët e falimentimit

Kreditorë falimentues konsiderohet çdo person fizik ose juridik i cili gjatë procedurës së falimentimit në çfardo baze ka kërkesë ndaj debitorit.

Kreditorët falimentues këtë status e kanë fituar ditën e hapjes së procedurës falimentuese.

Kërkesat e tyre kanë karakter pasuror juridik edhe atë nuk është me rëndësi se këto kërkesa kanë aritur apo jo, është kërkesë e vërtetuar apo jo, është monetare apo jomonetare, e kontestuar apo jo e kontestuar.⁶²

Kërkesat e kreditorëve falimentues kategorizohen në kategori më të lartë dhe më të ulët të rradhës pagesore. Rregulli është që kërkesat e kreditorëve falimentues të rradhës më të ulët pagesore mund të realizohen atëherë kur do të realizohen pagesat kreditorëve të rradhës më të lartë.⁶³ Këtu vijnë në shprehje parimi i prioritetit absolut nga radha e pagesave të nivelit më të lartë dhe vetëm me pagesën e tyre hapet mundësia të paguhen kreditorët e rradhës më të ulët të kërkesave.

Në pagesat e rangut më të lartë bëjnë pjesë rrogat e papaguar, kontributet nga rroga, sigurimi invalidor pensional, kompenzimet në rast dëmtimi, sëmundjet profesionale, kompensime për mos shfrytëzimin e pushimit vjetor për vitin kalendarik. Drejtori falimentues është i obliguar para se të fiilojë pagesën e kërkesave të rangut më të lartë, të bën pagesën e obligimeve të lartë përmendura në tërësi.⁶⁴

Ne Pagesat e rangut më të ulët përfshihen:

- kamatat e kërkesave të kreditorëve falimentues që arrijnë prej ditës së hapjes së procedurës falimentuese.
- shpenzimet të cilët për ndonjë kreditorë do të arrijnë me pjesëmarrjen e tyre në procedurë.
- dënimet në para për veprë penale ose kundërvatje apo kërkesave për kthim të huasë.
- kërkesat për kthimin e huasë apo kërkesë tjetër adekuate me cilën plotësohet pasuria-kapitali i bashkëpronarit apo aksionarit.⁶⁵

⁶² Bankruptcy Act (USA) 1978, 101 (5); Insolvency Act 1986 (England)

⁶³ Ligji për falimentim i R.M. neni 116

⁶⁴ Ligji për falimentim i R.M. neni 117

⁶⁵ Ligji për falimentim i R.M. neni 118

5. Kreditorët e siguruar-veçuar

Kreditorët që kanë të drejtën e pengut ose të drejtën e përmbushjes së ndonjë sendi ose të drejta që janë regjistruar në librat publik (Enti Shtetërorë për Punë Gjeodezike, Regjistrin Qëndror, në regjistrat tjerë përkatës dhe të ngjajshëm) kanë të drejtën e përmbushjes së ndarë të atij sendi ose të drejtën sipas ligjit. Një të drejtë të tillë të përmbushjes e kanë edhe nga aksionet, pjesët, letrat tjera me vlerë dhe koleteralët tjerë financiarë.⁶⁶ E drejta e ndarë nënkupton kërkesën e kreditorit ndaj debitorit falimentues, e cila është e ndarë nga kërkesat tjera të kreditorëve të njëjtë apo kreditorëve tjerë dhe e cila përmbushet nga sendi i caktuar, respektivisht mjetet të debitorit falimentues që shërbejnë si sigurim i atyre kërkesave. Në këtë rast debitori i përgjigjet kreditorit vetëm me sende të caktuara në të cilën kreditori ka të drejtën e pengut, të drejtën e retencionit apo të drejtën e kompensimit. Kreditorët e ndarë kanë mundësi edhe deri sa zgjatë procedura e falimentimit të realizojnë kërkesat e tyre nga masa falimentuese përmes kontestit dhe përmbarimit në mënyrë të njëjtë kur realizohet jashtë falimentimit në bazë të parimit “prior tempore potio iure”. Kjo pozitë e kreditorëve bazohet në të drejtat e fituara para të tjerëve.⁶⁷ Kjo do të thotë se kontrata për të drejtat e fituara, shkakton efekt juridik edhe pas hapjes së procedurës së falimentimit ose zbatimit të planit për riorganizim. Këto të drejta të fituara shkaktojnë efekt juridik në aspektin e sigurimit të kërkesave që nuk janë arritur për tu realizuar me hapjen e procedurës falimentuese dhe me zbatimin e planit të riorganizimit.⁶⁸

Kreditorët që te ndonjë send nga masa e falimentimit kanë ndonjë të drejtë pengu që nuk është regjistruar në librat publik, kanë të drejtën e përmbushjes së ndarë të kërkesës së vet, kamatave dhe shpenzimeve nga vlera e sendit pengorë. Kreditorët me të drejtën e përmbushjes së ndarë mund të vazhdojnë që ti realizojnë të drejtat e tyre si kreditorët e tjerë të falimentimit, vetëm nëse heqin dorë nga realizimi i kërkesës së vetë përmes përmbushjes së ndarë ose nëse nuk kanë sukses që në mënyrë të ndarë të përmbushen deri në shpërndraje të masës së falimentimit.

⁶⁶ Ligji për falimentim i R.M.-së, Neni 128.

⁶⁷ B. Brajanovski, Zakon za stečaj so komentar i obrazci, fq 99.

⁶⁸ Ligji për falimentim i R.M.-së, Neni 128.

6. Kreditorë të përjashtuar

Kreditorë i përjashtuar konsiderohet personi i cili në bazë të së drejtës së tijë reale ose personale mund të argumentojë se ndonjë send nuk bën pjesë në masën e falimentimit.⁶⁹ E drejta e tijë për veçimin e sendit do të përcaktohet sipas rregullave që vlejné për realizimin e atyre të drejtave jashtë procedurës së falimentimit. E drejta e veçimit, do të përcaktophet për pjesët, letrat me vlerë (përveç aksioneve), si dhe për kolaterale të tjerë financiar. Nëse e drejta e personit është regjistruar në librin publik, debitori doemos duhet të argumentojë se sendi për të cilin ka të bëjë ajo e drejtë bën pjesë në masën e falimentimit. Shitësi të cilit çmimi blrës nuk i është paguar në tërësi, mund të kërkojë që ti kthehet malli që është derguar debitorit nga vendi tjetër, para ditës së hapjes së procedurës, ndërsa deri në ditën e hapjes së asaj procedure nuk ka aritur në vendin e destinuar, përkatësisht nëse deri në atë ditë debitori nuk e ka ndërrmarë (e drejta e kërkimit). Të drejtën e kërkimit e ka edhe komisionari për blerjen e mallit. Atëherë nëse debitori e ka ndërrmarë mallin që ka aritur në vendin e destinuar vetëm për ruajtje, para ditës së hapjes së procedurës, shitësi ka të drejtë për ta kthyer, por ka të drejtë që në procedurë të rregullt ti realizojë të drejtat e veta lidhur me atë mall si kreditorë i përjashtuar.⁷⁰

7. Kreditorët e masës falimentuese

Nga masa e falimentimit së pari përmbushen shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe obligimet e tjera të masës së falimentimit. Shpenzimet e procedurës së falimentimit përmbushen para të gjitha obligimeve të tjera të masës së falimentimit sipas madhësisë së tyre. Obligimet e tjera të masës së falimentimit përmbushen proporcionalisht me madhësinë e tyre pasi që të paguhen kërkesat e kreditorëve të cilët e kanë fituar cilësinë e kreditorit pas hapjes së procedurës.⁷¹

Në shpenzimet e procedurës së falimentimit bëjnë pjesë:

- shpenzimet gjyqësore,
- shpenzimet/kompenzimet e drejtorit të përkohshëm falimentues, drejtorit të falimentimit dhe këshillit të kreditorëve,
- shpenzimet për mirëmbajtjen teknike të pronës së debitorit,

⁶⁹ Ligji për falimentim i R.M.-së, Neni 125

⁷⁰ Adnan Jashari, E drejta afariste (statusore)

⁷¹ Ligji për falimentim i R.M. neni 133

- shpenzime tjera që me ligj është përcaktuar se do të përmushen,
- shpenzimet e bëra për regjistrimin në librat publik.

Nëse drejtori i falimentimit konkludon se është me interes për kreditorët që debitori të vazhdojë me punë afariste, me lejen e gjykatësit të falimentimit ai mund të marrë kredi dhe të krijojë borxh të pasiguruar si shpenzime të procedurës së falimentimit. Gjykatësi i falimentimit para se të jep lejen duhet të marrë pajtimin e këshillit të kreditorëve.

Nëse drejtori i falimentues nuk mund të marrë kredi të pasiguruar, gjykatësi i falimentimit pas lejes paraprake të kuvendit të kreditorëve, të miratuar në mënyrën si votohet për miratimin e planit për riorganizim, me aktvendim do të lejojë që drejtori i falimentimit të marrë kredi të siguruar me vendosjen e drejtës së pengut në prononën që hynë në masën e falimentimit, ndaj së cilës nuk është vendosur e drejta e pengut me vendosjen e së drejtës së pengut me përparësi më të vogël mbi pronën nga masa e falimentimit ndaj së cilës tanimë ekziston e drejta e pengut.⁷²

8. Pasoja juridike nga hapja e procedurës së falimentimit

Me hapjen e procedurës falimentuese shkaktohen disa pasoja juridike. Ndikimi i pasojave juridike që pasojnë **ex lege** me ditën e hapjes së procedurës falimentuese, do të thotë kufizim total për subjektin dhe organeve të saj në udhëheqje të jetë titullar në të gjitha pronat dhe drejtat pronësore. Me një fjalë pasoja juridike të ktilla nënkuptojnë kufizim të aftësisë së plotë të borxhliut të jetë bartës i të drejtave dhe obligimeve që i ka krijuar gjatë regjistrimit të themelimit në Regjistrin Qëndrorë. Aftësitë e veprimit në aspektin juridik në tërësi janë të kufizuara, pra me fillimin e veprimit të pasojave juridike prej hapjes së procedurës së falimentimit shprehet përmes angazhimit të organeve të procedurës falimentuese dhe autorizimet e tyre. Pasojat juridike prej hapjes së procedurës falimentuese ndikojnë në aftësitë afariste të borxhliut si aftësi që e krijojnë borxhliu vetë të merë pjesë në të drejtën e jetës, pra në këtë kuptim krijon organe të udhëheqjes për mes cilëve sjellë vendime dhe emëron organe me të cilët i realizon vendimet e sjellura. Organet e udhëheqjes me të drejtë ndahen në organe të cilët e udhëheqin punën dhe janë kolegjiale dhe organe të përfaqësimit që janë persona fizik.

Me hapjen e procedurës falimentuese dhe veprimin e pasojave juridike pamundësohet hyrja në raportet pronësore juridike të borxhliut dhe dëshira për lidhje të kontratave të caktuara

⁷² Ligji për falimentim i R.M. neni 134.

sepse e njëjta gjë është e kufizuar me rregullativë ligjore. Segment tjetër që ndikon në pasojat juridike të procedurës falimentuese është aftësia e vetë subjektit të përgjigjet në dëmin e shkaktuar. Me hapjen e procedurës falimentuese aftësia delikte e borxhliut është shfuqizuar sepse i tërë dëmi që mund të ndodhë në këtë periudhë për të përgjigjet drejtori falimentues ose organet e procedurës falimentuese. Nga kjo kuptojmë se drejtori falimentues është administrator i emëruar nga gjykatësi falimentues që ti kryej obligimet e përcaktuara me ligj dhe i është bartur e drejta dhe obligimet që deri tash i kishin organet e udhëheqjes së subjektit-me qëllim parësor të realizohen kërkesat e debitorëve. Gjatë kryerjes së detyrave të veta drejtori falimentues duhet ti harmonizojë ashtu që t'i mbrojë interesat e borxhlive në njerën anë dhe të kreditorëve në anën tjetër. Pra pasojat nuk fillojnë me shpalljen e aktvendimit, por me shpalljen e tabelave. Nëse aktvendimi i shpallur për shkak të ankesës anulohet, ndërsa pas procedurës së përsëritur procedura hapet përsëri, konsiderohet se pasojat juridike fillojnë që nga dita kur aktvendimi i parë është shpallur në tabelën e shpalljeve. Me ditën e hapjes së procedurës së falimentimit fillon së pushuari kamatat e kërkesave të pasiguruara. Nëse pas përmbushjes së të gjithë kërkesave të mbetura ka mjete për pagesë, gjykatësi i falimentimit mund të lejojë përlllogaritje dhe pjesë të kamatës edhe pas paraqitjes për iniciimin e procedurës së falimentimit. Kamata llogaritet sipas ligjit, nëse nuk është kontaktuar ndryshe. Me hapjen e procedurës së falimentimit ndërpriten të drejtat e anëtarëve të organeve të administrimit, anëtarve të organeve mbikqirëse, përfaqësuesve dhe të autorizuarëve. Këto të drejtat në aspektin e disponimit të pasurisë kalojnë te drejtori falimentues. Me hapjen e procedurës së falimentimit ndalimi, tjetërsimi ose ngarkimi i pasurisë së debitorit si dhe procedura e përmbartimit apo sigurimit, në këtë procedurë nuk vlejnë.⁷³

⁷³ Komentim I neneve 136-138 të Ligjit për falimentim të RM-së

Kapitulli i tretë

SHPERNDARJA

1. Përbushja ndaj kreditorëve të falimentimit

Përbushja e kreditorëve të falimentimit kryhet pas përfundimit të seancës shqyrtuese (verifikuese). Përbushja bëhet në dy mënyra: shpërndarjes së mjetetve me avansë dhe me shpërndarjen përfundimtare.

Kur në masën falimentues do të grumbullohen mjetet monetare të nevojshme, menjëherë shpërndahen ndërmjet kreditorëve në procedurë të falimentimit.⁷⁴

Drejtori i falimentimit para se të fillojë shpërndarja përpilon propozim plan për shpërndarje. Propozim-planin për shpërndarje përbën shumën e përgjithshme të kërkesave, shumën e mjeteve të realizuara-arritura për shpërndarje nga masa e falimentimit, listën e kërkesave që do të meret parasysh gjatë shpërndarjes, përqindjen e përbushjes së kreditorëve, dhe shumën e mjeteve monetare që do të ndahen për përbushjen e kërkesave të kreditorëve.

Ky plan dërgohet në gjykatë për inspektim nga ana e pjesëmarrësve në procedurë falimentuese. Propozimi i parë apo shpërndarja e mjeteve në avansë përpilohet pas aritjes së mjeteve në llogari nga ana e drejtorit falimentues. Ky propozim-plan u dërgohet organeve tjera për miratim dhe pas miratimit nga organet tjera propozim plani i dërgohet gjykatësit falimentues dhe të gjithë kreditorët e përfshirë në plan. Në propozim- plan gjykatësi i falimentimit e ndan shumën e masës falimentuese për pagesën e shpenzime të papaguara dhe të parapara. Kreditorët në afat prej 8-ditësh kanë të drejtë kundërshtimi për shpërndarjen në avans të cilin kundërshtim gjykatësi falimentues e vlerëson dhe nëse ka arsye e përmirëson. Me këtë aktvendim autorizohet drejtori falimentues të e bënë shpërndarjen e mjeteve-pagesën e mjeteve në llogarinë e kreditorëve për të cilin veprim bënë edhe raport dhe ia dorëzon gjykatësit falimentues, këshillit të kreditorëve. Kreditori i cili nuk është përfshirë në shpërndarje nëse dorëzon dëshmi drejtori falimentues është i detyruar të ndan mjetet-pjesën proporcionale të mjetetve për mbushjen e kërkesave.⁷⁵

⁷⁴ Ligji për falimentim i R.M. neni 189

⁷⁵ Ligji për falimentim i RM-së (Komentim i nenit 190-191)

2. Shitja e pasurisë në falimentim

Kur gjykata merr vendimin për urdhërimin e debitorit të shkoj në likuidim, drejtori falimentues duhet të përmbarojë shitjen e pasurisë në falimentim. Ligji për Likuidimin dhe Riorganizimin e personave juridik në falimentim i cakton detyrën administratorit të kryej shitjen e një pjese ose të tërë pasurisë në falimentim. Drejtorit të falimentimit i lejohet të delegojë këtë përgjegjësi tek i emëruari i tij ose eksperti i punësuar, por ai duhet të mbikëqyr nga afër atë shitje, megjithatë gjykata mund të autorizojë ndonjë metodë tjetër me kërkesë të administratorit.

Likuidimi pas riorganizimit: Kur procedurat e likuidimit kanë filluar si rezultat i shndërrimit nga procedurat e riorganizimit, drejtori falimentues e ka të drejtën të shes vetëm pasurinë e siguruar me pajtimin me shkrim nga kreditorët kërkesa e të cilëve është e siguruar me pasurinë.

Likuidimi i drejtpërdrejtë. Në lidhje me procedurat e likuidimit të filluara drejtpërdrejt, drejtori falimentues ka të drejtën ekskluzive të shitjes së pronës së siguruar të paluajtshme gjatë periudhës kohore prej nëntëdhjetë (90) dite pas datës së pranimit të rastit, dhe për pronën e siguruar të luajtshme gjatë periudhës kohore prej gjashtëdhjetë (60) dite pas datës së marrjes së rastit. Si pasojë, hiqet moratoriumi në të drejtat e kreditorëve të siguruar për ushtrimin e të drejtave të tyre mbi pronësinë e siguruar i përcaktuar me ligj për vendim gjykate. Shitja e pronës së siguruar nga drejtori falimentues pas heqjes së moratoriumit ndodhë vetëm pas pajtimit me shkrim të kreditorit kërkesa e të cilit është e siguruar me pronë.

Ligji thotë se procedurat e shitjes rregullohen me rregullat përmbarese, të cilat akoma nuk janë përpiluar. Përpilimi i këtyre rregullave është i rëndësishëm sepse ai përcakton parametrat në mënyrë që të shmanget keqpërdorimi dhe shitja e palejuar e pasurisë në falimentim. Kështu që, përpilimi i këtyre rregullave është po aq i rëndësishëm sa edhe një proces funksional për shitjen e pasurisë në falimentim të debitorëve në likuidim.

Braktisja e pasurisë: Drejtori falimentues mund të braktis pasuri të caktuar të debitorit, me kusht që ai së pari të kërkoj lejen e gjykatës për këtë lëvizje. Drejtori falimentues mund të braktis pasurinë e debitorit vetëm nëse:

-Pasuria ka vlerë të parëndësishme,

Shënim: Është vështirë të përcaktohet çka do të thotë “vlerë e parëndësishme”. Megjithatë, supozimi është se pasuria me “vlerë të parëndësishme” do të thotë pasuria që kushton më shpenjime për ta mirëmbajtur ose shitur se sa thjesht të hiqet dorë nga ajo.

-Pasuria është barrë e rëndë e pasurisë në falimentim.

Pas braktisjes, prona pushon se qeni pjesë e pasurisë në falimentim dhe kreditorët e siguruar mund të realizojnë me detyrim të drejtat e tyre ndaj pronës.

Shitja e jashtëzakonshme e pronës: Ky ligj lejon shitjen e jashtëzakonshme dhe të shpejtë të pasurisë së caktuar nën rrethana të veçanta. Ky lloj i shitjes mund të bëhet vetëm pas kërkimit të lejimit nga gjykata. Ky Ligj e lejon shitjen e jashtëzakonshme të pasurisë nga administratori në dy raste:

Mallrat që prishen shpejtë –Administratorit i lejohej shitja e jashtëzakonshme e mallrave që prishen shpejtë nëse e ka lejen e gjykatës. Administratori duhet t'i dërgojë gjykatës *ex parte* njoftimin urgjent të shitjes së propozuar për mallrat që prishen shpejt dhe gjykata ka 2 ditë kohë të vendos për atë çështje. Nëse gjykata nuk përgjigjet, atëherë administratori mund të vazhdojë me shitjen.

Shënim: Ky lloj i pasurisë është zakonisht inventar, i cili ka jetë të shkurtër ose prishet brenda një kohe të shkurtër. Shembuj të tillë janë pemët dhe perimet ose mallrat data e skadimit të të cilave afrohet shpejtë.

Pasuria që kërkon mirëmbajtje të shtrenjtë – gjithashtu shitja e jashtëzakonshme e pasurisë e cila kërkon mirëmbajtje të shtrenjtë i lejohej administratorit nëse ekziston leja e gjykatës.

Të ardhurat nga shitja ose shfrytëzimi i pasurisë–Fitimet e marra nga shitja ose shfrytëzimi i pasurisë në falimentim janë po ashtu në pronësi të pasurisë dhe mbrohen dhe llogariten nga drejtori falimentues. Çdo e drejtë në fitimet e tilla që del nga pengu, pengndalja, hipoteka, ose interesi tjetër i siguruar do të respektohet në pajtim me ligjin në fuqi.

3. Shpërndarja përfundimtare

Nga vetë fjala kuptojmë se me planin për shpërndarje përfundimtare kryhet menjëherë pas shndërrimit në para të pasurisë që hynë në masën falimentuese. Propozim plani pregaditet po në të njëjtën mënyrë si edhe mënyra e parë-shpërndarja e mjetetve në avansë. Drejtori i falimentimit e pregadit propozim planin, në afat prej 8-ditësh pas aritjes së mjeteve në llogarinë e drejtorit falimentues, i cili obligohet të përgadit llogarinë përfundimtare dhe raportin përfundimtar të cilin e dorëzon te anëtarët e këshillit të kreditorëve për pajtim. Pas pajtimit të dhënë, drejtori falimentues propozim planin dhe llogaritë përfundimtare i dorëzon te gjykatësi i falimentimit i cili bënë shpalljen e të njëjtëve. Kundër propozim planit të paraqitur për shpërndarje përfundimtare, kreditorët e falimentimit kanë të drejtë kundërshtimi në afat prej 8-

ditësh nga paraqitja e shpalljeve në tabelë. Kundërshtimin e shqyrton gjykatësi falimentues dhe vendos në afat prej 8- ditësh për shpërndarjen përfundimtare të mjetetve. Aktvendimi dorëzohet te kreditorët që kanë paraqit kundërshtim kundër propozim planit për shpërndarje përfundimtare dhe te drejtori i falimentimit, i cili deponohet edhe në gjykatë për shiqim nga gjithë kreditorët. Pas refuzimit të kundërshtimit kanë të drejt kreditorët të këshilli i kreditorëve.⁷⁶ Gjykatësi falimentues në tri ditët e ardhshme nga dita e miratimit të planit për shpërndarje përfundimtare, konvokon kuvendin përfundimtar ku;

-debatojnë llogarinë dhe raportin përfundimtar,

-konformojn planin për shpërndarjen përfundimtare të mjeteve,

-do të vendosen për sendet dhe të drejtat që paraqesin pjesë të pasurisë falimentuese që nuk kanë qenë të tjetërsuar, arkëtuara dhe tës hndërruara në para.

Vendimet e kuvendit përfundimtar miratohen me shumicën e kërkesave të konfirmuara, të paraqitura nga kreditorët e pranishëm. Miratimin përfundimtar për shpërndarje e miraton gjykatësi, ndërsa realizimin e këtij miratimi e bënë drejtori falimentues. Drejtori falimentues obligohet që menjëherë të bënë shpërndarjen-pagesën e mjeteve në llogari të kreditorëve dhe të përpilojë raport për punën e kryer dhe ti dorëzojë te gjykatësi falimentues, këshillin e drejtorit dhe dosjen e debitorit për inspektim eventual. Mjetet e mbetura nga shpërndarja ku mbulohen të gjithë kreditorët, tepricën e mjetetve i bartë në llogari të debitorit ku shpërndarja bëhet në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare.⁷⁷

Menjëherë pas shpërndarjes përfundimtare të mjeteve gjyqëtari i falimentimit do të marrë aktvendimim për përmbyllje të procedurës së falimentimit. Në aktvendimin për përmbyllje të procedurës gjyqëtari i falimentimit përcakton që përmbyllja e procedurës të regjistrohet në librat publikë.

Gjithashtu drejtori i falimentimit pas shpërndarjes duhet detyrimisht ta njoftojë banken dhe të kërkojë shlyerje të faturës ose nëse ka mjete ti depozitojë si depozitim gjyqësore dhe ta regullojë dokumentacionin arkivorë në përputhje me ligjin.⁷⁸

⁷⁶ Ligji për falimentim i R.M. neni 196

⁷⁷ Komentim i nenit 197, 198, 199

⁷⁸ Ligji për falimentimi i RM-së neni 200

PJESA E PESTË

PËRMBYLLJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Pasi të kryhet shpërndarja përfundimtare gjyqëtari i falimentimit menjëherë do të mer aktvendim për pëmbyllje të procedurës së falimentimit, e cila pëmbyllje regjistrohet në Regjistrin tregtarë, librat publikë dhe në regjistrat e tjerë përkatës. Me pëmbylljen e procedurës njëkohësisht pushon së ekzistuari edhe subjekti, përkatësisht e humb cilësinë e subjektit juridik apo tregtarit individ, përveç rasteve kur pëmbyllja e procedurës përfundon me miratimin e planit për riorganizim.

Me këtë rast drejtori i falimentimit është i detyruar të njoftoj bankën për fshirje të të gjitha faturave, ndërsa po që se ka mjete të pashpërndara ti depozitojë si depozitim gjyqësorë.

1. Ndërprerja e procedurës falimentuese

Nëse pas hapjes së procedurës së falimentimit konstatohet se pasuria që bënë pjesë në masën falimentuese nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e shpenzimeve të procedurës, gjyqtari i falimentimit do ta ndërpresë procedurën dhe do të marrë aktvendim për pëmbylljen e procedurës falimentuese. Procedura nuk ndërpritet nëse kreditorët i japin Gjyqit falimentues avans të mjaftueshëm. Gjyqtari i falimentimit para se të ndërpresë procedurën e falimentimit do ta dëgjojë kuvendin e kreditorëve, drejtorin e falimentimit dhe kreditorët e masës falimentuese. Të gjitha mjetet monetare që janë në masën e falimentimit, pas ndërprerjes së procedurës, drejtori falimentues do ti përdor për mbulimin e e shpenzimeve të procedurës të bëra deri në atë kohë, proporcionalisht me shumat e tyre. Prej këtij momenti, drejtori falimentues nuk do të jetë i obliguar ta ketë në dispozicion pasurinë që bënë pjesë në masën falimentuese, dhe nuk do të jetë i detyruar që këtë pasuri ta shndërroj në mjete monetare, ndërkaq shpërndarja bëhet pa shndërrim në para⁷⁹

Ndërprerja e procedurës bëhet edhe me kërkesë të debitorit. Gjyqtari falimentues do të ndërpresë procedurën e falimentimit nëse debitori argumenton se pas hapjes së asaj procedure ai nuk është jolikuid apo në mënyrë të drejtëpërdrejt nuk i kanoset jolikuiditetit, nëse procedura e

⁷⁹ Ligji për falimentim i R.M, neni 205

falimentimit është hapur për këto shkaqe. Gjygtari i falimentimit do e pranojë propozimin e debitorit për ndërprerjen e procedurës nëse gjygtarit i jepen prova se nuk ekzistojnë shkaqet sipas të cilëve është hapur procedura e falimentimit. Kërkesa e debitorit do të pranohet nëse pas skadimit të afatit për pararqitjen e kërkesave parashtron deklarat me shkrim te noteri për pëlqimin e ndërprerjes së procedurës e të gjithë kreditorëve të falimentimit të cilët i kanë pararqitur kërkesat e tyre. Me propozim të debitorit , gjygtari i falimentimit mund të ndërpresë procedurën e falimentimit dhe para skadimit të afatit për paraqitjen, nëse nuk duhen kreditorët tjerë. Shpalljen e kërkesës për ndërprerjen e procedurës së falimentimit e bën Gjygtari i falimentimit.

Kërkesat e deponuara do të paraqiten në gjykatë dhe palëve do të u vëhen në dijeni. Secili kreditor në afat prej 8-ditësh nga dita e shpalljes së ndërprerjes së procedurës, mund të paraqes kundërshtim kundër ndërprerjes së procedurës së falimentimit. Për palët që kundërshtojnë paraprakishtë gjygtari i falimentimit do e dëgjojë palën që ka kundërshtuar-ka parashtruar kërkesë për ndërprerjen e procedurës, drejtorin falimentues dhe këshillin e kreditorëve, nëse është themeluar ai këshill. Para ndërprerjes së procedurës së falimentimit, drejtori i falimentimit do ti përmbush të gjitha kërkesat e pakontestuara të cilët janë obligime të masës falimentuese. Për të gjitha kërkesat e kontestuara drejtori falimentues do të jap garancë apo sigurim përkatës. Gjygtari falimentues do të jap aktvendim me të cilën e ka ndërprerë apo përmbyllur procedurën falimentuese dhe shkaqet për ndërprerjen e saj. Gjygtari falimentues do të njoftojë debitorin, drejtorin e falimentimit dhe këshillin e debitorëve për datën prej së cilës do të fillojë ndërprerjes së procedurës të shkaktojë efekte juridike. Pas ndërprerjes së procedurës së falimentimit debitori sërish e fiton të drejtën të menaxhojë dhe të ketë në dispozicion pasurine cila bënë pjesë në masën falimentuese. Aktvendimin e ndërprerjes së procedurës, përkatësisht mbylljen e procedurës së falimentimit në përputhje me ligjin e dërgon në Regjistrin tregtar, si dhe një ekzemplar në Regjistrin Qëndror. Kundër këtij aktvendimi të gjygtit të falimentimit për përmbylljen e procedurës secili kreditorë mund tëparaqes ankesë në afat prej tetë ditësh te këshilli i falimentimit.⁸⁰

2. Riorganizimi

Nuk është e thënë që çdo shoqëri tregtare që parashtron kërkesën për falimentim është e

⁸⁰ Adnan Jashari, E drejta afariste (statusore)

destinuar të mbyllet. Në fakt ka raste kur riorganizimi i duhur e ka nxjerrë shoqërinë tregtare nga falimentimi më të fortë se sa ka qenë përpara. Megjithatë, realiteti është se shumë shoqëri tregtare kurrë nuk mund të dalin nga falimentimi, por shkojnë në likuidim..

2.1. Prezantim mbi riorganizimin

Riorganizimi për ata që akoma janë të qëndrueshëm financiarisht është mundësi e mirë. Riorganizimet korporative varen nga forcat vendimmarrëse të orkestrimit. Ato e kanë fuqinë të dërgojnë çështjet e borxhit në gjykata për të gjetur mënyrën më të mirë të riorganizimit të pjesës së papaguar të borxhit për kredinë. Procesi i riorganizimit fillon me dorëzimin e planit të riorganizimit në gjykatë nga ana e shoqërisë. Gjykata mbikëqyr riorganizimin e borxhit duke dëgjuar rastin nga shoqëria tregtare, kreditorët dhe shitësit. Mund të jetë proces i gjatë, por zakonisht është në interesin e shoqërisë tregtare në fjalë.

Riorganizimi korporativ mund të jetë i ndërlikuar dhe i vështirë për tu tejkaluar. Ka shumë shoqëri tregtare të cilat ushqejnë frikën dhe injorimin e riorganizimit korporativ, duke filluar prej juristëve tek agjentet e tatimit. Megjithatë, një shoqëri tregtare mund të përballojë procesin nëse e ka informacionin e duhur, njerëzit e duhur dhe perspektivën e duhur në anën e saj.

Riorganizimi korporativ i borxhit bëhet për arsye të qarta, që të ndihmojë në largimin nga barra e borxhit të caktuar. Gjykatat do të vlerësojnë shoqërinë gjatë procedurave të falimentimit në mënyrë që të shohin se cili është plani për të transformuar të metat e afarizmit të tyre. Zakonisht, një shoqëri tregtare që ka vështirësi duhet të vërtetojë se ata kanë asete për të mbuluar borxhet, përndryshe zyrtarët ose pronarët mund të shohin shoqërinë e tyre tregtare në duart e kreditorëve të tyre. Riorganizimi korporativ mbron shoqërinë tregtare nga çdo dëmtim i mëtejshëm dhe jep shpresën se do të përmirësohen mundësitë e rimëkëmbjes së tregut dhe fitimit

Shumë shoqëri tregtare gjatë tërë kohës kanë kaluar nëpër proces të riorganizimit korporativ dhe më vonë pasi janë dal nga ai proces kanë qenë në majë të tregut. Falimentimi nuk nënkupton zënie e frymës së shoqërisë tregtare, por duhet të ndihmojë në uljen e borxheve dhe drejtimin e saj drejt suksesit. Riorganizimi korporativ i borxhit i jep mundësinë shoqërisë tregtare të gjej mënyrën për llogaritjen e hapave të gabuar dhe të ndërmarrë një qasje të re ndaj afarizmit, me shpresën se në fund do të ketë fitim të parave dhe dalje nga thellësia e shkatërrimit financiar. Nëse një shoqëri tregtare nuk i di mekanizmat për procesin e riorganizimit, atëherë riorganizimi korporativ mund të jetë përpjekje e dhimbshme. Me informacionin dhe përkrahjen e duhur,

riorganizimi korporativ mund të sjell ndryshim në dukjen financiare të shoqërisë tregtare.⁸¹

2.2. Plani i riorganizimit

Procedura e falimentimit e cila në vete përfshin riorganizimin realizohet në bazë të planit për riorganizim.

Plani i Riorganizimit është dokument i shkruar, i cili e përmban informacione që parashihen me Ligj. Plani mund të dorëzohet nga debitori, administratori, kreditorët të cilët mbajnë së paku tridhjetë (30%) përqind të kërkesave të siguruara, kreditorët të cilët mbajnë së paku tridhjetë (30%) përqind të kërkesave të pasiguruara, ose personat që kanë së paku tridhjetë (30%) përqind të kapitalit në pronësinë e debitorit në formë të aksioneve ose ndonjë formë të ngjashme. Plani për riorganizim të debitorit falimentues si institucion juridik ka qenë i njohur edhe në bazë të ligjit për barazim të dhunshëm, sanim dhe likuidim i njohur si “barazim me dhunë”. Qëllimi i barazimit me dhunë ka qenë ndërprerja e falimentimit. Instituti i riorganizimit për dallim nga barazimi me dhunë, ka për qëllim shërimin e tërësishëm të debitorit falimentues, riorganizimin e afarizmit të debitorit dhe konsolidimin financiar.⁸²

Planit për riorganizim hartohet në formë të shkruar.

Nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara me këtë ligj, plani për riorganizim mund të paraqitet pas hapjes së procedurës falimentuese apo para hapjes së procedurës falimentuese, edhe ate:

- a) Njëkohësisht me paraqitjen e propozimit për ngritje të procedurë së falimentimit nga ana e kreditorit apo debitorit
- b) Me propozim të kreditorit pas hapjes së procedurës së falimentimit deri në ditën e mbatjes së kuvendit raportues
- c) Me propozim të drejtorit të falimentimit, sipas vendimit, përkatësisht sipas instruksioneve të kuvendit të kreditorëve.⁸³

Subjekti i autorizuar për paraqitje të planit për riorganizim e ka për detyrë që gjyqtarit të falimentimit ti paraqes plan për riorganizim më së voni brenda 45-ditëve nga dita e pranimit të autorizimit ose mund të vazhdoj afatin e përgaditjes së planit edhe për 15-ditë. Me vendim të përgjithshëm të këshillit të kreditorëve, i miratuar nga dy të tretët e numrit të përgjithshëm të këshillit të kreditorëve, këshilli i kreditorëve afatin mund të e vazhdoj më së shumti edhe 60-

⁸¹ www.corporatereorganization.net

⁸² Programi I USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial

⁸³ Ligji për falimentim i R.M, neni 215

ditë. Plani i pregaditur për riorganizim nga subjekti me rekomandim të kuvendit të kreditorëve i dorëzohet drejtorit të falimentimit dhe gjygtarit të falimentimit, ndërsa kur drejtori i falimentimit është obliguar ta pregadit planin për riorganizim, planin e dërgon pran gjygtarit të falimentimit dhe këshillit të kreditorëve. Nëse janë paraqitur më shumë plane-variante të ndryshme për riorganizim, gjygtari i falimentimit do ta pranoj atë plan për të cilin ka dhënë pëlqim kuvendi i kreditorëve.⁸⁴ Plani për riorganizim, mund të realizohet vetëm në mënyrë të përcaktuar me dispozita ligjore edhe atë:

-të i jepet mundësia që debitori të menaxhoj ose ta ketë në dispozicion tërë pasurinë ose vetëm një pjesë të pasurisë së tij. Nga kjo mundësi mund të konstatohet se plani për riorganizim ka të bëjë me pasurinë e debitorit e jo me afarizmin e tij. Në këtë rast në vet planin përcaktohet personi që do të administrojë pasurin. Ai person mund të jetë përfaqësuesi ligjor i debitorit apo ndonjë person tjetër i emëruar nga drejtori falimentues.

-me mundësinë e ndryshimit përkatës statusor me qëllim që pasuria e debitorit ose një pjesë e pasurisë ti bartet njërit apo më shumë personave të cilët ekzistojnë apo themelohen.

-mundësia e bashkimit të debitorit me një apo më shumë persona, që duke u bashkuar, krijohet subjekti i ri që është pasoji e këtij ndryshimi statutor⁸⁵.

-me shitjen e pasurisë apo një pjese të saj, mos përmbushja e detyrimeve, me qëllim që ata mjetet të shërbejnë për vazhdimin e veprimtarisë dhe duke vazhduar veprimtarinë kreditorëve tu dorëzohen mallra që prodhohen nga veprimtaria e organizuar e debitorit.-përmbushja e obligimeve ndaj kreditorëve, bëhet kategorizimi i kreditorëve në rend pagese.

-barazimi me dhunë për zvoglimin apo shlyerjen e obligimeve të debitorit, vecënarishtë në raste kur asetet janë në pronësi të shtetit.

-me konvertimin e detyrimeve të debitorit në kredi. Në këtë rast, në esencë bëhet shtyrja e shlyerja e përmbushjes së kërkesave.

-me marrjen e garancive ose dhënies së sigurisë tjetër për përmbushjen e obligimeve të debitorit.

-me deponime shtesë etj.⁸⁶

Shpenzimet: Shpenzimet për dërgimin e PR-së nga çdo person përveç debitorit ose administratorit mbulohen nga personi i njëjtë që e propozon PR-në. Kurse, PR-të e dorëzuara nga debitori ose administratori mbulohen nga pasuria.

⁸⁴Ligji për falimentim i R.M. neni 216

⁸⁵ Adnan Jashari-Subjektet e të drejtës afariste

⁸⁶ Ligji për falimentim i R.M. neni 215

Shënim: Përpilimi dhe dorëzimi i PR-së mund të jetë proces shumë i shtrenjtë. Varësisht prej madhësisë së shoqërisë tregtare, ky proces mund të kërkojë punë intensive nga shumë profesionistë (juristë, ekonomistë, kontabilistë). Është një dokument me hollësi të shumta, i cili përfshinë bollëk të informacionit për rimëkëmbjen e shoqërisë tregtare që është në vështirësi.

2.3. Përmbajtjet e planit të riorganizimit

Përmbajtja e PR-së ka për qëllim t'i informojë në mënyrën e duhur të gjitha palët e interesuara, për nxjerrjen e suksesshme të debitorit nga falimentimi dhe ngritjen në këmbët e tij. Lista e poshtëshënuar tregon përmbajtjen e qartë të PR-së. Përmbajtja e PR-së themi se është hartuar në mënyrë e duhur kur përmbushen kërkesat.

-Paraqitja: një paraqitje të shkurtër të përgjithshme të veprimtarisë afariste të debitorit dhe rrethanat që shpijnë në vështirësinë financiare;

-Metodat dhe Mjetet: përshkrimin e metodave dhe mjeteve për realizimin e planit, duke dhënë hollësi mbi masat që parashikohet të merren, me mjaft hollësira se si do të realizohej plani, duke përfshirë secilin projekt financiar në të cilin bazohet mundësia e realizimit të planit;

-Likuideti Ekzistues në Dispozicion: diskutimin e shkurtër të shumës së të hollave që ka të ngjarë të jetë në dispozicion për kreditorët;⁸⁷

Plani për riorganizim përbën pjesën përgaditore (deklarative) dhe pjesën e zbatueshme (realizuese). Në pjesën përgaditore të planit për riorganizim përshkruhen masat që janë marrë dhe do të ndërmeren pas hapjes së procedurës falimentuese me qëllim që të krijohet bazë për të kënaqur të drejtat e pjesëmarrësve, të dhënat për bazat dhe efektet e falimentimit, informatat tjera që mund të ishin relevante për vendimin e kreditorëve në lidhje me miratimin e planit dhe për dhënien e pelqimit nga ana gjyqitarit të falimentimit.

Pjesa zbatuese përfshinë:

-masa dhe mjete për realizimin e planit si dhe përshkrimin e hollësishëm të masave që duhet të ndërmeren dhe mënyra me të cilët do të zbatohet riorganizimi. Lartësia e shumës së parave ose pasuria e cila do të shërbejë për përmbushje të pjesëshme apo tërëishme sipas radhës së pagesave duke inkuadruar edhe kreditorët e siguruar dhe pasiguar si dhe procedurën për përmbushjen e kërkesave dhe dinamikën kohore të pagesave të tyre (përmbushjen e detyrimit).

-afatet brenda të cilit do të zbatohet plani për riorganizim dhe afatet për realizimin e

⁸⁷ Programi i USAID-it në Kosovë për përmbardim dhe legjislacion komercial

elementeve kryesore të planeve për riorganizim.

-listë e anëtarëve të organeve të menaxhimit dhe shuma e kompensimeve të tyre.

-listë të personave profesionist, të cilët do të angazhohen dhe shumën e kompensimeve të tyre si dhe shumën e kompensimit për drejtorin falimentues.

-raportet financiare, projektet financiare duke përfshirë edhe bilancet e projektuara për sukses, bilancin e gjendjes dhe raportin për rrjedhat monetare për pesë vitet e ardhshme.

-vlerësim të mjeteve monetare të cilët priten pas shitjes së pasurisë në procedurën falimentuese, nëse personi është në falimentim.

-mundësi për krijimin e borxhit të ri nga ana e debitorit dhe llojet e garancive që mund t'iu ofrohen kreditorëve dhe investitorëve.

-shumën deri sa mund debitori të jetë i liruar nga obligimet ekzistuese.

-përkufizimi i masave organizative, për menaxhim, masave ligjore, financiare, tekniko-teknologjike dhe masat tjera për zbatimin e planit të riorganizimit.

-datën e fillimit të aplikimit të planit për organizim dhe të dhëna dhe përmbatje tjera, ashtu si që është e përcaktuar me ligj.⁸⁸

Shoqëritë tregtare që kanë vështirësi duhet të vërtetojnë se ata kanë asete për të mbuluar borxhet, përndryshe zyrtarët ose pronarët mund të shohin shoqërinë e tyre tregtare në duart e kreditorëve të tyre. Riorganizimi mbron shoqërinë tregtare nga çdo dëmtim i mëtejshëm dhe jep shpresën se do të përmirësohen mundësitë e rimëkëmbjes së tregut dhe fitimit.

Shumë shoqëri tregtare gjatë tërë kohës kanë kaluar nëpër proces të riorganizimit dhe më vonë pasi kanë dalur nga ai proces kanë qenë në majë të tregut. Falimentimi nuk nënkupton zënien e frymës së shoqërisë tregtare, por duhet të ndihmojë në uljen e borxheve dhe drejtimin e sajë drejt suksesit. Riorganizimi i borxhit i jep mundësinë shoqërisë tregtare të gjejë mënyrën për llogaritjen e hapave të gabuar dhe të ndërmarrë një qasje të re ndaj afarizmit, me shpresën se në fund do të ketë fitim të parave dhe dalje nga thellësia e shkatërrimit financiar. Nëse një shoqëri tregtare nuk i di mekanizmat për procesin e riorganizimit, atëherë riorganizimi korporativ mund të jetë përpjekje e dhimbshme. Me informacionin dhe përkrahjen e duhur, riorganizimi korporativ mund të sjell ndryshim në dukjen financiare të shoqërisë tregtare.⁸⁹

⁸⁸ Ligji për falimentim i R.M. neni 217-219

⁸⁹ Programi i USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial

PRAKTIKA GJYGJËSORE

Lënda: Propozim për lejimin e hartimit të planit për riorganizim

Gjygji Themelor në Tetovë duke vepruar në procedurën e hapur falimentuese ndaj borxhliut SHA AVTOPROGRES Tetovë-tashmë në falimentim, dhe pas plotfuqishmërisë së vendimit për miratimin e planit për riorganizim dhe likuidimit të debitorit sjellë:

Vendim

Procedura falimentuese ndaj debitorit SHA AVTOPROGRES Tetovë, e cila është në falimentim në bazë të vendimit të vitit 2004, MBYLLET.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që hynë në masën falimentuese tashmë i mer përsipër shoqëria e sapoformuar EGZON PROGRES (në pronësi të ISM GRUP Tetovë) si pasardhës i debitorit falimentues Sh.A AVTOPROGRES Tetovë e cila është formuar gjatë procedurës falimentuese të debitorit me planin për riorganizim.

OBLIGOHET, drejtori i falimentimit të debitorit të kryej mbikqyrje në zbatimin e planit të riorganizimit.

Pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi debitori Sh.A. AVTOPROGRES Tetovë në falimentim të fshihet nga regjistri tregtar pranë Regjistrat Qëndrorë të R.M..

Vendimi të dorëzohet deri te R.Q. i R.M., Agjencioni për katastar dhe organet tjera që i udhëheqin librat publike për evidentimin e së drejtës së patundshmërive.

Kopje e vendimit të shpallet në Fletën Zyrtare të R.M. në tabelën e shpalljeve të gjyqit.

Arsyetim

Me vendim S.T. nr. 157/04 prej 24.12.2004 në këtë gjyq mbi borxhliun Sh.A. Avtoprogres Tetovë është hapur procedurë falimentimi.

Këshilli i ri falimentues prej kur kreu shiqim mbi dokumentacionin konstatoi se gjatë procedurës Këshilli i debitorëve më 03.06. 2005 e obligon drejtorin falimentues të përgadisë Plan për Riorganizim dhe konsolidim financiar të borxhliut. Prej momentit kur drejtori falimentues përgaditë Plan për Riorganizim, i njëjti ligjërishtë dorëzohet në shqyrtim të personat e paraparë në pajtim me nenin 229 p.3 nga L.F. Pastaj këshilli i kreditorëve e kalon planin për riorganizim më 05.05 2006 me shumicë votash me përqindje prej 82,768% nga votat e përgjithshme, në këtë rast këshilli falimentues me vendim S.T. nr 157/04 më 08.05. 2006 e lejoi të njëjtin, dhe ky vendim bëhet i plotëfuqishëm më 07.09.2006.



Lënda: Njoftim

Propozues: Drejtori falimentues i përkohshëm

Njoftohet gjygi themelor i Tetovës se me 08.05.2006 me vendim S.t. nr 157/04 nga Gjygi themelor Tetovë, është sjellë Plani për riorganizim mbi borxhliun Sh.A AVTOPROGRES tani më në falimentim. Në vetë vendimin (aline 3) është e potencuar se për plotësimin e planit falimentues garanton ISM GRUP Tetovë të cilët kanë formuar shoqëri tregtare në formë të EGZON PROGRES DOOEL Tetovë.

Obligimet e ndërmarura për plotësimin e planit dhe dinamikës së pagesave të disa kreditorëve të parapara me planin për riorganizim nuk janë përmbushur, edhe ate:

1. M.F. D.H.P.sektorit për kapital nuk i është paguar shuma 6.100.000.00 den
2. M.F. D.H.P.R.D Tetovë nuk i është paguar shuma prej 625.048.00 den.
3. Stopanska Banka Sh.A. nuk i është paguar shuma prej 17.321.589.00 den.

Në bazë të gjendjes së lartëpërmendur konstatohet se plani për riorganizim të borxhliut falimentues Sh.A. AVTOPROGRES (në falimentim) nuk është përmbushur në pajtueshmëri me dinamikën e paraparë sipas planit.

Në bazë të gjithë gjendjes së lartë shënuar drejtori falimentues obligohet për mbikqyrjen e realizimit të planit për riorganizim të borxhliut falimentues Sh.A. AVTOPROGRES Tetovë deri te këshilli falimentues të Gjygit themelor Tetovë e sjell këtë;

Propozim

Që naj borxhliut Sh.A. AVTOPROGRES Tetovë të hapet procedura falimentuese (në pajtim me nenin 46 p.1 dhe 6 të ligjit për falimentim Fl. Zyrtare e R.M. 55/97) për ate se janë plotësuar kushtet (në pajtim me nenin 266 al 1 dhe neni 273 prej ligjit për falimentim Fl Z. 55/97) dhe për shkak të mos plotësimit të obligimeve nga ana e ISM GRUP TETOVO nëërmes shoqërisë së re tregtare EGZON PROGRES DOOELL Tetovë.



Me këtë rast Gyqi Themelor Tetovë si gjygi falimentues i shkallës së parë, duke vepruar në bazë të propozimit nga drejtori falimentues që përsëri të hap procedurë falimentuese ndaj borxhliut SH, A. AVTOPROGRES në pajtim me ligjin për falimentim në seancën e mbajtur sjell:

Vendim

Pranohet propozimi i drejtorit falimentues dhe pësëri hapet procedurë falimentuese ndaj borxhliut AVTOPROGRES Tetovë.



Kundër këtij vendimi Shoqëria ISM GRUP Tetovë ka përdorur mjetin juridik –Ankesë për mos përsëritje të procedurës falimentuese.

Gjykata eApelit në Gostivarë e hedh poshtë ankesën e ISM GRUP SHPK dhe e vërteton vendimin e shkallës së parë për përsëritje të procedurës së falimentimit.

Sqarim: Procedura falimentuese e cila e përmban riorganizimin zbatohet sipas planit për riorganizim. Plani për riorganizim mund të paraqitet njëkohësisht bashkë me propozimin për hapjen e procedurës falimentuese nga ana e debitorit dhe kreditorit, me propozim të kreditorit pas hapjes së procedurës së falimentimit dhe me propozim të drejtorit të falimentimit.

Në rastin konkret këshilli i ri falimentues konstaton se gjatë procedurës falimentuese kuvendi i kreditorëve e obligon drejtorin falimentues të përgadisë planin për riorganizim. Pra plani për riorganizim bëhet (në pajtim me nenin 215 al.2 p.3) pas hapjes së procedurës falimentuese me propozimin e drejtorit falimentues.

Përmes planit për riorganizim sipas nenit 215 alinea3, debitorit i mundësohet të menaxhojë ose ta ketë në dipozicion tërë pronën ose një pjesë, zbatohen ndryshime përkatëse statusore me qëllim që prona e debitorit të bartet njërit ose më shumë personave të cilët ekzistojnë apo do të themelohen, do të përcaktohet mënyra e përmbushjesh së detyrimeve ndaj kreditorëve të falimentimit, obligimet e debitorit mund të shëndrohen në kredi e tj.

3. Përmbyllja e procedurës falimentuese

Pas fuqizimit të aktvendimit me të cilin gjyqëtari i falimentimit e ka miratuar planin e propozuar për riorganizim, gjyqëtari i falimentimit do të marrë aktvendim të veçantë për përmbyllje të procedurës së falimentimit. Para përmbylljes së procedurës, drejtori i falimentimit do të përmbush kërkesat e kreditorëve të masës falimentuese, nëse ato nuk janë kontestuar dhe do të japë sigurim për kërkesat e kontestuara.

Gjyqëtari i falimentimit do ta shpallë aktvendimin me të cilin e ka përmbyllur procedurën së bashku me shkaqet e përmbylljes. Debitori, drejtori i falimentimit dhe antarët e këshillit të kreditorëve do të njoftohen për ditën prej së cilës do të fillojë përmbyllja dhe të prodhojë veprim ligjorë. Gjyqëtari i falimentimit aktvendimin e lartpërmendur do ta dërgojë te Regjistri tregtarë që të bëhet regjistrimi përkatës.⁹⁰

Janë edhe disa hapa të fundit që duhet të ndërmerren për të përfunduar rastin e falimentimit. Së pari, duhet të dorëzohet raporti përfundimtar. Së dyti, mbyllet rasti i falimentimit, dhe në fund, drejtori i falimentimit lirohet nga gjykata. Me përfundimin e këtyre hapave vlerësohet se rasti i falimentimit ka përfunduar. Me mbylljen e procedurës falimentuese dhe me fshirjen nga Regjistri Qëndrorë borxhliu si person juridik ndërpritet të ekzistojë.

Sqarim:

Raporti përfundimtar i Administratorit

Administratori i rastit të falimentimit duhet t'i dorëzojë gjykatës Raportin Përfundimtar. Ky raport përfundimtar dorëzohet kur:

- Është përfunduar me sukses PR-ja; ose
- Në rast të likuidimit, kërkesat janë paguar në pajtim me shpërndarjen e propozuar dhe miratuar.

Fatkeqësisht, përmbajtja e raportit përfundimtar dhe procedurat për zgjidhje të kundërshtimeve janë lënë të rregullohen me rregullat përmbarese, të cilat akoma nuk janë përpiluar.

Pasojat e mbylljes së rastit:

Mbyllja e rastit të falimentimit ka pasoja të caktuara, varësisht prej procedurës së cilës i është nënshtruar debitori: likuidimit ose riorganizimit.

⁹⁰ Ligji për falimentim i RM-së, neni 243

PJESA E GJASHTË

LLOJE TË VEÇANTA TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

1. Procedura e falimentimit mbi pasurinë e personave të vdekur-tregtar

Tregtari individual është person fizik që këtë status e fiton nëse plotësohen veçoritë e caktuara me regjistrimin në regjistrin qendrorë. Pra, deri sa me regjistrim në regjistër tregtar, tregtari individual e fiton subjektivitetin juridik, me çregjistrim nga regjistri tregtar, tregtari individual e humb subjektivitetin juridik. Tregtari individual çregjistrohet në bazë të dorëzimit të fletëparaqitjes për çregjistrim që përbën:

-deklaratën për shuarjen e tregtarit individual

-dëshmia se llogaria e tregtarit individual është e mbyllur

-dëshmia se tregtari individual rregullisht i ka paguar obligimet tatimore, kontributet dhe obligimet tjera.

Prej momentit kur këta veçori pushojnë, ndërkohë pushon edhe tregtari individual. Ashtu si themelohet me vendim të personit fizik, poashtu edhe ndërpritet me vendim tregtari individual. Ndërprerja e tregtarit individual shkaktohet që me vdekjen e personit fizik pasi tregtari individual është person fizik. Në rastet e tilla trashëgimtarët janë të detyruar ta paraqesin ndërprerjen e tij. Ndërprerja e tregtarit individual mund të bëhet edhe nëse mbi të hapet procedura e falimentimit.⁹¹

Ndërprerjen e punës tregtari individual është i detyruar të e paraqes në drejtorinë e të hyrave publike. Së paku tre muaji para paraqitjes së ndërprerjes së punës te organi i të hyrave publike tregtari individual e shpall ndërprerjen e punës dhe shënon ditën e ndërprerjes së punës, sëpaku në një gazetë ditore. Tregtari individual i njofton kreditorët e njohur, veç e veç me shkrim. Ndërkohë duhet të bëje pagesën e gjithë obligimeve që ka ndaj kreditorëve si dhe kërkesat ndaj debitorëve. Kështu veprohet edhe kur tregtari individual ka për qëllim ndërmarrjen ta shesë ose ta depozitoi në shoqëri. Në aspektin territorial personi i vdekur ku ka pasur vendëbanimin ajo Gjykatë është kompetente për hapjen e procedurës falimentuese mbi pasurinë e atij personi. Nëse personi i vdekur ka pasur veprimtari të regjistruar me seli në vend tjetër, kompetent është

⁹¹ Ligji për falimentim i R.M. neni 2

gjykata në teritorin e të cilës gjendet selia. Pra, sipas kësaj kompetencat përcaktohen në dy mënyra:

a) në bazë të vendimit

b) në bazë të selisë së regjistruar.

Hapja e procedurës së falimentimit mbi trashëgimin e trashigimlënësit mund të propozohet nga secili-cilido trashëgimtar, person i të besuarit, përmbarues i testamentit ose kreditor i asaj pasurie. Si shkak i propozimit të hapjes së procedurës falimentuese mbi trashëgimin e personit të vdekur konsiderohet jolikuiditeti i cili mund të shkaktohet në të ardhmen. Me qëllim që të bëhet ndarja e masës trashëguese në më shumë trashëgimtarë, procedura falimentuese hapet pas procedurës së ndarjes. Përgjegjës pas hapjes së procedurës për disponimin dhe administrimin me atë pasuri që hynë në masën falimentuese është drejtori falimentues i cili këtë hap e mer pas zgjidhjes së procedurës paraprake. Në pasurinë që hynë në masën falimentuese, përmbushen obligimet në mënyrë të përcaktuar me dispozita ligjore si shpenzimet e bëra në mënyrë përkatëse që duhet ti kompensohen trashëgimtarit nga masa falimentuese, shpenzimet për varrimin e trashëgimtarit të ndjerë, shpenzimet e nevojshme reale që ka të bëjë me procedurën me cilën paraqitet dhe shpallet vdekja e personit të ndjerë, me mbrotjen dhe ruatjen e trashëgimisë, me shpalljen dhe thirjen e kreditorëve, regjistrimin e inventarit të asaj trashëgimie, obligimet tjera. Shpërndarja e masës falimentuese bëhet konform rregullave dhe procedurës falimentuese.⁹²

2. Procedura e falimentimit mbi pasurinë e bashkëshortëve

Hapja e procedurës falimentuese ka pasoja juridike dhe ndaj pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, në raste kur procedura falimentuese është e hapur ndaj cilit do nga bashkëshortët si borxhli individual. Për tu sqaruar ndikimi i procedurës falimentuese mbi këtë kapital duhet shkurt të jepen disa fakte të përgjithshme në lidhje me natyrën e juridike të pasurisë së bashkëshortëve. Sipas kriteriumeve në atë kur është krijuar dhe bazën se si është krijuar pasuria të bashkëshortet ai mund të jetë i posaçëm dhe i përbashkët.⁹³

Pasuri e posaçme është ajo pasuri ku njëri nga bashkëshortet e ka pasur në kohën e lidhjes së bashkëshortësisë dhe ai përfaqëson pasuri e vëçantë e tij. Pasuri e vacant llogatitet edhe pasuria dhe e drejta mbi pasurinë ndaj pasurisë ku bashkëshorti e fiton në bazë të trashëgimisë, dhuratë,

⁹² Adnan Jashari E Drejta Afariste (Statusore)

⁹³ Ligji për familjet (Fl Zyrtare e R.M. br 80/92, 9/96,38/04, 33/06, 84/08,67/10,156/10 dhe 44/12 Vendimet e Gjyqit Suprem 19/00, 79/01, 60/05, dhe 117/09)

si dhe gjërat e fituara me kurorë, atë cilët kryesishtë shërbejnë për përmbushjen e nevojave të njërit nga bashkëshortet, nëse nuk paraqet shumë të madhe të pakrahasueshme në raport me vlerën e pasurisë së përgjithshme. Udhëheqja dhe disponimi i pasurisë së veçantë është lënë të secili bashkëshortë veç e veç, përveç se bashkëshortet ndryshe nuk meren vesht. Marrëveshja duhet të kryhet në formën me shkrim. E drejta e pronësisë të bashkëshortëve për kompetencat për pasurinë e tyre të përbashkët evidentohet në librat publik në emër të dy bashkëshortëve si pasuri e tyre e përbashkët. Nëse në librat publik si pronar i pasurisë së përbashkët është regjistruar njëri nga bashkëshortët do të llogaritet se evidentimi është kryer në emër të dy bashkëshortëve dhe në rast të hapjes së procedurës falimentuese në rastet konkrete nuk paraqet pengesë që ajo pasuri të hy në procedurën faalimentuese.

Kur bashkëshortet me shkrim pajtohen për udhëheqjen dhe disponimin me pasurinë e përbashkët apo me ndonjë pjesë të vet ta kryej njëri nga ta dhe kur procedura falimentuese hapet ndaj pasurisë së bashkëshortëve, pasuria e përbashkët e bashkëshortëve apo pjesës për cilën ka të bëjë marrëveshja hynë në masën falimentuese.

FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR

Falimentimi me element të huaj paraqet falimentim ndërkombëtar. Elementi i huaj mund të jetë i lidhur për elementet më të rëndësishmenë një procedurë falimentuese siç janë pasuria e debitorit falimentues dhe pjemarësit në procedurën e falimentimit.⁹⁴

Falimentimi ndërkombëtar realizohet atëherë kur:

-gjykatat e huaja ose përfaqësuesi i huaj (drejtori i huaj i falimentimit, kreditorët dhe tjerë) kërkon ndihmë që ka të bëjë me procedurën që udhëhiqet në shtet të huaj.

-shteti i huaj kërkon ndihmë që ka të bëjë me procedurën që udhëhiqet në Maqedoni në përputhje me dispozitat ligjore.

-procedura në shtetin e huaj udhëhiqet njëkohësisht me procedurën e cila udhëhiqet në Maqedoni.

-kreditorët ose persona tjerë nga shteti i huaj kanë interes juridik, kërkojnë ngritje të procedurës ose marrin pjesë në procedura të cilat udhëhiqen në përputhje me dispozitat ligjore.⁹⁵

Çdo shtet ka interes që gjykatat e vendit-veta të zgjedhin marrëdhëniet e caktuara në rastet e caktuar. Për këtë arsye përcaktohet kompetencë ekskluzive, me qëllim që në këto raste të jetë kompetent gjykatat e shtetit të caktuar. Në shumë shtetet po edhe në Maqedoni, Gjykata e Maqedonisë është ekskluzivisht kompetent për zbatimin e procedurës së falimentimit kundër debitorit të falimentimit selia e cilit është në vendin amë-konkretishtë në Maqedoni, pra në vendin ku e ka regjistruar selin e veprimtarisë. Procedura përfshinë tërë pasurinë e debitorit pa marrë parasysh nëse pasuria gjendet në Maqedoni ose në vend të huaj (procedura kryesore e falimentimit). Në raste kur selia e regjistruar e debitorit është në vend të huaj por veprimtaria kryesore është në Maqedoni, të drejtë ekskluzive për procedurën e falimentimit kompetent është gjykata në rajonin ku gjendet puna afariste.⁹⁶

⁹⁴ V.Colovic, Megjunarodni stecaj Banja Luka, 2007

⁹⁵ Ligji për Falimentim i RM-së, neni 319

⁹⁶ Ligji për Falimentim i RM-së, neni 320

PËRFITIMET NGA FALIMENTIMI

Ligjet e mira për falimentimin janë aq të rëndësishme sa edhe një ekonomi e qëndrueshme. Miratimi i këtij ligji është pjesë e një tendence në Republikën e Maqedonisë për miratimin e legjislacionit ekonomik, i cili forcon mjedisin që mundëson zhvillimin e afarizmit. Ekonomia e Maqedonisë që përballoi një tranzicion të ashpër përveç reformave tjera kishte nevojë edhe për një ligj të mirë për falimentimin që është thelbësor për të ndihmuar shoqëritë tregtare dhe ndërmarrësit në përpjekjet e tyre, sidomos gjatë periudhave të vështira ekonomike. Ekzistenca e një ligji të mirë për falimentimin dhe e sistemit funksional për zbatimin e tij janë qenësore për funksionimin e duhur të veprimtarisë afariste në ekonominë e tregut. Me të vërtetë, ligjet e mira për falimentimin e inkurajojnë ndërmarrësin, sepse ju ofrojnë rrjetë të sigurt njerëzve të cilët duan të bëjnë afarizëm.

Në anën tjetër, mungesa e ligjeve për falimentimin ose nëse ato nuk janë funksionale mund të dëmtojnë ekonominë e vendit. Për shembull, në Republikën e Maqedonisë ekziston një prirje për të mos parashtruar kërkesë për falimentim, por në vend të saj të mbyllen dyert e ndonjë shoqërie tregtare dhe të hapet një e re nën emër të ri, duke mos i paguar kreditorëve asnjë shumë për borxhet të cilat ju detyrohen atyre. Shumë thonë se ligji i cili trajtohet në këto module ka nevojë për shumë akte nënligjore në mënyrë që ai të funksionojë në mënyrë të duhur. Në mungesë të tyre, zbatimi i tij do të ishte i vështirë. Në këtë mënyrë, është në interes të Maqedonisë të përfundojë kornizën ligjore që ka të bëjë me falimentimin dhe të fillojë zbatimin e saj në gjykata dhe autoritete tjera që merren me veprimtari afariste. Qëllimi i procedurës së falimentimit është përmbushja e kërkesave të kreditorëve nga borxhliu falimentues përmes likuidimit, përkatësisht shëndrrimit në para (materializimit) të pasurisë së borxhliut dhe shpërndarjen e mjeteve të realizuara kreditorëve ose nëpërmjet planit për riorganizim në drejtim të mbijetimit të aktivitetit të borxhliut.

PËRFUNDIM

Falimetimi paraqet situatën në të cilën gjendet një subjekt fizik ose juridik në kushtet e pamundësisë për pagimin e borxheve. Kjo situatë si e tillë paraqet një rezik të madh si për subjektin ashtu edhe për kreditorët. Si zgjidhje të vetme të kësaj situatë subjektet e shohin marjen e borxheve të tjera e cila edhe më tepër e vështirson gjendjen dhe poashtu kreditorët edhe më shume humbin mundësinë për kthimin e borxhit nga ana e debitorit.

Në këtë rastë vinë në shprehje miratimi i një ligji adekuat i cili do të regullonte situatat e këtilla në mënyrë më të përshtatshme si për debitorin ashtu edhe për kreditorët.

Qëllimi i Ligjit për falimentim është përcaktimi i disa dispozitave të detyrueshme dhe të barabarta për pagimin e detyrimeve gjatë procedurës së falimentimit. Përkatësisht përmes ligjit synohet që çdo shoqëri tregtare të ketë mundësinë e fshirjes së borxheve përmes shpërndarjes të të gjithë pasurisë së tijë duke përfshirë gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe mundësinë e një fillimi të fresket në njërin anë dhe në anë tjetër përmbushje të barabartë të të gjitha kërkesave të kreditorëve .

Ligji për falimentim gjithashtu sinon të sigurojë mënyrë të përshtatshme dhe efektive për riorganizimin ose likuidimin e një subjekti i cili përballlet me vështirësi financiare. Ligji ndëhyn jo vetëm në të drejtat procedurale të kreditorit ndaj debitorit por edhe në të drejtat pronësore të personave të cilët kanë një marrëdhënie juridike me debitorin e falimentuar para dhe pas fillimit të procedurës falimentuese.⁹⁷

Procedura e falimentimit është procedurë gjyqësore. Sipas ligji themi procedura e falimentimit vinë në shprehje mbi pronën e çdo debitori person juridik dhe mbi personin fizik i cili ka të regjistruar veprimtari. Procedura e falimentimit gjithashtu mund të realizohet edhe mbi pronën e bashkësisë ekonomike të interesit, mbi pronën e personit të vdekur dhe mbi pronën e çifteve bashkëshortore, duke përjashtuar pronen shtetërore të Republikës së Maqedonisë, fondet që financohen nga buxheti i shtetit, fondet për sigurim pensional, invalidorë, fondin për sigurim shëndetsorë, njësitë e vetadministrimit lokal, organet e drejtorisë shtetërore si dhe personat e tjerë juridik me autorizim publik.

⁹⁷ E drejta e falimentit, Erblina Fetahu, Tiranë

Rregullativa ligjore me të cilën rregullohet falimentimi, sot konsiderohet si një nga shtyllat kryesore të funksionimit të ekonomive të tregut. Në kushtet e zhvillimit të ekonomive në rrethanat e globalizimit ku ndryshimet janë shumë të shpejta, themi se falimentimi ka për qëllim primar të pastrojë tregun nga subjektet joprofitabile.

LITERATURA

1. Adnan Jashari-Subjektet e së Drejtës Afariste-Tetovë, 2009
2. Abdylmenaf Bexheti-Financat Publike-Tetovë, 2007
3. Aleks Laurasi-Ligjet për Sh.Tregtare-Tiranë, 2002
4. B.Brajanoski-Zakon za stečaji so komentar obrazci
5. B.Brajevski, Beličanec, T i Nikolloški, A-Komentar za zakonot za stečaj
6. Dejan Kostovski-Zakon za Stečaj-Skopje, 2014.
7. Erblina Fetahu-Drejta e Falimentimit- Tiranë, 2011
8. Grupa autora-Prirucnike za stečajne upravnike-Beograd, 2006
9. Gazeta Zyrtare e R.M.nr 84/89
10. Gazeta zyrtare e R.M.nr 57/97
11. Gazeta zyrtare e R.M.nr. 67/2007
12. Luan Gonxha “Korrupsioni” Tiranë, 2004
13. Mariana Semini-Tutulani-E Drejta Tregtare-Tiranë
14. M.J.Zatilla-Reorganizacija ili korporativna rehabilitacija kao stečajna alternative- Beograd, 1997
15. Milena Anxheloovic-Izbegavanje placanje poreza-Beograd, 1989
16. Mihajlo Maneski-Korupcija- Skopje, 2002
17. N.Tupcanoski “Etimologija i fenomologija na k.dello,danocno zatajuvanje” Skopje.nr 12
18. M. Dika, Insolvevencijsko pravo- Zagreb, 1998
19. N.B.R.M.”Godishen Izveshtaj” 2003-2013
20. M.F.-Strategija za sprečuvanje na perenje pari- Skopje, 2006
21. Prof.Mr P.F. Van der Heiden-“The Sector Informal in Transition“ përkth. Klarita Grzhani- Tiranë, 2004
22. Regjistri Qëndrorë i R.M.
23. Selman Selamanaj-Globalizimi dhe Tranzicioni- Prishtinë, 2006
24. Trajko Sllaveski “Privatizacija, Pazar, drzhava” Skopje, 1997
25. Zakon za Stečajna postapka. Sll. Vesnik na R.M. nr. 55/97 prej 29.10.2007
26. Zakon za Trgovski Drushtva
27. Rregullorja e UMNİK-ut 2001/9, 35; 2005/18,48
28. V.Radovic-Stecajni Isplatni redovi- Beograd, 2004
29. Zakonot za stečaj, prinudno likvidiranje i likvidacija; nr 174/95, 17/96, 44/2006; 126/2006, 84/2007
30. Zakon za prisillno poravnuvanje stečaj i likvidacija, Sll list na SFRJ, nr. 84/89

31. Zakon za stečaj, Službeni Vesnik na R.M. nr 34 prej 23.03.2006
32. Zakon o transformaciji društvenih proizvođača, SFRJ, 1991
33. Централен регистар (2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016), База на податоци за домашни сметки и правни лица, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, Скопје.
34. Државен завод за статистика на РМ
35. Vujović. S. Osnovni finansiskog menaxhmenta, megatrend, Univerzitet primenjenih nauka-Beograd, 2005.
36. Velkovski Tome, Skopje (2010) ‘‘Drzhavni Institucii vo stecajna postapka’’
37. Velkovski Tome, Stečajna postapka vo R.Makedonija.
38. Vitanova, G. Finansiski pazari i institucii, Ekonomski Fakultet-Prilep, 2003
39. Ministerstvo za ekonomija na R.M. ([www. Economy.gov.mk](http://www.Economy.gov.mk))